



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 13 regjistër (JR)
Datë 11.03.2021

Nr. 37 i vendimit
Datë 19.09.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 19.09.2023, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Bardhok Lleshi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 336, datë 15.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bardhok Lleshi.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

neni 46 e vijues i ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 19.09.2023, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 336, datë 15.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Bardhok Lleshi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për shkak të funksionit prokuror, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr. 84/2016,
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin Bardhok Lleshi, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

3.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;* (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;* (iii) *ka kryer fshehje të pasurisë;* (iv) *ka kryer deklaram të rremë;* (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Bardhok Lleshi, bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Me vendimin nr. 336, datë 15.01.2021, Komisioni vendosi shkarkimin e subjektit nga detyra.

4.1. Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në zbatim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të pasurive të krijuara *përpara* fillimit të detyrës. Pretendimi i tij për pamundësi objektive, ngritur nga subjekti pasi u njoh me rezultatet e hetimit, u konsiderua jobindës sipas Komisionit. Po ashtu, Komisioni konstatoi pasaktësi të *qëllimshme* në deklaratimet periodike vjetore, si dhe marrëveshje tregtare të papasqyruara me transparencë, të cilat kanë krijuar dyshim se pasuria e subjektit është shumëfishuar në vlera të konsiderueshme dhe pa dokumentacion mbështetës mbi ligjshmërinë e tyre, gjatë kohës që subjekti ishte në detyrë. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se pasuritë e tij janë krijuar të gjitha para ushtrimit të detyrës nuk u vlerësuan të bazuara nga Komisioni.

4.2. Përfundimisht, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe ndodhet në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se ai ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe se gjendet gjithashtu në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) kundër vendimit të sipërpërmbledhur. Subjekti ka pretenduar se vendimi ka qenë i paragjykuar, është i pabazuar në ligj, është rezultat i cenimit dhe shkeljes së normave dhe rregullave procedurale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe rezultat i vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të rezultuara të vërtetuara gjatë procesit të hetimit administrativ për vlerësimin e kriterit të pasurisë. Bashkë me ankimin, subjekti ka sjellë disa akte shkresore në cilësinë e provave të reja. Përmes ankimit, subjekti ka kërkuar që Kolegji të vendosë:
 - (i) Prishjen e vendimit objekt ankimi dhe dërgimin e çështjes Komisionit [apo KLP-së, në varësi të cilit institucion do të jetë ngarkuar për këtë detyrë], për të vazhduar me procedurën e rivlerësimit për kriteret e pavlerësuar.Ose:
 - (ii) Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike;
 - (iii) Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe të atyre të parashikuara nga KEDNj-ja, ndaj subjektit të rivlerësimit Bardhok Lleshi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë;

(iv) Çeljen e shqyrtimit gjyqësor, administrimin e provave të reja dhe hetimin e dy kritereve të reja;

(v) Ndryshimin e vendimit nr. 336, datë 15.01.2021, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

6. Subjekti ka pretenduar se vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të së drejtës për proces të rregullt, sikurse edhe në vlerësim të gabuar të kriterit të kontrollit të pasurisë.

6.1. Për sa u përket argumenteve për cenim të procesit të rregullt dhe të aspekteve procedurale të procesit të rivlerësimit të tij, subjekti potencon se: (i) hetimi i Komisionit është i paplotë dhe i pabazuar në Kushtetutë dhe në ligj; (ii) procesi i zhvilluar për të është i parregullt në kuptim të nenit 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pikat 5 dhe 6, nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016; (iii) Komisioni ka shkëlur nenin 6 të KEDNj-së, pasi mbi të njëjtat fakte, ka arritur në konkluzione të kundërta nga Prokuroria Shkodër, e cila ka pushuar procedimin penal në ngarkim të tij në vitin 2014, nisur me kallëzimin e paraqitur nga ILDKPKI-ja. Prokuroria ka konstatuar se faktet e kallëzuara nuk përbëjnë vepër penale; (iv) shkarkimi i tij nga detyra është në shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, pasi është joproportional me qëllimin e ndjekur dhe konkluzionet në të cilat është bazuar.

6.2. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, argumentet e subjektit në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë.

6.2.1. Konkluzioni i Komisionit për deklaram të pasaktë dhe mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë “tokë arë”, me sipërfaqe 8.320 m², në Dritas, Tiranë, është i pabazuar. Deklarimet e tij ndër vite dhe në deklaratën e rivlerësimit *vetting* janë të sakta. Burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga emigracioni. Dokumentacioni provues mungon për shkaqe objektive, për të cilat duhet të zbatohet pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

6.2.2. Konkluzioni i Komisionit për deklaram të rremë dhe mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë tokë arë, me sipërfaqe 16.620 m², ndodhur në Tapizë/Dritas [Tiranë], është i gabuar. Deklarimi i kësaj pasurie është në përputhje me ligjin. Pasuria është krijuar me burime të ligjshme financiare dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

6.2.3. Konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe deklaram të rremë për apartamentin e ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, është i gabuar. Në zbatim të parimit të sigurisë juridike, konkluzionet e Komisionit nuk mund të jenë të ndryshme nga ato të hetimit të procedimit penal të vitit 2014, për sa vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër është në fuqi. Deklarimi i kësaj pasurie në deklaratën e rivlerësimit *vetting* është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Kjo pasuri është krijuar me burime të ligjshme financiare, të ardhura nga emigracioni dhe kredia e marrë nga Emporiki Bank.

6.2.4. Konkluzionet e Komisionit për pasurinë bodrum [me sipërfaqe 600 m²], se ka kryer deklaram të pasaktë, nuk ka burime financiare të ligjshme, gjendet në situatën e konfliktit të

interesit të paktën në një rast dhe se ka kryer deklaram të rremë, janë tërësisht të pambështetura në prova dhe legjislacionin e zbatueshëm. Kjo pasuri është krijuar me burime të ligjshme dhe ai e ka shpjeguar në mënyrë bindëse krijimin e saj.

6.2.5. Konkluzioni i Komisionit se ka kryer deklaram të rremë dhe se ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” [me targa {***}], është i gabuar. Deklarimi në deklaratën e rivlerësimit *vetting* është i saktë. Pasuria është krijuar me burime të ligjshme, dhe të ardhurat nga shitja e saj duhet të përfshihen në analizën financiare.

6.2.6. Janë të pabazuara e në kundërshtim me provat konkluzionet e Komisionit lidhur me pjesëmarrjen në kapitalin themeltar të shoqërisë “{***}” ShPK. Aludimi për ndikim të pozicionit të tij si prokuror nuk mbështetet në asnjë parashikim ligjor. Kjo pasuri nuk është krijuar me të ardhura nga emigracioni. Blerja e kuotave të shoqërisë në vitin 2011, në vlerën 60.000 lekë, është në përputhje me kapitalin e saj.

6.2.7. Konkluzioni i Komisionit se ka kryer deklaram të pasaktë dhe se nuk ka mundur të provojë mundësitë financiare për blerjen e truallit të ndërtimit në Lezhë në vitin 2002 [me sip. 7.210 m²], është tërësisht i pabazuar. Nga provat, rezulton qartë se kjo pasuri është e vëllait F. Ll. dhe është deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës, duke saktësuar se zotërohet 100% prej vëllait.

6.2.8. Konkluzioni i Komisionit se nuk ka mundur të provojë mundësitë financiare për krijimin e pasurisë dyqan në rr. “{***}”, në Tiranë, ose që kjo është pasuri e vëllait të tij, dhe të ardhurat e përfituara mbetën të paprovuara, është tërësisht i pabazuar. Kjo pasuri nuk ka qenë asnjëherë në pronësi të tij, apo të personave të lidhur me të. Subjekti vetëm ka administruar të ardhurat e aktivitetit për të cilin janë paguar rregullisht detyrimet tatimore. Administrator ka qenë vëllai F. Ll..

6.2.9. Konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerën 10.000 euro të *cash*-it, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, është i pabazuar. Të ardhurat nga qiratë në vite, të administruara *cash*, jo domosdoshmërisht kanë qenë të kursyera.

6.2.10. Mosdeklarimi i aksioneve të bashkëshortes në kapitalin themeltar të shoqërisë “{***}” ShPK, është një pasaktësi. Fitimi i realizuar, i pashpërndarë, nuk është objekt deklarimi sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

6.2.11. Për analizën financiare për periudhën kohore 2003-2016, Komisioni ka vlerësuar vetëm shpenzimet për krijimin e pasurive dhe jo të ardhurat e krijuara. Në analizë ka dublim të vlerave të pasurive të krijuara përpara fillimit të detyrës dhe pasaktësi në përlllogaritjen e viteve 2005-2010. Nga korrigjimi dhe saktësimi i analizës për periudhën 2005-2016, rezultatet e të gjitha viteve janë pozitive.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit. Për rrjedhojë, çështja me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

8. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 14 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Përrjashtim bëjnë rastet kur trupi gjykues vlerëson se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Trupi gjykues i Kolegjit e shqyrtoi këtë çështje në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi vlerësoi se nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike.
10. Subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte shkresore¹ bashkëlidhur ankimit, që kërkoi të merren në cilësinë e provave për konstatimin e drejtë të gjendjes faktike. Sipas tij, për shkaqe objektive, ka qenë e pamundur t’i depozitonte këto akte gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision. Nën dritën e

¹ Aktet e bashkëlidhura ankimit janë përkatësisht: (i) vendim i datës 26.06.2015, i prokurorit F. L., Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për pushimin e procedimit penal të vitit 2014, regjistruar në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Bardhok Lleshi, për veprën penale “Refuzimi për deklarim, mosdeklarim, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunës publikë”, të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal dhe shkresë përcjellëse të Prokurorisë [pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër], datë 03.08.2015, drejtuar atij; (ii) shkresë e Avokatit të Popullit, me nr. {***} prot., datë 03.03.2017, drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për përcjellje të dokumentacionit Kuvendit të Shqipërisë për të argumentuar që një ndër komisioneret që ka qenë pjesë e trupit gjykues në Komision, nuk përmbush kriteret e zgjedhshmërisë; (iii) komunikim elektronik mes punonjësve të ILDKPKI-së dhe Drejtorisë së Tatimeve lidhur me tatimet e evidentuara për aktivitetin tregtar “{***}”.

parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, të cilat diktojnë kushtet kur mund të paraqiten prova të reja në ankim, trupi gjykues vendosi të mos pranonte asnjë prej këtyre akteve. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktet që lidhen me mosfillimin e procedimit penal ndaj tij, datojnë nga viti 2015. Ky fakt tregon që subjekti i ka disponuar këto dokumente përpara procesit të tij të rivlerësimit e, për rrjedhojë, nuk ka qenë në kushtet e pamundësisë për të kërkuar marrjen e tyre si provë në Komision. Për sa u përket akteve që lidhen me pretendimet për mospërmbushje të kriterëve të zgjedhshmërisë së komisioneres, znj. P., korrespondenca që kërkohet të pranohet në cilësinë e provës daton në vitin 2017. Për rrjedhojë dhe në kushtet që subjekti nuk ka dhënë arsye për të provuar se nuk ka qenë në gjendje t’i paraqiste këto akte në Komision, sjellja e tyre si provë e re në ankim, nuk përmbush testin e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Së fundmi, korrespondenca mes ILDKPKI-së dhe administratës tatimore, kryer në funksion të përgatitjes së raportit të kontrollit për procesin e rivlerësimit, është pjesë e fashikullit të përcjellë në Kolegj nga Komisioni. Si i tillë, ky akt nuk përbën provë të re. Ky vlerësim i trupit gjykues të Kolegjit mban në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6² e ligjit nr. 84/2016, për provat që duhet të refuzohen nëse nuk lejohen nga ligji. Në rastin konkret, në kushtet që subjekti nuk provon se mosparaqitja e provave në hetimin administrativ në Komision, nuk është për faj të tij, trupi gjykues refuzoi marrjen e tyre në cilësinë e provës, sikurse parashikon neni 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

11. Me parashtrimet e depozituara përpara seancës gjyqësore, subjekti i rivlerësimit paraqiti nëntë (9) akte shkresore të tjera, të cilat po ashtu kërkoi të merren në cilësinë e provës. Ndër to, dy (2) dokumente³ kanë për qëllim të provojnë të ardhurat e vëllait të subjektit [z. F. Ll.] në emigracion. Për këto akte, sipas subjektit, Komisioni nuk i ka dhënë kohë të mjaftueshme. Aktet e tjera synojnë të provojnë të ardhura të subjektit për krijimin e pasurive objekt analize⁴. Trupi gjykues i përjashtoi

² Ndër të tjera, kjo dispozitë përcakton që: “[6.] Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji [...]”.

³ Grupi i parë i akteve përmban: (i) deklaratë noteriale të datës 16.03.2021, të një individi rezident në ShBA, që deklaron në lidhje me punësimin e vëllait të subjektit në kompaninë e tij, në periudhën 1999-2002, pagesën përkatëse [2.000 USD/muaj] dhe faktin që gjithë detyrimet tatimore janë paguar nga kompania. Deklaruesi shprehet po ashtu se të dhënat nuk disponohen meqenëse ligjet e ShBA-së nuk kërkojnë ruajtjen e dokumentacionit më shumë se 7-14 vite. Deklarata, me vulë apostile nga Departamenti i Shtetit të Floridas në datë 26.04.2021, është paraqitur edhe e përkthyer dhe e noterizuar më datë 19.12.2022; (ii) shkresë të datës 26.03.2021, në gjuhën angleze, me logo të Autoritetit Federal të Taksave në Kanada [Canada Revenue Agency], drejtuar vëllait të subjektit, z. F. Ll.. Kjo shkresë ka bashkëlidhur formularë të “Income Tax Return Information – Regular”, për vitet 2003-2013, në emër të z. F.Ll. dhe numrin personal përkatës të tij në funksion të sigurimeve shoqërore. Dokumentet e sipërcituara janë paraqitur të përkthyer dhe të noterizuara. Në përmbajtje të shkresës, e cila rezulton të përfshijë informacionin e kërkuar nga marrësi, jepet informacion për përdorimin e shërbimit on-line për taksat mbi të ardhurat, informacionin e të ardhurave personale, si dhe shërbime ndihmëse për përdoruesit.

⁴ Aktet e tjera, janë: (i) një formular i DRT Lezhë, datë 16.12.2020, titulluar “Njoftim vlerësimi për detyrimet”, pa kredenciale konfirmuese të autenticitetit/ekstremite të institucionit (nr. protokollit, vulë, fizike apo elektronike); (ii) nxjerrje llogarie bankare për shoqërinë “{***}” ShPK, printuar më 18.03.2021, ku pasqyrohen veprime bankare të kryera më datë 17.03.2021, por pa të dhëna identifikuese të bankës përkatëse; (iii) kontrata shitje automjetesh, respektivisht të viteve 2004 dhe 1999, objekti i të cilave nuk ka lidhje me pasurinë objekt rivlerësimi [automjeti me

nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes këto akte, pasi vlerësoi se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49, pika 6, fjalialia e parë e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim vetëm lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja.

12. Pavarësisht nga ky vlerësim ligjor, trupi gjykues vëren se aktet e sjella me parashtrimet, nuk kapërcejnë as kriteret e përcaktuara në nenin 49, pika 6, geramat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, pasi u mungon forma e kërkuar nga ligji, marrja e tyre duket e panevojshme apo pretendojnë të provojnë fakte që edhe nëse pranohen të vërteta, nuk ndikojnë në vendimmarrjen përfundimtare.

12.1. Konkretisht, përpos faktit që subjekti ka pasur mundësinë të administronte aktet që lidhen me të ardhurat e vëllait në ShBA dhe Kanada gjatë hetimit administrativ, aktet e sjella nuk përbëjnë dokumentacion zyrtar për të provuar shumën e të ardhurave duke qenë me natyrë deklarative ose, në rastin e printimeve të dokumentacionit zyrtar kanadez, përbëjnë një pasqyrim të shërbimeve të ofruara taksapaguesve, pa specifikuar të dhëna në dobi të pretendimeve të subjektit. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit⁵, megjithëse e vlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia provuese e deklaratës noteriale të hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, është e zbehtë. Në këtë rast, deklarata në favor të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, është hartuar pasi subjekti është njohur me vendimin e Komisionit për shkarkimin e tij nga detyra, fakt që nuk mund të mos ngrejë pyetje për mospërputhjen e pretendimeve me faktet, duke favorizuar situatën e subjektit. Legalizimi i deklaratës noteriale sipas procedurave për përdorimin e dokumentacionit jashtë vendit, provon kryerjen e deklarimit nga deklaruesi, por jo vërtetësinë e të dhënave të deklaruara prej tij.

12.2. Më e rëndësishmja, subjekti nuk provoi pamundësinë e sigurimit të këtij dokumenti nëpërmjet formave të tjera të komunikimit – telefon, postë elektronike e shërbim postar – apo pengesat konkrete të krijuara nga situata e pandemisë përpara, gjatë dhe pas. Përpos faktit që parashikimet kushtetuese, ligjore dhe udhëzimi i ILDKPKI-së përcaktojnë *shprehimisht* barrën e gjithë subjekteve të rivlerësimit për të provuar me dokumentacion të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, përfshirë edhe ato të fituara nga punësimi jashtë Shqipërisë/në emigracion që në vitin 2016⁶, edhe në nivel individual, subjekti është vendosur në dijeni të nisjes së procesit të hetimit

*targë {***}}, por synojnë të vërtetojnë me prova rrethanore mundësitë financiare për krijimin e saj; (iv) vendim, datë 27.07.2010, i Komunës Bërçullë, për dhënien e lejes së ndërtimit shoqërisë “{***}” ShPK, bashkë me dokumentacionin përkatës; (v) kopje të noterizuara të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, Njësia-{***}, me palë shitëse shoqëria “{***}” ShPK dhe palë blerëse N. LL.; dhe (vi) certifikata për vërtëtim pronësie në emër të z. N. LL., lëshuar më datë 23.11.2012 dhe më datë 16.06.2020.*

⁵ *Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018(JR), paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019(JR), paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019(JR), paragrafi 85.2; nr. 48/2022(JR), paragrafi 31.*

⁶ *Aneksi i Kushtetutës është miratuar më datë 22.07.2016, ligji nr. 84/2016 në datën 30.08.2016 dhe Udhëzimi i ILDKPKI-së në datën 10.10.2016.*

administrativ për të, që në datën 07.02.2020, nëpërmjet njohjes me trupin gjykues, edhe duke abstraguar nga fakti që shorti për rivlerësimin e tij është hedhur që më 16.12.2019⁷. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për pamundësi për shkak të pandemisë, është i pabazuar. Së dyti, nga aktet në fashikull, nuk rezulton që subjekti të ketë kërkuar kohë shtesë për sigurimin e dokumentacionit gjatë hetimit administrativ, ndonëse ka kërkuar dhe i është dhënë kohë shtesë për shkaqe të tjera. Përpos kësaj, trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ, pyetjes se sa kanë qenë të ardhurat vjetore të vëllait në emigracion, subjekti i është përgjigjur: *nuk kam dijeni*. Në kushtet që subjekti pretendon se ka qenë në ekonomi të përbashkët familjare me vëllanë në fjalë, kjo përgjigje mund të lexohet si përpjekje për krijim mundësie të një deklarimi të mëpasmë, në varësi të rezultateve. Në parashtrime subjekti ka pretenduar se vëllai arriti të rrugëtonte drejt Kanadasë dhe ta siguronte dokumentacionin, pa e shoqëruar këtë pretendim me dokumentacion mbështetës.

12.3. Për sa më sipër, parë edhe në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka qenë në pamundësi për ta paraqitur dokumentacionin në Komision, për sa rezulton se ai mund të sigurohej *on-line*. Në përmbledhje, pretendimi i subjektit për mosdhënie mundësie nga Komisioni për të sjellë dokumentacion për të ardhurat e vëllait, vlerësohet i pabazuar, në kushtet që edhe duke përjashtuar periudhën kohore gjatë së cilës është kufizuar veprimtaria për shkak të pandemisë, hetimi administrativ ka zgjatur edhe të paktën gjashtë (6) muaj të tjerë [seanca gjyqësore është kryer më 11.01.2021].

12.4. Në të njëjtën linjë dhe duke abstraguar nga fakti që aktet e tjera paraqiten për herë të parë në ankim, trupi gjykues vëren se grupi i akteve të sjella me parashtrimet për të provuar aspekte të ndryshme të pretendimeve të subjektit për vlerësimin e pasurisë, nën dritën e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe nëngermat përbërëse të saj, nuk u pranuan për shkak të problemeve të formës apo për shkak se nuk do të kishin ndikim mbi vendimin përfundimtar. Konkretisht, dy⁸ prej tyre u mungojnë ekstremitetet e nevojshme nga ana formale e, për rrjedhojë, janë të papërdorshme në kuptim të dispozitave procedurale civile dhe të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Tri akte të tjera janë pjesë e fashikullit të përcjellë nga Komisioni në Kolegj⁹, ndërsa një tjetër referon të dhëna pa relevancë në kontrollin e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së luajtshme [automjet]¹⁰. Në kushtet që në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2006, si dhe gjatë

⁷ Referuar paragrafëve 3 dhe 4 të vendimit të Komisionit, si dhe njoftimit në faqen zyrtare të Komisionit në: <https://kpk.al/njoftim-per-shortin-e-dates-16-dhjetor-2019/19/>.

⁸ Formulari i DRT Lezhë, datë 16.12.2020 dhe nxjerrje llogarie bankare për shoqërinë “{***}” ShPK, printuar më 18.03.2021, referuar edhe në poshtëshënimin nr. 4.

⁹ Shih poshtëshënimin nr. 4, nënpikat “iv”, “v” dhe “vi”. Për dokumentet e cituara në nënpikën “v”, kontratë shitblerjeje e pasurisë Njësia-***, dhe certifikatën për vërtetim pronësie në emër të z. N. Ll., lëshuar më datë 23.11.2012, cituar në nënpikën “vi”, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në pamundësi për paraqitjen e tyre në Komision, por gjithashtu përmes tyre provohet kryerja e veprimeve juridike lidhur me pronësinë e njësies në një periudhë me të vonë se ajo në të cilën subjekti ka administruar aktivitetin tregtar të zhvilluar në të, e për këto arsye ato nuk kanë relevancë në çështjen objekt shqyrtimi.

¹⁰ Shih poshtëshënimin nr. 4, nënpika “iii”.

gjithë procesit në Komision, subjekti i rivlerësimit këtë pasuri e ka deklaruar me të ardhura nga emigracioni, këto dokumente do të ishin gjithësesi të panevojshme.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi objekt ankimi është marrë mbi bazën e një hetimi administrativ të paplotë, të pabazuar në Kushtetutë dhe ligj, dhe që konkluzioni i Komisionit përbën shkelje të parimeve themelore procedurale pasi procesi i zhvilluar për të është i parregullt, në kuptim të nenit 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pikat 5 dhe 6, si dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit i mori në analizë të gjitha këto pretendime nën dritën e dispozitave kushtetuese përkatëse, dhe arriti në përfundimin që asnjë prej pretendimeve të subjektit nuk qëndron. Nga analiza e kryer mbi bazën e akteve në fashikull, rezultoi se procesi i kryer për subjektin e rivlerësimit ka qenë në përputhje dhe në përmbushje të gjithë garancive kushtetuese, ligjore e të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë për proces të rregullt ligjor. Në vijim, shtjellohet në detaj arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion.

13.1. Së pari, subjekti ka argumentuar se është shkelur parimi i *sigurisë juridike* pasi objekti i hetimit administrativ të Komisionit përkon thujse në tërësi me hetimin e kryer në ngarkim të tij në kuadër të procedimit penal nr. {***}, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur pushimin e çështjes, meqenëse faktet e parashtruara në kallëzimin e ILDKPKI-së nuk përbëjnë vepër penale. Duke referuar jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese¹¹ dhe qëndrimin e mbajtur nga GjEDNj-ja në çështjen *Xheraj kundër Shqipërisë*¹², subjekti argumenton se nuk mund të fillojnë hetimet apo procedura të tjera gjyqësore apo administrative për një fakt për të cilin është konkluduar me vendim pushimi. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar, ndërsa ngjarjet e sjella në vëmendje prej subjektit, e konkretisht, procesi i rivlerësimit dhe mbyllja/mosfillimi i procedimit penal në ngarkim të tij më herët, nuk përmbushin kushtet për të qenë edhe indirekt si të lidhur me njëri-tjetrin. Në këtë vlerësim, shtjelluar gjerësisht më poshtë, trupi gjykues mban në konsideratë qoftë natyrën e ndryshme të procedimeve, qoftë parimet mbi të cilat mund të argumentohet në mënyrë legjitime shkelje e parimit të sigurisë juridike, por edhe rrethanat konkrete të procedimeve të potencuara nga subjekti, arsyetuar në vijim.

13.2. Së pari, trupi gjykues sjell në vëmendje se vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. {***} nuk i është nënshtruar kontrollit gjyqësor. Për rrjedhojë, referenca në qëndrimin e GjEDNj-së në çështjen *Xheraj*, përjashtohet në nivel parimor për disa shkaqe. Së pari, sepse

¹¹ Subjekti referon në vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 02.11.2005; nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 9, datë 26.02.2007.

¹² Subjekti ka referuar paragrafin 58 të vendimit *Xheraj kundër Shqipërisë*: <https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-205654>.

konstatimi i shkeljes së parimit të sigurisë juridike në atë vendim është derivat i ekzistencës së një vendimi *gjqësor*, të rishikuar nga gjykatat vendase. Edhe në çështjen *Brumarescu kundër Rumanisë*, që përbën mbështetjen për vendimin në *Xheraj*, në fokus të analizës kanë qenë veprimet [e kontestuar] të autoriteteve vendase, e ndikimi i tyre mbi sigurinë juridike të krijuar nga një *vendim gjyqësor*. Nga ana tjetër, edhe në *Xheraj kundër Shqipërisë*, në paragrafët 51-54 dhe si *obiter dictum*, GjEDNj-ja ka rikonfirmuar se parimi i sigurisë juridike *nuk* është absolut dhe ka ritheksuar të paktën pesë (5) çështje të jurisprudencës së vet, në të cilat janë elaboruar rrethana me karakter përmbajtësor e detyruese, ose shkaqe serioze e të përligjura, të cilat në balancën tërësore të interesave, prevalojnë mbi parimin e sigurisë juridike¹³. Së dyti, trupi gjykues çmon të theksojë edhe qëndrimin e GjEDNj-së se heqja dorë nga ndjekja penale nga ana e një prokurori, nuk është e barasvlefshme as me dënimin, sikurse as me shpallje pafajësie¹⁴. Me fjalë të tjera, jurisprudenca mbi të cilën mbështetet ky argument i subjektit jo vetëm nuk gjen zbatim pasi mungon analogjia, por edhe ofron argumente në të kundërt të pretendimit të subjektit.

13.3. Së dyti, GjEDNj-ja ka konstatuar edhe që neni 4 i Protokollit nr. 7 – *E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë* – nuk e përjashton ndjekjen e procedurave të dyfishta, penale dhe administrative, me kusht që të vërtetohet në mënyrë bindëse se procedurat kanë qenë të bashkuara nga një “lidhje materiale dhe kohore mjaft e ngushtë”¹⁵. Për të vendosur nëse kjo lidhje ekziston, elementet me rëndësi që duhet të merren parasysh, janë: (i) nëse procedurat e ndryshme synojnë qëllime bashkëplotësuese dhe kanë të bëjnë kështu jo vetëm *in abstracto*, por edhe *in concreto*, me aspekte të ndryshme të aktit të dëmshëm ndaj shoqërisë për të cilin është fjala; (ii) nëse dyfishësia e procedurave është një pasojë e parashikueshme si ligjërish, ashtu edhe praktikisht, e së njëjtës sjellje të ndëshkuar (*idem*); (iii) nëse procedurat janë ndjekur në një mënyrë që e shmang sa të jetë e mundur çdo përsëritje në grumbullim e vlerësim të provave, sidomos në saje të një ndërveprimit të përshtatshëm ndërmjet autoriteteve të ndryshme kompetente, në të cilin shihet qartë se përcaktimi i fakteve i bërë në njërin nga procedurat është marrë te tjetra; (iv) e sidomos, nëse sanksioni i vendosur në përfundim të procedurës që mbaron e para, është marrë parasysh në procedurën që mbaron e fundit, në mënyrë që i interesuari të mos ngarkohet me një barrë të tepruar, meqenëse ky rrezik i fundit ka më pak gjasa të paraqitet po qe se ekziston një mekanizëm rregullues i konceptuar për të siguruar që shumica e përgjithshme e të gjitha dënimeve të dhëna të jetë proporcionale.

13.4. Në konsideratë të këtij qëndrimi, trupi gjykues vlerëson se në procesin e rivlerësimit të subjektit, zhvilluar vite pasi ishte mbyllur një procedim penal, i cili nuk iu nënshtroa kontrollit gjyqësor, evidentohet qartësisht ekzistenca e elementeve që u përkasin qëllimeve të ndryshme e

¹³ <https://hudoc.echr.coe.int/fre?i=001-87964>. *Ryabykh kundër Rusisë*, (nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX) dhe *Bratyakin kundër Rusisë* (vendimi nr. 72776/01).

¹⁴ *Shih vendimet e GjEDNj-së në Smirnova e Smirnova kundër Rusisë, Harutyunyan kundër Armenisë, çështja Margus kundër Kroacisë, par. 120, ndër të tjera.*

¹⁵ *Shih vendimin e GjEDNj-së, A e B kundër Norvegjisë [Dhoma e Madhe], ku gjykata ka shqyrtuar sistemin norvegjez të procedurës së dyfishtë penale dhe administrative në rast deklarimesh tatimore jokorrekte, paragrafët 130 dhe 132.*

po ashtu edhe parashikueshmërisë së tyre, ligjore dhe praktike. Pasi ka analizuar sa më sipër, edhe nën dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së¹⁶, trupi gjykues çmon të theksojë që, në rastin konkret, procedurat e kryera janë ndjekur nga institucione të ndryshme, me tagra të ndryshme, mbi baza ligjore të ndryshme dhe natyrë tejet të ndryshme procedimesh. Mes dy procedimeve nuk ka asnjë lidhje, përpos që njëri është penal e tjetri administrativ – organet e rivlerësimit hetojnë dhe vendosin mbi kritere të përcaktuara nga Kushtetuta e ligji në një procedim autonom, dhe me dinamikë e parime të ndryshme nga ato që karakterizojnë procedimin penal që kryen prokuroria.

13.5. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se procesi i rivlerësimit për subjektin nuk përbën në asnjë këndvështrim shkelje të sigurisë juridike. Për këtë shkak, argumentet e subjektit për të kontestuar legjitimitetin e vlerësimit pasuror të kryer nga organet e rivlerësimit, janë të pabazuara. Procesi i rivlerësimit përbën një procedurë të ndryshme, për objektiva të tjerë dhe të pakushtëzuar e ndërvarur nga procedimi penal i mbyllur në vitin 2015 nëpërmjet heqjes dorë nga ndjekja penale nga prokuroria, përpara se të miratoheshin dispozitat që sollën procesin e rivlerësimit në Shqipëri. Në këtë drejtim, sjellim në vëmendje që procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016¹⁷, duhet të identifikojë subjektet që kanë në pronësi ose përdorim *pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht*, ose ata që *nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht* pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Ky objektiv realizohet bazuar në parime dhe standarde të përcaktuara qartë. Nga leximi harmonik i parimeve mbi të cilat kryhet kontrolli i pasurisë së subjekteve në procesin [administrativ] të rivlerësimit, deduktohet që edhe në një situatë *hipotetike* të ekzistencës së një vendimi gjyqësor të formës së prerë, nuk do të mund të argumentohet se ishte në pikëpyetje cenimi i parimit të sigurisë juridike apo gjësë së gjykuar. Juridiksionet e ndryshme, procedimet e ndjekura veçmas e në mënyrë të pavarur, dhe kompetencat e organeve të rivlerësimit, të njohura nga kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, përjashtojnë ekzistencën e ndonjë shkakut ligjor për të pretenduar për cenim të parimit të sigurisë juridike.

13.6. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka vënë në dukje elemente konkurruese me këtë parim. Konkretisht, interesi publik konkurrin me sigurinë juridike dhe prevalon ndaj tij, sikurse referuar edhe më sipër, arsyetuar gjerësisht edhe në jurisprudencën e GjEDNj-së¹⁸. Në të njëjtën linjë, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se:

¹⁶ Shih vendimet e GjEDNj-së, *çështjet Häkkä k. Finlandës, Nykänen k. Finlandës, Glantz k. Finlandës, Rinas k. Finlandës, Österlund k. Finlandës, Kiiveri k. Finlandës dhe Lucky Dev k. Suedisë.*

¹⁷ “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbyshjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.”

¹⁸ Shih paragrafin 13.2. dhe poshtëshënimin nr. 14 më sipër.

*[...] nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes do të ketë natyrshëm përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike [...]*¹⁹.

Dhe:

*[...] Ky parim përfshin midis të tjerave edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë për sipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore [...]. Gjykata çmon se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit [...]*²⁰.

13.7. Në konsideratë të sa më sipër dhe të synimit për të cilin është ngritur sistemi i rivlerësimit, garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, pretendimet e ngritura nga subjekti për cenim të sigurisë juridike, për shkak të veprimeve të mëparshme nga organi i prokurorisë, janë të pabazuara. Procesi i rivlerësimit, përbën një procedurë të pavarur e të pa kushtëzuar nga procedime të tjera dhe ka qenë derivat direkt i nevojës për të shëruar problemet endemike të kulturës së pandëshkueshmërisë së ndërsjellë që kishte zënë vend në sistemin e drejtësisë shqiptare²¹, referuar edhe nga Komisioni i Venecias në analizën e draft ndryshimeve kushtetuese që passollën edhe rivlerësimin.

13.8. Subjekti pretendon në vijim se është ngarkuar me një barrë prove të paarsyeshme meqenëse i kërkohet të justifikojë të ardhurat e rreth 30 viteve më parë, ose pas më shumë se 15 vitesh nga kur ka deklaruar për herë të parë. Trupi gjykues vëren se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Në rrethanat konkrete, shtrirja e kontrollit mbi burimet e krijimit të pasurive gjatë ushtrimit të detyrës është logjikisht e paevitueshme në kushtet që është e pamundur të vendoset një “vijë ndarëse” kohore apo substanciale mes pasurive të deklaruara të krijuara përpara fillimit të detyrës me ato të krijuara më pas, pasi ndërthurja e të dy kategorive është e shumëfishtë. Pasuritë e krijuara gjatë ushtrimit të detyrës kanë pjesërisht zanafillë në pasuritë e deklaruara të krijuara para fillimit të ushtrimit të detyrës. Sikurse Kolegji ka arsyetuar në vendime të mëparshme, në kuptim të parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, rivlerësimi ka objekt kontrolli pasurinë dhe përmes kontrollit të burimit me të cilin është krijuar kjo pasuri institucionet e rivlerësimit analizojnë të shkuarën e një funksionari publik, në funksion të vlerësimit të integritetit të tij/saj, për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike.²²

¹⁹ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 18/2003 dhe nr. 35/2007.

²⁰ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.29/2010.

²¹ Shih: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2015\)045-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)045-e), paragrafi 8.

²² Shih vendimet e Kolegjit që u përkasin subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori, nr. 19/2019, parag. 39; subjektit të rivlerësimit A. Kolgjoka, nr. 8/2020, parag 34.1, ndër të tjerë.

13.9. Ky qëndrim është elaboruar edhe në çështje të tjera të shqyrtuara nga Kolegji, sikurse edhe është konfirmuar në jurisprudencën e GjEDNj-së më pas. Konkretisht, përkundër pretendimeve për cenim të parimit të sigurisë juridike apo të kohës së gjatë që ka kaluar nga deklaratat e para, trupi gjykues i Kolegjit ka theksuar natyrën e veçantë të procesit të deklarimit të pasurive krahasuar me shkeljet disiplinore tipike, të cilat kanë të bëjnë me ngjarje faktike të një momenti, incidentale, të plota në momentin e kryerjes. Shkeljet që lidhen me detyrimin e deklarimit të pasurive apo të mungesës së burimeve janë me natyrë të vazhduar në kohë dhe krijojnë efekte të pandërprera. Procesi i deklarimit, po sipas së njëjtës bazë ligjore, është nga natyra i vazhdueshëm dhe i përbërë nga hallka të një zinxhiri, pasuria e krijuar në vitet paraardhëse shërben si burim krijimi për pasurinë në vitet pasardhëse. Kjo është veçanërisht me rëndësi për dinamikën që përbëhet nga deklaratat para fillimit të detyrës, që shoqërohet më pas vetëm me detyrimin për pasqyrimin e shtesave dhe pakësimeve ndër vite²³.

13.10. Në të njëjtën linjë ka arsyetuar edhe GjEDNj-ja në çështjen kyç *Xhoxhaj*, duke theksuar nevojën që të mos vendosen kufij kohorë pasi një qasje e tillë do të cenonte kapacitetet e autoriteteve për të vlerësuar ligjshmërinë e totalit të pasurive të përfituara nga një subjekt gjatë karrierës së tij profesionale, dhe që për shkak të specifikës që ka vlerësimi i pasurisë përkundër hetimeve të zakonshme disiplinore, “*kërkonin një shkallë më të lartë fleksibiliteti për shtetin e paditur*” për zbatimin e kufizimeve ligjore, në përputhje me objektivin e rikthimit dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin e një niveli të lartë integriteti që pritet nga anëtarët e gjyqësorit. Po aty, GjEDNj-ja ka sjellë në pah edhe nevojën për një kontroll të thelluar pasi në “kontekstin shqiptar [...] verifikimi paraprak i deklaratave të pasurisë nuk ka qenë veçanërisht efektiv [...]”. Së fundmi, po aty, edhe në vlerësimin e GjEDNj-së, ndërthurja e interesave pasurorë mund të jetë objekt interpretimi për të përcaktuar kohën e saktë kur një shkelje e veçantë disiplinore mund të ketë ndodhur në këtë kontekst, e konkretisht, në kohën kur është blerë fillimisht pasuria ose në kohën kur pasuria është deklaruar në një deklaratë periodike²⁴.

13.11. Subjekti i rivlerësimit argumenton edhe që nëse në procesin e rivlerësimit vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për pasaktësi apo shkelje administrative që mund të jenë kryer në deklaratat periodike të pasurisë, dekada më parë, ku ligji i kohës nr. 9049/2003 parashikonte dhënien e masës disiplinore vetëm për refuzimin për deklarim dhe çdo shkelje tjetër kishte si sanksion disiplinor dënimin me gjobë, do të cenoheshin parimet e njohura të procesit të rregullt ligjor “*nullum crimen, nullum poena sine lege*” dhe “*mens rea*”. Edhe këtë pretendim, trupi gjykues e gjen të pabazuar, në kushtet që ai u referohet parimeve të procesit penal, ndërsa procesi i rivlerësimit ka natyrë administrative, përcaktuar i tillë qartësisht për këtë qëllim nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016.

²³ https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendimi-A_Dollapaj-i-anonimizuar.pdf, paragrafët 64.2 dhe 64.3.

²⁴ Shih <https://hudoc.echr.coe.int/>, vendimin e GjEDNj-së, çështja *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, paragrafi 349; çështja *Thanza kundër Shqipërisë*, paragrafi 107.

13.12. Konkretisht, Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 kanë përcaktuar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si një masë të jashtëzakonshme e me natyrë kalimtare, qëllimi i të cilit është të qëndrojnë në detyrë magistratët të cilët rezultojnë të përshtatshëm për të ushtruar funksionin e dhënies së drejtësisë. Neni D i Aneksit të Kushtetutës, materializuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, parashikon se objekt i vlerësimit pasuror është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Ky ka qenë edhe vlerësimi i elaboruar nga GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*. Në analizën e kritereve të vendosura në praktikën e saj gjyqësore, të njohura si “kriteret e Engel-it”, gjykata ka vlerësuar se procesi i rivlerësimit nuk përbën proces penal, bazuar në ligjin mbi të cilin mbështetet, natyrën e veprimeve të marra në analizë, subjektet të cilat i nënshtrohen dhe seriozitetin e sanksionit²⁵.

13.13. Në këtë kontekst, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk është shkarkuar nga detyra për shkak të deklarimeve të kryera në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, por pasi Komisioni ka konstatuar se ai nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas analizës së kryer nën dritën e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 e 5 të ligjit nr. 84/2016. Thënë ndryshe, problematika e konstatuar në vlerësimin e pasurisë së subjektit ka pasur për bazë analizën e kryer për pasuritë e deklaruara prej tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit [vetting] dhe konstatimin se ai ka nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave²⁶. Nga ana tjetër, deklaratat periodike vjetore të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Për rrjedhojë, kontrolli i pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin është objekt i kontrollit të pasurisë gjatë rivlerësimit. Ky kontroll mund të përfshijë edhe krahasimin me deklaratimet ndër vite, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi masa disiplinore e marrë nga Komisioni ka qenë konkluzion i hetimit administrativ të kryer, analizës së deklaratës së pasurisë dhe shpjegimeve të subjektit, nën dritën e kuadrit kushtetues e ligjor të hartuar për rivlerësimin.

13.14. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është shkelur neni 6 i KEDNj-së, pasi gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, sipas kritereve të përcaktuara nga GjEDNj-ja në çështjen *Volkov kundër Ukrainës*: mungesës së përfaqësimit të gjyqtarëve në Komision, mënyrës së zgjedhjes së

²⁵ *Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafin 241 e vijues.*

²⁶ *Pikat 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. [...] 3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj [...]”.*

tyre, si dhe faktit që i njëjti organ heton dhe gjykon. Anëtarëve të Komisionit u ka munguar profesionalizimi dhe eksperiencia e nevojshme për të trajtuar çështjet tepër komplekse, teknike dhe të ndjeshme të procesit të *vetting*-ut. Sipas subjektit, [komisionerja] znj. P. nuk ka 15 vite eksperiencë pune kërkuar nga ligji, ndërsa dy komisionerët e tjerë [znj. S. dhe z. K.], janë të ekspozuar ndaj presionit politik për shkak të punësimit për një kohë të gjatë në organet shtetërore. Së fundmi, përkatësia politike e z. K. rezultoi e qartë nga intervista më datë 02.06.2017, pretendoi po ashtu subjekti. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se edhe ky pretendim është i pabazuar, elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e deritanishme dhe në linjë me arsyetimin e GjEDNj-së në çështjen kyç *Xhoxhaj*.

13.15. Konkretisht, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje së pari, se kuadri kushtetues e ligjor mbi të cilin kryhet rivlerësimi, përfshirë edhe mënyrën e funksionimit të Komisionit, ka kaluar testin e gjykimit kushtetues²⁷ për të cilin ka mbajtur qëndrim edhe GjEDNj-ja në disa vendime për çështje të shqyrtuara mbi bazë të ankimeve të subjekteve të shkarkuara nga detyra me vendim të Kolegjit²⁸. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson që këto pretendime të vlerësuara të pabazuara në vijim të analizës shteruese të kryer edhe nga GjEDNj-ja në çështjen kyç *Xhoxhaj*, përpos theksimit të qëndrimit që ligjshmëria e tyre tashmë nuk mund të jetë objekt kontesti, të mos i shtjellojë më tej në këtë arsyetim.

13.16. Nga ana tjetër, për sa u përket pretendimeve për kriteret e zgjedhshmërisë së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon të risjellë në vëmendje dhe të rikonfirmojë qëndrimin e tij në çështje të tjera. Konkretisht, pasi ka kryer një vlerësim tërësor të gjithë faktorëve, analizuar nën dritën e garancive procedurale të sanksionuara nga Kushtetuta, ligji dhe KEDNj-ja e jurisprudenca e GjEDNj-së, ndër të tjera në çështjen *Astradsson kundër Islandës* dhe *B. Cani kundër Shqipërisë*, trupi gjykues i Kolegjit i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet për këtë aspekt të procesit, duke argumentuar:

[...] trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve, edhe përzgjedhja e

²⁷ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 13.04.2007; nr. 7, datë 11.03.2008; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 23, datë 04.11.2008, dhe vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, ku gjykata ka analizuar se: “[...] Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit [...]; dhe [...] Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...]”.

²⁸ Shih vendimin e GjEDNj-së *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, parag. 314, 316, lexuar së bashku me paragraf. 299-300; *Sevdari kundër Shqipërisë*, parag. 117-199.

anëtarëve të institucioneve pasqyroj vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t'i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj [...]²⁹.

13.17. Subjekti i rivlerësimit pretendon më tej se Komisioni ka qenë i paragjykuar ndaj tij, ka vepruar si gjykatë e jashtëzakonshme dhe nuk u është nënshtuar detyrimeve të Kushtetutës dhe KEDNj-së, nuk ka respektuar rregullat e procesit administrativ dhe ligjit nr. 84/2016, ka tejkaluar rregullat e parashikuara nga ky ligj në ushtrimin e diskrecionit e, për pasojë, ka vepruar në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike. Komisioni nuk i ka dhënë kohë të mjaftueshme për të paraqitur prova, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme nga situata e pandemisë. Për kërkesën e tij në prill 2020, për 45 ditë kohë për të siguruar dokumentacion jashtë vendit, për shkak të pandemisë, ka marrë përgjigje: *Do kthesh përgjigje apo të vazhdoj procedurën?*

13.18. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe këto pretendime janë të pambështetura në fakte. Analiza e akteve në fashikull nuk provon që Komisioni të ketë cenuar të drejtën e subjektit për mbrojtje efektive apo që kjo e drejtë të jetë ndikuar negativisht për shkak të kufizimeve nga situata e pandemisë. Konkretisht, nga aktet në fashikull, rezulton se pavarësisht detyrimit ligjor të shprehur që kishte për të aksesuar adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit³⁰, subjekti është shprehur se nuk e kishte aksesuar e-mail-in për 19 ditë, *për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia, si dhe që e ka aksesuar adresën elektronike vetëm për shkak të një*

²⁹ Shih vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit H. Muçmata, nr. 43/2022 (JR), paragrafi 14.2 e vijues, si dhe vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit E. Trashi, nr. 48/2022 (JR), paragrafi 16.

³⁰ Neni 46 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[3.] Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit. 4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative”.

emergence, duke kërkuar 45 ditë kohë për t'u përgjigjur, përkundër afatit 15-ditor të vendosur nga Komisioni në *e-mail*-in e datës 09.04.2020, e tashmë të tejkaluar për shkak të mosveprimit të tij. Komisioni i ka dhënë mundësinë subjektit për të kthyer përgjigjet edhe *pjesë-pjesë*, ka theksuar detyrimet ligjore të tij [subjektit] për të aksesuar adresën zyrtare të postës elektronike³¹, parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 84/2016, sikurse edhe ka kërkuar një adresë alternative që mundëson akses të përditshëm. Nga *e-mail*-i, rezulton edhe që Komisioni i ka tërhequr vëmendjen subjektit për veprime të përsëritura të mosaksesimit të cilat krijojnë zvarritje. Në datën 12.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka dërguar përgjigjet dhe dokumentacionin përkatës, për të gjitha pyetjet.

13.19. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi po ashtu edhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni, për të vlerësuar nëse procedura e ndjekur ka qenë në përputhje me përcaktimet kushtetuese dhe ato të ligjit të posaçëm nr. 84/2016. Nga aktet, rezulton se për shkak të situatës së pandemisë, Komisioni ka ndërmarrë hapa për të mos cenuar procesin kontradiktor: (i) duke shtyrë me 10 ditë afatin e dorëzimit të shpjegimeve për rezultatet e hetimit administrativ; dhe (ii) në përfundim të hetimit administrativ, ka komunikuar me subjektin për ta informuar për mundësinë për të dhënë shpjegime të tjera. Subjekti ka konfirmuar se shpjegimet e dhëna prej tij ishin përfundimtare dhe nuk ka kërkuar kohë shtesë apo argumentuar problematika të shkaktuara nga situata e pandemisë. Në prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ, sikundër gjatë hetimit administrativ, subjekti nuk ka kërkuar kohë shtesë për të siguruar dokumentacion, por vetëm ka specifikuar pamundësinë e udhëtimit drejt Greqisë për të gjetur punëdhënësit e tij dhe siguruar dokumentacion lidhur me punësimin si emigrant ekonomik. Subjekti ka dhënë të njëjtin shpjegim edhe për pamundësinë e vëllait [F. L1.] për të gjetur dokumentacion për të ardhurat gjatë qëndrimit si emigrant në Kanada.

13.20. Duke qenë që një analizë e detajuar e themelit të pretendimeve për të ardhurat nga emigracioni shtjellohet më tej në vendim, analiza e trupit gjykues në këtë pikë të arsytimit kryhet në funksion të pretendimeve të subjektit me natyrë procedurale. Në këtë kontekst, pasi analizoi të gjitha pretendimet e subjektit, lidhur me pamundësinë e paraqitjes së dokumentacionit justifikues ligjor për të ardhurat nga emigracioni në Greqi, trupi gjykues vëren se procesi i kryer për subjektin në Komision, është i rregullt dhe në përputhje me garancitë kushtetuese, ligjore e të standardeve ndërkombëtare të njohura. Pretendimet e subjektit janë të pabazuara. Ky konkluzion bazohet në arsytimin e shtjelluar në vijim.

13.21. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar vlerën 70.000 euro [shtatëdhjetë mijë euro] *kursime* nga punësimi në emigracion në Greqi në vitet 1991-1996. Këto të ardhura deklarohen si burim krijimi i pasurive të krijuara përpara dhe pas fillimit të detyrës. Subjekti nuk ka sjellë

³¹ *Ibid*, sikurse edhe dy pikat e tjera të neni 46: “1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji. 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, njoftimi bëhet në adresën elektronike private që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji [...]”.

dokumentacion justifikues ligjor lidhur me këto të ardhura bashkë me deklaratën e rivlerësimit *vetting*, pavarësisht detyrimeve kushtetuese, ligjore dhe përcaktimeve të detajuara të tyre nëpërmjet udhëzimit të Inspektorit të ILDKPKI-së³². Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje që subjekti nuk i ka deklaruar këto të ardhura në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës, dorëzuar më datë 24.03.2005³³, me gjithë kujtesën për këtë qëllim në rubrikën e dedikuar për të ardhurat në formular. Gjithashtu, në këtë deklaratë, si dhe në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2006, ku subjekti rideklaron të gjithë pasuritë e tij, të ardhurat nga emigracioni nuk paraqiten si burim për asnjë prej pasurive të deklaruara prej tij.

13.22. Duke iu rikthyer procesit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se subjekti rezulton të ketë qenë inkohorent edhe në vijim, pasi në faza të ndryshme të procesit, pretendimet e tij kanë variuar nga fakti që përjashtohet mundësia e dokumentacionit meqenëse nuk ka qenë pajisur me dokumentacion e leje pune, në pamundësi për të udhëtuar, në vitin 2020, ose kohën e gjatë që ka kaluar e që përjashton ruajtjen nga autoritetet. Konkretisht, ndërsa në pyetësorin e parë subjekti është shprehur se *nuk disponon dokumentacion ligjor nga organet tatimore, pasi nuk ka qenë i pajisur me dokumentacion ligjor nga shteti grek*³⁴, gjatë hetimit administrativ ka pretenduar pamundësi për të udhëtuar e marrë dokumentacion, *për shkak të pandemisë*, ndërsa në ankim sërish shprehet se *ka punuar në kushtet e mungesës së dokumentacionit të punës*³⁵ dhe, po në ankim, referon kohën mbi 20-vjeçare që ka kaluar, e për pasojë mosruajtjen e dokumentacionit nga institucionet tatimore e bankare³⁶.

13.23. Nga këto pohime të subjektit, rezulton qartë që subjekti, përpos kontradiktor, nuk ka pretenduar e provuar pamundësinë objektive për të paraqitur dokumentacion ligjor provues. Përveç faktit që plotësimi dhe dorëzimi i deklaratës së rivlerësimit *vetting* duhet të kishte ndërgjegjësuar subjektin e rivlerësimit për gjetjen e provave që provonin deklaratimet e tij, gjatë procesit administrativ në Komision, pas thujse katër (4) vitesh gjatë të cilave ishte në fuqi kuadri kushtetues e ligjor i rivlerësimit kalimtar që parashikonte detyrime specifike për subjektet për pasuritë e të ardhurat e deklaruara, nën përgjegjësinë e përmbushjes së barrës së provës, por edhe fazat vijuese, subjekti është mjaftuar me deklarin për pamundësinë e lëvizjes për shkak të situatës së pandemisë. As në atë moment procedural të procesit të rivlerësimit, nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur ndonjë dokument, qoftë edhe si indicie e punësimit të tij, qëndrimit në Greqi, fitimit të të ardhurave të një niveli të konsiderueshëm – përreth 20.000 euro në vit, sipas

³² Udhëzimi nr. {***} prot., datë 10.10.2016, i Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së, në pikën 21 përcakton: “Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaramit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë”.

³³ Format i deklaratës nuk është i titulluar “Deklaratë para fillimit të detyrës”, por në të është shenjuar me “x” në kuadratin që përkon me “Deklarim i parë apo para fillimit të detyrës”, plotësuar përtej afatit ligjor 30-ditor nga emërimi, në kushtet që subjekti ka specifikuar si datë emërimi në detyrë, 11.10.2004.

³⁴ Referoju pyetësorit nr. 1, pyetja 1.

³⁵ Shih faqen 25 të ankimit.

³⁶ Shih pikën 96 të ankimit të subjektit të rivlerësimit.

subjektit – sikurse edhe prova të tjera që do të pasqyronin angazhimin e tij për të provuar të ardhurat, nën dritën e detyrimeve kushtetuese e ligjore. Hetimi i Komisionit ka vijuar për disa muaj pasi janë shfuqizuar masat e kufizimit të lëvizjes, ndërsa vendimi është marrë në janar 2021. Qartazi, edhe në harkun kohor në vijim, subjekti nuk rezulton të ketë ndërmarrë hapa për të sjellë dokumentacion, duke u kufizuar vetëm në pretendime deklarative që ka qenë *fakt i njohur botërisht dhe i provueshëm në shumë mënyra*, punësimi i tij në emigracion.

13.24. Në këtë linjë, pretendimet e subjektit që Komisioni duhej të kishte aplikuar parashikimet e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të vlerësonte mosparaqitjen e dokumentacionit për shkaqe të arsyeshme, janë të pabazuara. Jo vetëm që subjekti është *kontradiktor*, por edhe rezulton të mos ketë ndërmarrë asnjë hap për të provuar në ndonjë formë asnjë detaj i cili mund të shërbente qoftë edhe si indicie e pretendimit të tij, nëpërmjet qëndrimit në Greqi, mënyrës së administrimit të kursimeve, ruajtjes e sjelljes në Shqipëri apo veprime të tjera të cilat do të provonin aspekte të veçuara të pretendimeve qoftë të punësimit, sasisë së të ardhurave apo përpjekjeve të tij në funksion të procesit të rivlerësimit.

13.25. Nën dritën e dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, detyrimi për të provuar këtë pretendim i përket vetë subjektit. Pretendimet e subjektit për shkelje të procesit të rregullt ligjor dhe që, sipas pikës 3 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, të pranohet si i mirëqenë një fakt i tillë, si pohim i dëshmitarit apo ekspertit, për sa ato kanë të bëjnë me detyrime të pashlyera prej atij vetë, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pabazuara, dhe qëndrimin e Komisionit të drejtë e të bazuar. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument për të ardhurat e deklaruara, që përjashton automatikisht edhe provueshmërinë e sasisë së të ardhurave, apo ligjshmërinë e gjurmueshmërinë e tyre. Ky vlerësim mban në konsideratë edhe faktin e sipërreferuar që subjekti nuk ka lënë gjurmë të këtyre të ardhurave as në deklaratat e para periodike të tij, qoftë për nga ekzistenca, qoftë edhe si burim krijimi i ndonjë prej pasurive të krijuara deri në atë moment kohor, parë në kontekstin edhe të përcaktimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 për vlerën provuese që mund të marrin deklaratat periodike vjetore. Ndikimi konkret i vlerësimit të këtyre të ardhurave në vlerësimin e kriterit të pasurisë, shtjellohet në arsyetimin e shkaqeve të ankimit që lidhen me themelin e çështjes.

- 14.** Subjekti pretendoi se procesi i zhvilluar për të në Komision, ka qenë në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së pasi nuk është dëgjuar, Komisioni e ka ftuar në seancë dëgjimore pa marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij, nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave të paraqitura, seanca ka qenë tërësisht formale. Po ashtu, sipas subjektit, Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim vlerën provuese të provave të paraqitura, nuk i ka bërë me dije se nga cilat prova ka nxjerrë të dhënat dhe konkluzionet, nuk “dihet roli dhe njohuritë e personit” që ka kryer analizën financiare, sikurse edhe nuk është njohur me analizën e re financiare të kryer pasi ai ka paraqitur provat. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe këto pretendime, në thelb të lidhura të gjitha me parimin e kontradiktoritetit, janë të pabazuara. Nga aktet në fashikull, rezulton që Komisioni ka referuar shpjegimet e provat e paraqitura nga subjekti në raport me provat e tjera të administruara,

përfundimet e nxjerra dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi. Komisioni ka arritur në një përfundim të ndryshëm, që në thelb përbën edhe kontestimin e parashtruar në ankim nga subjekti. Në kushtet që mënyra e arsyetimit bazohet në një vlerësim të ndryshëm të provave dhe nuk konstatohet asnjë veprim i kryer në kundërshtim me garancitë kushtetuese për proces të rregullt, ky pretendim i subjektit u gjet i pabazuar. Arsyetimi i trupit gjykues shtjellohet në vijim.

14.1. Në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka referuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve, si dhe gjetjet për të cilat i ka kaluar barrën e provës sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se për pasuritë objekt kontrolli, *është hetuar administrativisht dhe penalisht*, por nuk rezulton të ketë depozituar akte për procedimet e përmendura. Për rrjedhojë, pretendimi se nuk janë marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij, është i pabazuar. Po ashtu, pretendimi i subjektit për njohje me rezultatin përfundimtar të hetimit përmes *një raporti të ri ku analizohen provat e pranuar apo të rrëzuara, rezultatet e pritshme dhe motivimi përkatës*, përbën një kërkesë që tejkalon parashikimet e dispozitave procedurale dhe materiale të ligjit nr. 84/2016, si dhe të dispozitës së referuar prej vetë subjektit në mbështetje të këtij pretendimi – nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative³⁷. Së pari, ky pretendim nuk gjen mbështetje ligjore në ligjin nr. 84/2016, pasi procedura e rivlerësimit nuk parashikon një dinamikë në të cilën Komisioni e subjektet veprojnë me raporte hetimi të shumëfishta, apo një procedurë në të cilën subjektet kanë mundësi të kontestojnë në seri analizat e kryera e konkluzionet paraprake. Nga përmbajtja e dispozitave që rregullojnë procesin në Komision, rezulton detyrimi i Komisionit për të kaluar barrën e provës për të paraqitur shpjegime shtesë, dhe dëgjimi në seancë dëgjimore. Nëse dinamika e ngjarjeve do ishte ajo e potencuar nga subjekti në ankim, vendimmarrja do të ishte proces i pamundur. Për të shëruar problematika të konstatimeve të gabuara apo shkeljeve procedurale, ligji parashikon të drejtën e ankimit dhe kontrollin që ushtron Kolegji mbi vendimet e Komisionit. Nga ana tjetër, asnjë nga hapat e ndërmarrë nga Komisioni në funksion të caktimit të seancës dëgjimore, nuk rezulton në kundërshtim me nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative. Komisioni rezulton të ketë respektuar të gjitha parashikimet në shtatë (7) germa që pasqyrojnë detyrimet e organit publik për të siguruar njoftimin e palës dhe të drejtën e saj për t'u dëgjuar, ndërkohë që subjekti nuk ka ilustruar cila prej këtyre germave nuk ka gjetur zbatim në seancën publike të caktuar për rivlerësimin e tij.

³⁷ Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 87, parashikon se: “Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64 i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar. 2. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me shkrim apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna: a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës; b) palët e përfshira; c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës, si dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës; d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën e afatin e ushtrimit të kësaj së drejte; dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm. 3. Afati i parashikuar sipas shkronjës “dh” të pikës 2 të këtij neni, nëse nuk parashikohet nga ligji ose aktet nënligjore, përcaktohet nga organi publik, në përputhje me nenin 53 të këtij Kodi”.

14.2. I pabazuar u vlerësua edhe pretendimi i subjektit për shkelje të nenit 49 e vijues të ligjit nr. 84/2016, për shkak të mosrespektimit të procedurës së vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit. Në mënyrë të veçantë, subjekti ndalet tek ajo që sipas tij përbën mosmarrjen në konsideratë të vendimit të Prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. {***} dhe deklaratën noteriale të vëllait të subjektit, hartuar gjatë hetimit administrativ. Pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër, trupi gjykues çmon të konfirmojë që edhe ky pretendim i subjektit, në thelb, konteston qëndrimin e Komisionit për aktet e shpjegimet e subjektit. Së pari, nga aktet nuk rezulton që subjekti të ketë sjellë si provë vendimin e vitit 2015, për pushimin e procedimit penal nga prokuroria. Së dyti, Komisioni ka analizuar deklaratat noteriale të vëllait të subjektit dhe personave të tjerë, por i ka vlerësuar pa peshë provuese për shkak të momentit kur ato janë hartuar. Së treti, vendimi objekt shqyrtimi është në përputhje me parashikimet e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, qoftë në këndvështrim të strukturës, ashtu edhe të përmbajtjes. Vlerësimi i shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej subjektit, në përmbushje të barrës së provës, bëhet nga Komisioni pas zhvillimit të seancës dëgjimore dhe para dhënies së vendimit përfundimtar, qasje që paraqitet në përputhje me parashikimet e nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative³⁸, si dhe të nenit 57, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016³⁹. Në përmbledhje, pretendimi i subjektit të rivlerësimit u vlerësua i pabazuar.

14.3. Trupi gjykues i Kolegjit i gjen të pabazuara edhe argumentet e subjektit në drejtim të vënies në pyetje të saktësisë së analizës financiare për shkak të mosnjohjes së identitetit të hartuesve të saj apo metodologjisë së përdorur, sikurse edhe me argumentimin se ai duhet të njihej sërish me analizën financiare pas provave të paraqitura. Pa ripërsëritur sa është arsyetuar më sipër për mënyrën se si kryhet procesi i rivlerësimit dhe hapat që parashikon ligji, përfshirë edhe ankimin në Kolegj të vendimit të Komisionit, pikërisht për të kontrolluar analizën financiare të hartuar nga Komisioni, trupi gjykues sjell në vëmendje dispozitat e neneve 22 e 23 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtyre parashikimeve ligjore, institucionet e rivlerësimit asistohen nga Njësia e Shërbimit Ligjor, strukturë që përbëhet nga ekspertë me njohuri të thelluara ligjore dhe ekonomike, të cilët studiojnë dosjen nga pikëpamja financiare dhe nga ajo ligjore⁴⁰. Ligji nuk parashikon detyrimin për identifikimin e individit të ngarkuar për të hartuar akte në ndihmë të vendimmarrjes së trupit gjykues. Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, analizat financiare të kryera nga kjo strukturë i nënshtrohen debatit gjyqësor dhe subjekti i rivlerësimit, sikundër në rastin konkret, parashtron

³⁸Neni 48 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton: “Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi”.

³⁹Neni 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “[...] 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsytet mbi të cilat mbështeten vendimet; 29 c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. 5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij”.

⁴⁰Nenet 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016 përcaktojnë veprimtarinë e Njesisë së Shërbimit Ligjor në funksion të ndihmës dhe këshillimit të institucioneve të rivlerësimit dhe kriteret që duhet të përmbushin individët që punësohen, përfshirë arsimimin dhe përvojën e punës.

prapësime e sjell akte në mbështetje të pretendimeve të tij. Vendimmarrja është tagër i trupit gjykues të Komisionit, ngarkuar me short për kryerjen e procesit të rivlerësimit. Ligji nr. 84/2016 nuk parashikon që subjekti i rivlerësimit të njihet me një analizë tjetër financiare pas paraqitjes prej tij të provave dhe shpjegimeve në përmbushje të barrës së provës. Komisioni vlerëson nëse subjekti i rivlerësimit ka arritur të përmbysë barrën e provës dhe, sipas rastit, reflekton korrigjimet përkatëse në analizën financiare që i është përcjellë subjektit, bashkë me rezultatet e hetimit administrativ, duke pasqyruar në vendim analizën e provave dhe përfundimet e analizës financiare. Përmes ankimit, analiza financiare që mbështetet në dokumentacionin financiar të administruar në fashikujt e hetimit administrativ, i nënshtrohet kontrollit nga ana e Kolegjit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar.

14.4. Edhe pretendimi i subjektit që seanca dëgjimore ishte “formale” meqenëse relatimi në seancë dhe rezultatet e hetimit ishin të njëjtë, në shkelje të nenit 48 të ligjit nr. 44/2015, u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit si i pambështetur në ligj. Nga shqyrtimi i akteve në fashikuj, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka administruar të gjitha provat shkresore të paraqitura prej subjektit në përmbushje të barrës së provës, ka shqyrtuar gjendjen e tyre⁴¹ dhe ka vijuar duke caktuar seancën dëgjimore më datë 11.01.2021 dhe kryer njoftimet përkatëse. Në atë seancë, zhvilluar në prani të subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, ky i fundit ka kërkuar riçeljen e hetimit administrativ për vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe për dy kriteret e tjera. Pasi ka shqyrtuar këtë kërkesë, Komisioni ka njoftuar mospranimin e saj. Në vijim, përfaqësuesi ligjor i subjektit ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues, për njëanshmëri. Seanca dëgjimore është ndërprerë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Një trupë tjetër gjykuese e zgjedhur me short, ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues. Seanca dëgjimore ka vijuar në datën 13.01.2021. Subjekti i rivlerësimit *nuk* ka qenë i pranishëm, përfaqësuesi ligjor i tij ka marrë gjithë kohën e nevojshme për të dhënë shpjegimet për rezultatet e hetimit administrativ dhe barrën e provës, duke i dhënë të gjitha mundësitë për parashtrimin e tyre në detaj.

14.5. Në fund, në arsyetimin e vendimit objekt ankimi, Komisioni ka dhënë vlerësimin e tij për shpjegimet e paraqitura nga subjekti gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ, duke përmbushur kështu kërkesat e nenit 48 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative⁴². Nga ana tjetër, relatimi i rezultateve të hetimit administrativ në seancën dëgjimore, ka për qëllim t’i japë mundësi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë për sa është konstatuar, të paraqesë/përmbledhë provat në përmbushje të barrës së provës, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative. Në kushtet që të gjitha këto veprime janë në përputhje me parashikimet e nenit 87 të ligjit nr. 49/2015⁴³, hapat e

⁴¹ *Shih procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, datë 05.01.2021.*

⁴² *Neni 48 parashikon që: “Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi”. Ndërsa neni 47 parashikon që: “Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes”.*

⁴³ *Neni 87, po aty, parashikon: “[...] 1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik [...] njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar. 2. Njoftimi [...] bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban*

sipërreferuar nuk mund të argumentohen si shkak për të pretenduar *apriori* se seanca ishte formale. Për sa më sipër analizuar, duke lexuar në harmoni dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në procesin e hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se pretendimi se seanca dëgjimore është zhvilluar formalisht, është i pabazuar.

15. Subjekti i rivlerësimit pretendoi për shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, pasi shkarkimi nga detyra për të nuk është *proporcional* me qëllimin e ndjekur dhe konkluzionet në të cilat është bazuar. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson edhe këtë pretendim të pabazuar, në konsideratë të rrethanave konkrete. Nga përmbajtja e vendimit objekt ankimi, rezulton se Komisioni ka konstatuar një sërë problemesh që lidhen me kriterin e vlerësimit pasuror nga analiza e *11 pasurive*, të cilat i atribuohen subjektit të rivlerësimit, sikurse edhe një balancë e thellë negative financiare dhe cenim i besimit të publikut, në vlerësimin tërësor. Të gjitha këto rrethana e përjashtojnë edhe teorikisht argumentimin e moszbatimit të masës disiplinore për proporcionalitet. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit u vlerësua haptazi i pabazuar. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion, shtjellohet në vijim.

15.1. Parimi i proporcionalitetit, parashikuar në pikën 1 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ka për qëllim që masa disiplinore të jetë në proporcion me shkeljen e konstatuar. Sikurse ka arsyetuar Kolegji në vendime të mëparshme⁴⁴, proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i rivlerësimit. Zbatuar në rrethanat konkrete faktike e ligjore të vendimit objekt ankimi, trupi gjykues konstaton se nga 14 pasuri objekt kontrolli, për 11 prej tyre subjekti i rivlerësimit Bardhok Lleshi ka dështuar të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ. Komisioni ka konstatuar që subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në një vlerë të konsiderueshme, (-) 19.337.912 lekë⁴⁵, ka kryer deklaram të pasaktë, ka kryer deklaram të rremë për gjashtë pasuri të analizuara, ka kryer fshehje pasurie dhe ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar përkatësisht nga gerrat “b”, “a”, “ç”, “c” dhe “d” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, Komisioni ka vendosur shkarkimin e subjektit për deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe cenim të besimit të publikut, parashikuar nga pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Nën dritën e këtyre vlerësimeve, të para veçmas, sikurse edhe në tërësi,

këto të dhëna: a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës; b) palët e përfshira; c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës; d) informacionin për të drejtën e palës për t’u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte; dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm. 3. Afati i parashikuar sipas shkronjës “dh” të pikës 2 të këtij neni, nëse nuk parashikohet nga ligji ose aktet nënligjore, përcaktohet nga organi publik, në përputhje me nenin 53 të këtij Kodi”.

⁴⁴ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit që u përkasin subjektit të rivlerësimit B. Cani [JR nr. 2/2020], datë 27.02.2020, subjektit të rivlerësimit Fatmir Lushi [JR nr. 20/2020], datë 08.09.2020 dhe subjektit të rivlerësimit Ç. Shahini [JR nr. 36/2020], datë 16.12.2020.

⁴⁵ Sipas analizës përfundimtare, pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, pasqyruar në paragrafin 15.6 të vendimit të Komisionit.

trupi gjykues e gjen të pabazuar kërkesën e subjektit për proporcionalitet, me pretendimin se arsyet mbi të cilat bazohet shkarkimi “nuk janë relevante e as të mjaftueshme për të justifikuar masën e dhënë”.

15.2. Pretendimi tjetër i subjektit fokusohet në pasojën që ka masa disiplinore mbi jetën profesionale të tij, pas vendimit objekt ankimi. Subjekti pretendon se për shkak të shkarkimit nga detyra, ka humbur të gjitha mundësitë për punësim që përkojnë me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale, pasi ai nuk mund të ushtrojë gjithë jetën profesionin e gjyqtarit apo prokurorit, nuk mund të aplikojë për një pozicion pune në administratë publike⁴⁶, nuk mund të jetë noter apo ekspert i pavarur apo të marrë titullin e avokatit⁴⁷. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje që një pretendim i kësaj natyre është analizuar gjerësisht dhe gjetur i pabazuar në vendime të mëparshme⁴⁸, dhe ka kaluar edhe kontrollin e përputhshmërisë me të drejtat që parashikon neni 8 i KEDNJ-së, në vendimin e GjEDNJ-së në çështjen kyç *Xhoxhaj k. Shqipërisë*. Pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht në atë vendim, referuar edhe *Naidin k. Rumanisë*⁴⁹, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje që GjEDNJ-ja ka arsyetuar se ndalimi i përjetshëm për t’u rifutur në sistemin e drejtësisë, i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike, *nuk* është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Kjo është veçanërisht e tillë në kontekstin kombëtar të konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës⁵⁰. Duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit rikonfirmon sa ka konstatuar edhe GjEDNJ-ja, që shkarkimi i subjektit nga detyra nuk ka përbërë shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkueses.

C. *Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

C.1 *Pasuria tokë arë, me sipërfaqe 8.320 m², në Dritas, Tiranë*⁵¹

16. Kjo pasuri është deklaruar e fituar në vitin 2002, në vlerën 832.000 lekë. Pas hetimit administrativ të kryer, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie, duke referuar në mënyrë të shprehur vetëm germën “a” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016⁵². Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga burime të ligjshme dhe të justifikuara me

⁴⁶ Subjekti referon parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

⁴⁷ Subjekti referon parashikimet e germës “f”, neni 13 i ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit”.

⁴⁸ Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit që i përket subjektit të rivlerësimit A. Shema [JR nr. 23, datë 28.06.2022], si dhe arsyetimin, për sa gjen zbatim në vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit E. Kana [JR nr. 39/2020], datë 21.12.2020.

⁴⁹ <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=002-10210>.

⁵⁰ Paragrafi nr. 413 i vendimit *Xhoxhaj k. Shqipërisë*.

⁵¹ Blerë në vlerën 832.000 lekë, në vitin 2002, me burim të deklaruar nga emigracioni.

⁵² Paragrafi 1.14 i vendimit të Komisionit.

dokumentacion ligjor, pasi nuk u provuan të ardhurat nga emigracioni, të referuara si burim. Komisioni ka theksuar edhe që subjekti nuk ka qenë konsistent për sa i përket datës kur është kryer pagesa për pasurinë, ndërsa mungon dokumentacioni për datën ekzakte në kushtet që pagesa deklarohet të jetë kryer *cash* përpara nënshkrimit të kontratës. Subjekti nuk ka deklaruar barrën hipotekore të vendosur mbi pasurinë e tij, si dhe të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Komisioni ka shprehur dyshime për fshehjen e vlerës reale të pasurisë në deklaratën *vetting*, nisur nga kontrata e lidhur me bankën, në të cilën vlera aktuale e pasurisë tejkalon disa herë vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Pretendimet e subjektit se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive dhe që pretendimet e tij për të ardhurat e tij nga emigracioni, duhet të pranohen si fakte të njohura botërisht⁵³, nuk u vlerësuan me peshë.

16.1. Subjekti kundërshton në tërësi këtë konkluzion të Komisionit duke potencuar disa aspekte. Së pari, sipas tij, Komisioni nuk ka specifikuar normën ligjore të shkelur prej tij dhe shkeljen e kryer, sipas kërkesave të nenit 87 të ligjit nr. 44/2015⁵⁴, për atë që përbën gjetjen kryesore – mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor për të ardhurat nga *emigracioni*. Sipas subjektit, konstatimi i Komisionit për deklarime të ndryshme të kohës së krijimit të pasurisë, është në kundërshtim me provat e administruara. Pasuria është krijuar sipas certifikatave të pronësisë, të dorëzuara me deklaratën e rivlerësimit *vetting* dhe deklaratën përpara fillimit të detyrës. Ky konstatim i Komisionit, të cilin subjekti e referon si “gjetje”, përbën përpjekje “denigruese” të qëllimshme për të konsideruar deklaram të rremë kohën reale kur është bërë pagesa. Pagesa është kryer në momentin e hartimit të kontratës së *shitblerjes* dhe regjistrimit të pasurisë në ZVRPP dhe, sipas tij, nuk ka lidhje me “vlefshmërinë” e krijimit të kësaj pasurie të krijuar përpara se të fillonte Shkollën e Magjistraturës (shtator 2002).

16.2. Pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikull dhe analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se vlerësimi i Komisionit është i bazuar. Pikësëpari, nga një lexim logjik i konkluzionit të Komisionit, rezulton që së bashku me germen “a”, do të duhet t’i ishte referuar shprehimisht edhe germen “b” të nenit 33, pika 5. Trupi gjykues e konsideron pa peshë këtë gabim material, duke e parë në kontekstin logjik të rregullimit ligjor. Më tej, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore për procesin e rivlerësimit, me fokus pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, zberthyer edhe në pikën 21 të udhëzimit nr. 4095 të Inspektorit të ILDKPKI-së, subjekti duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe “të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaramit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë”.

⁵³ Referuar pikës 3 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 2 të nenit 32 të të njëjtit ligj.

⁵⁴ Cituar më sipër në poshtëshënimin nr. 43.

16.3. Pamundësia objektive, parashikuar shprehimisht nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përcakton hapa specifike të cilët duhet të ndërmerren në drejtim të vërtetimit të saj⁵⁵. Pa përsëritur sa është shtjelluar gjerësisht më sipër, në paragrafët 13.21 e deri në 13.25, subjekti jo vetëm që nuk mund të argumentojë pamundësinë objektive pasi nuk ka sjellë asnjë dokument apo akt që të vërtetojë përpjekje të tij për të provuar punësimin qoftë edhe të pjesshëm apo me prova rrethanore, por çfarë është më e rëndësishme, ky pretendim nuk gjen zbatim për sa kohë të tilla dokumente, sipas pohimit të tij, nuk ekzistojnë në kushtet që subjekti ka punuar pa leje pune e qëndrimi. Nga ana tjetër, argumenti se punësimi i tij në emigracion, është fakt i njohur botërisht, është i pabazuar dhe krejtësisht deklarativ. Ndërsa migrimi i jashtëm i shumë shtetasve shqiptarë në vitet '90 është fakt i njohur⁵⁶, është alogjik pretendimi i subjektit se meqenëse ky fenomen ka gjetur zbatim për shumë individë të tjerë, ka gjetur zbatim edhe për atë personalisht, ndonëse subjekti nuk solli asnjë provë apo indicie të punësimit, udhëtimit, qëndrimit, të ardhurave që ka fituar, apo transferimin e tyre në Shqipëri.

16.4. Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka provuar të ardhurat e pretenduara nga emigracioni. Pretendimet e tij për pamundësi objektive janë të pabazuara, sikurse nuk gjejnë vend në kushtet që në momente të ndryshme procedurale, subjekti ka parashtruar shkaqe të ndryshme e kontradiktore për mungesën e tyre, përpos faktit që nuk gjen mbështetje, përmes përpjekjesh të kryera prej tij për të marrë konfirmim për pretendimet për krijimin e një shume të konsiderueshme të fituar për pesë (5) vite punë. Subjekti prezumohet të ketë aftësinë profesionale dhe të arsytimit për të kuptuar rëndësinë e përmbushjes së këtij detyrimi kushtetues, e hapat konkretë që do të duhet të kishte ndërmarrë për ta përmbushur atë. Për këto arsye, edhe pretendimi i subjektit lidhur me paqartësi sa i përket raportit të rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, u vlerësua i pabazuar. Në kushtet që subjekti nuk ilustron në çfarë mënyre metodologjia e përdorur paraqiste vështirësi apo mospërputhje, pretendimet për shkelje të nenit 87 të ligjit nr. 44/2015, u vlerësuan të pabazuara.

16.5. Nga aktet në fashikull, rezulton se janë të pabazuara edhe prapësimet e subjektit për sa i përket konkluzionit të Komisionit lidhur me kohën e krijimit të kësaj pasurie. Subjekti ka deklaruar momente të ndryshme gjatë së cilës është kryer pagesa, në tri deklarime të ndryshme. Konkretisht, në deklaratën *vetting*, subjekti është shprehur: *blerë faktikisht në vitin 1998*, ndërsa në deklaratën përpara fillimit të detyrës [që mban datën 24.03.2005], ka referuar si datë 02.07.2002, dhe së fundmi, në deklaratën periodike për vitin 2006, është shprehur se *kontrata është lidhur në vitin 2002 (02.07.2002), por pagesa është bërë në vitin 1997*. Së fundmi, gjatë hetimit administrativ në

⁵⁵ “[...] 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor [...]”.

⁵⁶ Shih ndër të tjera: https://www.instat.gov.al/media/3117/migracioni_n_shqiperi.pdf, <https://albania.iom.int/>, <https://www.renate-europe.net/ep-content/uploads/2019/05/The-study-report-Albanians-and-Migration.pdf>.

Komision⁵⁷, sikurse edhe në ankim, subjekti ka vendosur si kohë pagese atë të vitit 2002, kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes. Subjekti ka shtuar po aty se viti 1998, referuar në deklarin fillistar, është në fakt koha kur palët kanë rënë dakord për transaksionin. Nga sa më sipër, rezultojnë qartë e të provuara mospërputhjet në kohën kur është paguar pasuria, ndonëse në të gjitha variantet, ato referojnë një periudhë përpara se subjekti të emërohej në detyrë, më 11.10.2004.

16.6. Nga sa më sipër, rezulton se në kushtet që në momentin kur subjekti ka hartuar deklaratën përpara fillimit të detyrës, më 24.03.2005, ndarja në kohë e deklaruar prej tij mes dakordësisë e pagesës, ka rëndësi dhe shkak logjik vetëm nevojën për ta ngarkuar vlerën e shpenzuar në një periudhë më të hershme, krahasuar me fillimin e detyrës. Në këtë linjë, trupi gjykues vlerëson edhe deklarinmet gjatë hetimit se pagesa në fakt është kryer në vitin 2002, si një nevojë për të lëvizur shpenzimet në një periudhë kohore më të përshtatshme për procesin e rivlerësimit, dhe jo domosdoshmërisht si pasqyrë e kronologjisë së vërtetë. Kërkesa e subjektit për t'i dhënë peshë deklaratës së pasurisë para fillimit të detyrës, përkundrejt deklaratës së pasurisë të vitit 2006, si rrjedhojë u vlerësua si një materializim i ndryshimit të qëndrimit të subjektit për të përmirësuar situatën e analizës financiare. Në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklarata përpara fillimit të detyrës dhe ajo për vitin 2006 kanë të njëjtën vlerë provuese në procesin e rivlerësimit. Përkundrejt ndryshueshmërisë së deklarinmeve të subjektit, pretendimi për të përdorur si provë vetëm njërën nga deklaratat e pasurisë, vlerësohet i pabazuar. Së fundmi, u gjetën të pabazuara edhe pretendimet e subjektit se si kohë e pagesës, pavarësisht nga sa ai ka deklaruar ndër vite, duhet konsideruar data e hartimit të kontratës, meqenëse palët kanë referuar kryerjen e pagesës *përpara nënshkrimit të kontratës*. Kjo referencë e palëve thjesht tregon që pagesa është kryer përpara se palët të paraqiteshin përpara noterit publik më 02.07.2002. Në kushtet që palët mund të kishin dhënë detaje specifike të mënyrës dhe kohës së pagesës në atë moment kohor, një shprehje e përgjithshme e kësaj natyre shërben vetëm për të konfirmuar shlyerjen e detyrimeve të marra përsipër në momentin në fjalë. Nën përgjegjësinë e buruar nga ligji nr. 9049/2003, subjekti ka deklaruar në mars 2005, se pagesa përkon me datën e kontratës, një vit më pas ka referuar si datë vitin 1997, ndërsa në deklaratën *vetting* është pasqyruar pagesa në vitin 1998. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues vlerëson se përfundimi i Komisionit se subjekti ndryshon deklarinmet e veta në lidhje me datën e kryerjes së pagesës për këtë pasuri, është i bazuar në provat e administruara, ndërsa pretendimet e subjektit për përpjekje denigruese të Komisionit, janë të pabazuara.

16.7. Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi përfundimin e Komisionit lidhur me mosdeklarinmet e *barrës hipotekore* të vendosur mbi pasurinë e tij, si dhe konstatimin për vlerën reale që, sipas Komisionit, është fshehur në deklaratën *vetting*. Në argumentet e tij, subjekti parashtron se

⁵⁷ Në pyetësorin nr. 1, nëpërmjet e-mail-it, datë 06.03.2020, subjekti është shprehur: "Lidhur me dokumentacionin provues se sipërfaqja e tokës 8.320 m² është blerë në vitin 1998, deklarimi im fillistar ka të bëjë me faktin se në atë vit është rënë dakord dhe është mbyllur marrëveshja me palën shitëse për çmimin e shitjes së pronës, ku palës shitëse i është lënë kohë për të përgatitur dokumentacionin në mënyrë që të bëhej transaksioni, por pagesa është bërë në kohën kur është firmosur kontrata e shitblerjes, e dorëzuar me deklaratën *vetting*".

pasqyrimi i këtij veprimi juridik nuk është parashikim ligjor detyrues, sikurse as ndryshimi i vlerës së tregut. Në deklaratën e pasurisë deklarohen të drejtat reale mbi një pasuri të paluajtshme dhe jo të drejtat reale që ka banka ndaj saj.

16.8. Nga aktet në fashikuj, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo pasuri është bllokuar në datën 09.04.2010, në favor të Procredit Bank, për shumën 70.000 euro, është zhbllokuar në datën 15.06.2011 dhe është bllokuar sërish, tashmë në favor të Bankës Kombëtare Tregtare, për shumën 5.000.000 lekë. Në këtë marrëdhënie, subjekti është garantor për një kredi afatgjatë për të pastrehët⁵⁸, marrë nga një prokuror tjetër. Subjekti nuk ka deklaruar këtë marrëdhënie interesi e garancie në deklaratën *vetting* apo në deklaratat periodike. Kuadri ligjor i rivlerësimit, përfshirë formularin në Shtojcën 2, parashikon detyrimin për deklarimin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.), të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e deklarimit.

16.9. Nën këtë dritë, nga një lexim harmonik i gjithë rrethanave ligjore që rregullojnë marrëdhënien e dorëzarisë dhe në funksion të një deklarimi të plotë e shterues, trupi gjykues vlerëson se subjekti duhet ta kishte deklaruar këtë marrëdhënie. Duke mbajtur në konsideratë disa aspekte të kësaj situate ligjore, trupi gjykues vendosi ta vlerësojë mosdeklarimin e kësaj marrëdhënieje detyrimi si një aspekt të qasjes së subjektit në procesin e deklarimit. Konkretisht, meqenëse objekt deklarimi në procesin e rivlerësimit, janë pasuritë dhe *detyrimet financiare* e që sipas Kodit Civil⁵⁹, detyrimet që merr përsipër dorëzanesi, përfshirë kamatëvonesën e shpërblime të tjera, janë të njëjta me ato të debitorit kryesor, fakti që individi i cili ishte debitori kryesor, është po ashtu prokuror, e të dy kanë detyrime për parandalimin e konfliktit të interesave, ishte një ndër aspektet e marra në konsideratë. Nga ana tjetër, marrëdhënia e detyrimit ka passjellë për subjektin kufizimin e të drejtave reale për pasurinë dhe, për pasojë, detyrimin e tij për deklarim të kontratave të hipotekave në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 4 të ligjit 9049/2003, të parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005 lidhur me konfliktin e interesit, si dhe të deklaratës së rivlerësimit *vetting* në kuptim të parashikimeve të pikave 1 dhe 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se dorëzania është një marrëdhënie *besimi* dhe se veprimi juridik i vendosjes së barrës hipotekore për të garantuar kredinë e një personi tjetër pa interes, nuk është objekt deklarimi, vlerësohet prej trupit gjykues, i pabazuar.

16.10. Për sa u përket pretendimeve në drejtim të vlerës reale të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se është i pabazuar përfundimi i Komisionit për *fshehje të vlerës reale* të pasurisë në deklaratën *vetting*. Në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 [deklarata *vetting*], specifikohet që nevojitet përshtetja e hollësishëm i *vlerës në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacion dhe çmimin e blerjes*. Në kushtet që udhëzimi dallon mes vlerës dhe çmimit të blerjes, duket se

⁵⁸ Referuar në shkresën e BKT-së [nr. {***} prot.], dërguar Komisionit në datën 12.11.2020, me të cilën janë përcjellë kontrata e kredisë bankare e datës 23.11.2011 dhe kontrata e hipotekimit e së njëjtës datë, në funksion të huasë së marrë nga z. B. D..

⁵⁹ Nenet 585 e në vijim të Kodit Civil.

ligjbërësi ka pasur parasysh pritshmërinë për deklaram gjithëpërfshirës. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë ndërmarrë personalisht veprime për rivlerësimin e kësaj pasurie. Rivlerësimi rezulton të jetë pasojë e procedurës së ndjekur nga banka në funksion të kredive për të cilat subjekti është dorëzanës. Nga këto rrethana, trupi gjykues vëren se ndonëse logjikisht subjekti nuk mund të ishte i ndërgjegjshëm për vlerën e rritur të pronës në mënyrë të konsiderueshme, meqenëse e ofronte atë si kolateral kundrejt pasurive me vlerë të caktuar, ky mosdeklarim do të vlerësohet në funksion të qasjes së përgjithshme të subjektit ndaj detyrimeve të tij si subjekt rivlerësimi e deklarues. Në vlerësimin e Kolegjit, mosdeklarimi i kontratës së hipotekës, arsyetuar më sipër, së bashku me mungesën e transparencës së treguar nga subjekti, nuk janë të tilla që të vlerësohen si fshehje e [vlerës së] kësaj pasurie, sipas dispozitave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës e ligjit nr. 84/2016. Në vendimin e Komisionit, ky konstatim nuk ka gjetur pasqyrim. Ky vlerësim sillet në vëmendje vetëm në përgjigje të parashtrimeve të subjektit në ankim, përkundër konstatimeve të Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ.

16.11. Në përfundim, nën dritën e arsytimit të shtjelluar më sipër, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë *tokë arë*, në vitin 2002, me sipërfaqe 8.320 m², ndodhur në Dritas/Tapizë, Tiranë, blerë në vlerën 832.000 lekë, me burim nga emigracioni. Subjekti për rrjedhojë gjendet në kushtet e germave “a” dhe “b” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

C.2. Pasuritë tokë arë, me sipërfaqe 11.500 m² dhe 5.120 m², në Tapizë, Tiranë

17. Subjekti ka deklaruar këto dy pasuri në deklaratën *vetting*, në emër të tij, por “të financuara nga vëllai” [z. F. Ll.]. Subjekti ka deklaruar po ashtu se këto pasuri, të blera në vitin 1998, janë regjistruar më 27.02.2002 e vazhdojnë të jenë në emër të tij, meqenëse vëllai ishte emigrant në Kanada e ShBA dhe ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare në momentin e regjistrimit. Vlera e blerjes është deklaruar respektivisht 1.150.000 dhe 512.000 lekë. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë për këtë pasuri dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj, parashikuar nga germat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

17.1. Subjekti i rivlerësimit parashtron se konkluzioni i Komisionit është i gabuar. Pasuritë i përkasin dhe kanë për burim të ardhurat e vëllait, emigrimi i të cilit është fakt i njohur botërisht dhe i provueshëm “në shumë mënyra”. Për pasojë, të ardhurat e tij duhet të merren në konsideratë sipas parashikimeve të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Dokumentacioni për këto të ardhura nuk mund të administrohet për shkak të kohës së largët. Gjatë hetimit administrativ në Komision, për shkak të pandemisë, vëllai e ka pasur të pamundur të udhëtonte për në ShBA dhe Kanada për të marrë dokumentacion nga individë me të cilët ka pasur marrëdhënie kontraktuale pune. Vëllai nuk ka pasur interes financiar për ta shitur pronën e, për rrjedhojë, nuk ka ndërmarrë veprime për ta kaluar në emrin e tij. Mosdeklarimi i barrës hipotekore mbi këtë pasuri, për të garantuar kredinë

e një personi tjetër, pa interes, nuk është objekt deklarimi sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

17.2. Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, si dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të rremë të burimit të krijimit dhe të mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga geramat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk provon financimin e kësaj pasurie tërësisht nga i vëllai apo pronësinë e tij [vëllait, F. Ll.]. Për pasojë, pretendimet e subjektit në këtë drejtim u gjetën të pabazuara. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në detaj në vijim.

17.3. Së pari, nga aktet në fashikuj, rezultojnë e dokumentuar si vijon.

a) Dy parcelat e tokës, me sipërfaqe 11.500 m² dhe 5.120 m², me vendndodhje në Tapizë, Tiranë, janë regjistruar në emër të subjektit në bazë të kontratës së shitjes, datë 29.01.2002⁶⁰. Shitësit kanë deklaruar se kanë marrë jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të kontratës, çmimin e shitjes prej 1.662.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit.

b) Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit i deklaroi pasuritë [sipërfaqet dhe vlerat përkatëse], sipas kontratës së shitjes, ndërsa në deklaratën e pasurisë *përpara* fillimit të detyrës dhe në atë për vitin 2006, i deklaroi si një e vetme, me sipërfaqe 15.000 m² dhe vlerë 1.500.000 lekë. Në deklaratën *vetting* dhe deklaratën periodike për vitin 2006, subjekti deklaroi se prona është blerë nga F. Ll. në vitin 1998. Me deklaratën *vetting*, subjekti ka përcjellë një deklaratë noteriale të të vëllait [z. F. Ll.], hartuar në datën 06.01.2017, nëpërmjet së cilës konfirmohet sa ka deklaruar subjekti në deklaratën *vetting*.

c) Më datë 31.12.2004, subjekti është pajisur me prokurë të përgjithshme përfaqësimi nga vëllai [F. Ll.]⁶¹. Në vijim, subjekti ka kryer veprime juridike në emër të të përfaqësuarit, e konkretisht duke vepruar në cilësinë e shitësit dhe duke përfaqësuar vëllanë në cilësinë e blerësit për një truall ndërtimi me sipërfaqe 7.210 m² në Lezhë, në datën 04.02.2005 [palë shitëse Bardhok Lleshi dhe palë blerëse F. Ll.].

ç) Parcela e tokës/prona me sipërfaqe 5.120 m², sipas dokumentacionit të përcjellë Komisionit nga ASHK, është bllokuar si kolateral për shumën 7.080.000 lekë nga Banka Kombëtare Tregtare, në zbatim të një kontrate hipoteke të datës 27.02.2010.

17.4. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mospërputhjet në sipërfaqen dhe vlerën e pasurive mes deklaratave periodike e asaj *vetting*, janë pasojë e një gabimi përlllogaritjeje të tij, korrigjuar në deklaratën *vetting* dhe nga noteri, me shkrim dore “në kontratën e shitjes”. Ndonëse shpjegimet e subjektit, duke pasur parasysh që kontrata e shitjes ka detajuar në mënyrë specifike qoftë sipërfaqen, qoftë çmimin, trupi gjykues i Kolegjit çmon të mos e analizojë më tej këtë aspekt, duke

⁶⁰ Shkresa e ASHK nr. {***} prot., datë 17.02.2020.

⁶¹ Sipas “General power of Attorney”, datë 31.12.2004, përpara një noteri publik në Toronto, Kanada. Nëpërmjet kësaj prokure, F. Ll., me banim në Toronto, Kanada, i jep tagra përfaqësimi vëllait Bardhok Lleshi, përfshirë por jo kufizuar vetëm në transaksione të pasurive të paluajtshme. Ky akt nuk ka vullë apostile.

e konsideruar një gabim material jopërcaktues në kontekstin e thelbit të shkaqeve të ankimit që nuk lidhen me çmimin apo sipërfaqen e pasurive.

17.5. Nga ana tjetër, nga analiza e dokumentacionit në fashikull cituar më sipër, rezulton që të dyja këto pasuri janë blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2002 dhe vijonin të ishin në emër të tij edhe në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, në janar 2017. Pretendimet e subjektit për arsyet për të cilat ka vepruar në emër dhe për llogari të vëllait, edhe nëse pranohen për vitin 2002, nuk shpjegojnë përse prona nuk u regjistrua në emër “të financuesit” asnjëherë në harkun kohor të ndërmjetëm, ndonëse ai rezulton të jetë kthyer në Shqipëri. Përkundrazi, i njëjti individ [referuar më sipër në paragrafin 17.3/c], i pranishëm në Shqipëri edhe në janar 2017, përpara se të hartohej deklarata *vetting*, ka lëshuar deklaratë noteriale në mbështetje të pretendimeve të subjektit, ndërkohë që logjikisht, nëse vërtet prona ishte e vëllait, ky i fundit mund të kishte ndërmarrë hapat për ta regjistruar atë në emrin e tij.

17.6. Për shkak të arsytimit logjik të mësipërm, fakti që subjekti ka deklaruar që në deklaratën përpara fillimit të detyrës, plotësuar më 24.03.2005, sikurse edhe në atë për vitin 2006, se i vëllai ka tokë truall e tokë arë, respektivisht, apo që ka deklaruar se nuk ka pjesë takuese pasi toka i përkiste të vëllait, nuk u vlerësua me peshë. Përkundrazi, që në atë moment kohor, nëse situata e pronësisë ishte siç subjekti e atribuon, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 9049/2003, dhe sipas kërkesës në formatin e deklaratës për *përshkrim të hollësishëm të pasurisë*, subjekti nuk ka paraqitur asnjë shpjegim përse prona ishte e regjistruar në emër të tij. Së fundmi, edhe për nga vështrimi kronologjik, pretendimi që prona është financuar prej të vëllait me të ardhura të fituara *sapo* ka shkuar emigrant në ShBA apo Kanada në vitin 1998⁶², duket jobindës.

17.7. Në të njëjtën linjë, pretendimet e subjektit se ka vepruar në emër të vëllait madhor, meqenëse ishte në të njëjtën certifikatë familjare, vlerësohen të pakuptimta e të pabesueshme. Të gjitha veprimet juridike që lidhen me krijimin e kësaj pasurie, përfshirë edhe regjistrimin e titujve të pronësisë më 27.02.2002, u kryen nga subjekti, i cili vazhdoi të mbante të drejtat e pronësisë për të paktën 15 vjetët e ndërmjetëm. Për më tepër, subjekti e disponoi pronën me kontratë hipoteke për të tretët në vitin 2010, duke vepruar si pronar. Nga ana tjetër, nga aktet në fashikull, vëllai rezulton të ketë interesa të tjerë financiarë e të banojë në Shqipëri në këtë periudhë kohore, pasi në vitin 2005 ka blerë pasuri të tjera, përfshirë nga vetë subjekti në cilësinë e përfaqësuesit të tij dhe, mbi të gjitha, është regjistruar si person fizik në vitin 2005 në Tiranë. Për gjithë këto arsye, pretendimi i subjektit se ruajtja e pronës në emrin e tij, përfshirë edhe në janar 2017, ka qenë pasojë e largësisë gjeografike të vëllait në vitin 2002, është jobindës dhe i pasinqertë. Edhe nëse ky pretendim do të pranohej teorikisht për momentin e blerjes, si hipotezë garantiste, ai humbet bazën logjike për periudhën kohore pas prokurës së lëshuar në emër të subjektit në dhjetor 2004 e sidomos pasi vëllai i subjektit është regjistruar për të ushtruar aktivitet privat duke filluar nga viti 2005. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit çmon se pretendimet e subjektit se prona i përket

⁶² Momenti kohor nga viti 1998, referuar ndër të tjera në faqen 17 të përgjigjeve të subjektit për rezultatet e hetimit, paraqitur më 19.12.2020.

vëllait, janë të pambështetura dhe analiza financiare për mundësitë e krijimit të tyre iu ngarkua subjektit.

17.8. Në vijim dhe pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht edhe më sipër, në paragrafin 13.21 deri 13.25, për faktin që subjekti nuk ka provuar të ardhurat e tij apo të vëllait nga emigracioni dhe as nuk gjendet në kushtet e pamundësisë objektive, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti dështoi të provojë në çdo formë edhe mundësinë financiare me burime të ligjshme të vëllait për të financuar pronën, mënyrën e transferimit të të ardhurave në një vlerë të konsiderueshme në Shqipëri apo indicie të tjera të kohës për këto të ardhura apo disponimin e tyre. Shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, nuk kanë dhënë qartësi apo arritur të shpjegojnë mungesën e plotë të provave për të ardhurat në fjalë. Konkretisht, gjatë hetimit administrativ në Komision⁶³, subjekti është mjaftuar të specifikojë se nuk ka dijeni për sasinë e të ardhurave të fituara nga i vëllai, dhe që ato janë sjellë në Shqipëri nëpërmjet të njohurve. Subjekti po ashtu ka pretenduar se dokumentacioni ekziston, por ka qenë e pamundur të merrej ndërkohë që vëllai është vendosur në Shqipëri që në vitin 2005. Në kushtet që nga ana tjetër, subjekti pretendon në parashtrime se të ardhurat nga emigracioni, si të ardhura familjare, mbulonin të gjitha pasuritë e krijuara përpara fillimit të detyrës, mospërputhjet në pohimet e subjektit paraqiten jobindëse dhe nuk dëshmojnë përpjekje të tija për të deklaruar saktë burimet e krijimit të pasurive në emër të tij. Përpos sa analizuar më sipër, fakti që subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë në çdo formë mundësinë financiare të vëllait për të financuar këtë pronë, apo mënyrën e transferimit të një sasive të konsiderueshme të të ardhurave në Shqipëri, në periudha të ndryshme kohore, përfshirë edhe ato për blerjen e pasurive të tjera [shtjelluar në vijim], në vlerësimin e trupit gjykues ishte *një ndër* aspektet e rrethanave faktike që passollën konkluzionin se kjo pronë është në fakt e subjektit të rivlerësimit.

17.9. Së fundmi, në kushtet që Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi për mosdeklarimin e barrës hipotekore mbi këtë pasuri, si dhe detyrimet që ai ka lidhur me të, duke mos deklaruar kështu edhe vlerën reale të kësaj pasurie në plotësimin e deklaratës *vetting*, trupi gjykues e vlerëson jorelevante të arsyetojë më tej e konkludojë për sa u përket pretendimeve të subjektit në këtë drejtim.

*C.3. Pasuria apartament, me sipërfaqe 124,1 m², në rrugën “{***}”, Tiranë*

- 18.** Apartamenti në fjalë është deklaruar në deklaratën *vetting* në vlerën 8.034.000 lekë [ekuivalenti i 60.000 eurove] me burim një *kredi*, sikurse edhe 25.000 euro si kështu i parë, paguar në momentin e porosisë [në vitin 2003]. Subjekti *nuk* ka deklaruar burim për kështu i parë në deklaratën *vetting*. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar kryerjen e pagesave për blerjen e pasurisë, si dhe burimin e ligjshëm të tyre, nuk ka provuar se kredia bankare e deklaruar ka shërbyer për blerjen e pasurisë, si dhe ka konstatuar se nuk janë provuar burimet e ligjshme të pagesave të kredisë nga persona të ndryshëm. Komisioni

⁶³ Shih përgjigjen nr. 2 të pyetësorit, datë 9.4.2020

ka konkluduar se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj, dhe ka kryer deklaram të rremë, parashikuar nga geramat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

18.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar konkluzionin e Komisionit. Mosdeklarimi i kontratës së sipërmarrjes dhe pagesave të kryera në zbatim të saj, është pasojë e faktit se në deklaratën fillestare të pasurisë, nuk ka pasur një rubrikë për deklarimin e kontratave të sipërmarrjes, ndërsa shpenzimet e kryera nuk ishin objekt deklarimi sipas parashikimit të ligjit të kohës. Në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2006, ka deklaruar gabimisht detyrimin që ekzistonte ndaj shoqërisë ndërtuese më datë 31.05.2005. Ky gabim është korrigjuar me deklaramet në ILDKPKI në vitin 2007. Përdorimi i të ardhurave të kredisë bankare për blerjen e apartamentit, është provuar nga deklarimet e administratorit të shoqërisë gjatë hetimit penal, si edhe nga informacioni i dërguar nga e njëjta shoqëri në ILDKPKI. Nga hetimi administrativ nuk rezultoi ndonjë e dhënë që likuiditetet e tërhequra nga banka në vitin 2006, të jenë përdorur për ndonjë qëllim tjetër. Pagesat e kësteve të kredisë, kryer nga persona të familjes, kanë burim të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes.

18.2. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është i drejtë. Subjekti nuk provoi në asnjë formë të ardhurat e tij nga emigracioni, të cilat i ka referuar si burim për shlyerjen e pagesës së këstit të parë vetëm gjatë hetimit administrativ. Po ashtu, subjekti nuk arriti të provojë që kredia bankare ka shkuar drejt pagesës së apartamentit, sikurse edhe burimet e ligjshme të pagesave të kësteve të kredisë. Për rrjedhojë, edhe në analizën e kryer në Kolegj, subjekti rezultoi në mungesë burimesh për krijimin e kësaj pasurie. Për sa i përket shlyerjes së kësteve të kredisë nga subjekti dhe personi i lidhur për periudhën kohore 2005-2010, edhe pas korrektimit të analizës së Komisionit kryer në Kolegj, duke gjetur të bazuara disa nga shkaqet e ankimit, subjekti është në mungesë burimesh për të përballuar me burime të ligjshme shpenzimet, për vitet 2006, 2007, 2009 dhe 2010. Një shtjellim i dedikuar i analizës financiare gjendet në pjesën e fundit të këtij arsytimi, pjesë e rubrikës që i përket analizës financiare të periudhës së rivlerësimit. Konkluzioni i mësipërm i trupit gjykues të Kolegjit për këtë pasuri, mbështetet në arsytimin e shtjelluar në vijim.

18.3. Pikësëpari, nga aktet në fashikuj, rezultoi e dokumentuar sa vijon.

- a) Sipas kontratës jonoterialë⁶⁴ të sipërmarrjes, me datë 07.11.2003, ndërtuesi [shoqëria “{***}” ShPK] ka përfunduar dhe u ka dorëzuar porositësve [subjektit dhe bashkëshortes] apartamentin në rr. “{***}” përpara redaktimit të kontratës. Palët kanë rënë dakord për pagesën e çmimit të shitjes prej 60.000 eurosh me këste: kësti i parë prej 25.000 eurosh u pagua para noterit më datë 07.11.2003, diferenca prej 35.000 eurosh do të paguhej nga porositësi sipas marrëveshjes së mëvonshme mes palëve.

⁶⁴ Vërtetuar nënshkrimet e palëve me nr. {***}, datë 07.11.2003, noter Xh. B. H., Dhoma e Noterisë Tiranë.

- b) Kontrata e shitblerjes⁶⁵, datë 06.11.2012, konfirmon kushtet e parashikuara nga palët në kontratën e sipërmarrjes. Çmimi i shitjes së apartamentit, prej 8.034.000 lekësh, i është paguar tërësisht shoqërisë ndërtuese nga blerësit.
- c) Për herë të parë, subjekti ka deklaruar për këtë pasuri në deklaratën periodike për vitin 2006. Subjekti është shprehur tekstualisht: “[...] me kontratë sipërmarrjeje në vitin 2003, nga e cila kam paguar 25.000 euro në momentin e lidhjes së kontratës, [...] në vitin 2004 nuk kam paguar detyrim ndaj firmës. Vlera e apartamentit është 60.000 euro dhe detyrimi ndaj firmës është 35.000 euro”. Në rubrikën përkatëse, subjekti deklaron detyrim të pashlyer prej 35.000 eurosh ndaj shoqërisë ndërtuese, për blerjen e apartamentit.
- ç) Në deklaratat periodike për vitet 2012 dhe 2015, subjekti ka deklaruar blerjen e apartamentit, regjistrimin e tij dhe shlyerjen e detyrimit prej 2.500 eurosh ndërtuesit, si “diferencë e mbetur për blerjen e apartamentit”.
- d) Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pagimi i vlerës është bërë me këste, në momentin e porosisë në vitin 2003, paguar 25.000 euro, ndërsa pjesa tjetër është paguar me kredi”. Subjekti po aty ka deklaruar kredi bankare⁶⁶ në shumën 35.000 euro nga Emporiki Bank, sipas kontratës së datës 23.11.2005, për blerjen e apartamentit [me adresën përkatëse⁶⁷] dhe kredi mobilimi, në shumën 20.000 euro, për të njëjtin apartament. Subjekti ka specifikuar edhe që huaja është shlyer më 15.12.2010.
- dh) Nga aktet rezulton se të dyja huatë janë lëvruar në datën 15.12.2005 dhe tërhequr *cash* nga subjekti në pesë (5) ditë të ndryshme, në vlera të ndryshme, në harkun kohor nga 27.12.2005 deri më 26.10.2006, në një total prej 45.900 eurosh⁶⁸.

18.4. Nga analiza e akteve të mësipërme, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje disa konstatime. Së pari, subjekti ua ka atribuar si burim krijimi shumën prej 25.000 eurosh, të ardhurave nga *emigracioni* për herë të parë në hetimin administrativ në Komision⁶⁹. Në asnjë nga deklaratat periodike apo atë *vetting*, paraqitur në ILDKPKI, qoftë në funksion të ligjit nr. 9049/2003, ashtu edhe në funksion të rivlerësimit, nuk pasqyrohet ekzistenca e përdorimi i të ardhurave nga emigracioni si burim krijimi i pasurisë. Së dyti, asnjë nga tërheqjet në *cash* të transheve të kredive – në pesë ditë të ndryshme mes dhjetorit 2005 e tetorit 2006 – nuk ka shërbyer për të shlyer detyrimin e prapambetur ndaj ndërtuesit. Në kushtet që subjekti deklaron detyrim të pashlyer ndaj ndërtuesit në vlerën 35.000 euro [shih paragrafin 18.3/c] edhe në mars 2007, kur subjekti ka dorëzuar deklaratën periodike për vitin 2006, rezulton⁷⁰ që asnjë nga shumat e

⁶⁵ Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme apartament nr. {***}, datë 6.11.2012, palë shitëse shoqëria “{***} ShPK, palë blerëse Bardhok Lleshi dhe A. P..

⁶⁶ Sipas kontratave, respektivisht nr. {***}, lëvruar më dt.15.12.2005, dhe nr. {***}, lëvruar po më dt.15.12.2005

⁶⁷ Adresa e cituar nga subjekti është: Njësia Admin. Nr. {***}, Blv. {***}, nd. {***}, h. {***}, ap. {***}, Tiranë.

⁶⁸ Datë 27.12.2005 – 15.000 euro; datë 16.8.2006 – 10.000 euro; datë 12.09.2006 – 5000 euro; datë 12.10.2006 – 10.900 euro; datë 26.10.2006 – 10.900 euro.

⁶⁹ Shih përgjigjen nr. 4 të pyetësorit, datë 9.04.2020.

⁷⁰ Neni 32, i titulluar “Deklarimi i pasurisë”, në pikën 5 parashikon: “[...] 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelitit”.

tërhequra në *cash* të kredive, sipas deklarimeve të tij, nuk ka shërbyer kundrejt pagesës për apartamentin. Së treti, rezulton se për herë të parë, subjekti ka deklaruar kredinë si burim krijimi të apartamentit vetëm në deklaratën *vetting*.

18.5. Duke abstraguar nga çfarë tregon zgjedhja e vazhdueshme e subjektit ndër vite për të mos treguar transparencë, pavarësisht detyrimeve të tij ligjore si subjekt deklarues, trupi gjykues i Kolegjit u ndal në analizën e secilit prej burimeve të deklaruara, sikurse edhe atyre të hetuara nga Komisioni në hetimin administrativ. Së pari, nën dritën e arsytimit të shtjelluar më sipër për mungesën e plotë të dokumentacionit për punësimin në emigracion, apo edhe indicieve të të ardhurave të fituara, shtjelluar gjerësisht në paragrafët 13.20 deri 13.25 të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë në asnjë formë burimet e ligjshme për pagesën e kështit të parë për apartamentin në nëntor 2003. Për rrjedhojë, subjekti rezulton me mungesë burimesh për 25.000 euro, të përcaktuara e pranuar nga palët si të paguara.

18.6. Së dyti, janë të pabazuara pretendimet e subjektit për arsyet për të cilat e ka deklaruar marrëdhënien me këtë pasuri vetëm në mars 2007, ndonëse ka jetuar atje nga momenti që ka marrë detyrën⁷¹ dhe e deklaroi adresë vendbanimi në deklaratën përpara fillimit të detyrës 2004. Kontrata e sipërmarrjes, ndryshe nga sa përpiqet të argumentojë subjekti, nuk parashikon ndërtimin e një sendi të ardhshëm, përkundrazi, palët pranojnë se në momentin e lidhjes së saj [nëntor 2003], apartamenti ka ekzistuar materialisht dhe u është dorëzuar porositësve⁷². Me fjalë të tjera, subjekti gëzonte të drejta reale, për të cilat edhe në formular, qartësohet detyrimi për deklarim të pasurive të paluajshme.

18.7. Pretendimi i subjektit se apartamenti është deklaruar në mënyrë të tërthortë nëpërmjet deklarimit të kredisë në një deklaram shtesë në vitin 2007, është po ashtu i pabazuar. Nga aktet në fashikull, në dosjen e ILDKPKI-së nuk rezulton deklarim shtesë i subjektit, sikurse as nuk referohet ai në aktkontrollin e këtij institucioni. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2005, subjekti ka deklaruar kredi bankare [në Emporiki Bank] “për blerje apartamenti” në vlerën 35.000 euro, e marrë në datën 15.12.2005, dhe për mobilim banese në vlerën 20.000 euro, e tërhequr në datën 15.12.2005. Përpos këtij referimi, në deklaratë nuk ka asnjë të dhënë për kontratën e sipërmarrjes për apartamentin, pagesat e kryera, çmimin e dakordësuar apo detyrimet e mbetura të pashlyera, elemente që indirekt do të tregonin veprimet konkrete të kryera në funksion të krijimit të pasurisë, pra, për sa më lart, pretendimet e subjektit vlerësohen si përpjekje për të përmirësuar situatën e tij në rivlerësim. Për rrjedhojë, mbetet fakt i pakontestueshëm që për herë të parë, për ekzistencën dhe posedimin e kësaj pasurie që në momentin e emërimit [në fund të vitit 2004], subjekti e ka deklaruar në mars 2007. Të pabazuara janë edhe pretendimet e subjektit që tenton të reduktojë të drejtat reale mbi apartamentin thjesht si ekuivalent i deklarimit të shpenzimeve. Pagesa e 25.000 eurove dhe marrja në dorëzim e apartamentit lidhen drejtpërdrejt me fitimin e të drejtave reale mbi

⁷¹ Referoju përgjigjeve të subjektit në pyetësorin nr. 1.

⁷² Sipas nenit 2 të kontratës, “Objekti”, me përmbajtje: “Shoqëria “{***}” ShPK, me investimin plotësisht të saj dhe konform legjislacionit shqiptar, ka përfunduar dhe u ka dorëzuar të përfunduar porositësve apartamentin nr. 2.

pasurinë, për të cilën subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003. Nëse logjika do të ishte ajo e potencuar nga subjekti, ligji nuk do të kërkonte deklarim të pasurive dhe të drejtave reale, por thjesht shpenzimet dhe specifikimin e nevojës për kryerjen e tyre. Në përmbledhje të këtij arsytimi, për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues e vlerësoi edhe këtë aspekt të shpjegimeve të subjektit për mënyrën e veprimit, në kontekstin e vlerësimit tërësor të qasjes së tij ndaj detyrimeve ligjore për transparencë.

18.8. Në lidhje me shlyerjen e pjesës tjetër të vlerës së pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se pagesa prej 35.000 eurosh i është bërë shoqërisë “{***}” ShPK gjatë vitit 2006, ndërsa deklarimi i pashlyer prej 35.000 eurosh në deklaratën periodike të atij viti ka qenë një gabim. Subjekti pretendon se ka pasqyruar gabimisht gjendjen e detyrimit një vit më herët, më 31.12.2005. Së pari, rezulton se ky pretendim ngrihet për herë të parë në ankim. Për rrjedhojë, edhe në pamje të parë, saktësimi i një gabimi në këtë moment procedural, 14 vjet pas faktit, duket jobindës. Edhe në leximin rigoroz e harmonik të deklaratave periodike për sa i përket deklarimit të hapave të krijimit të kësaj pasurie, nuk rezultojnë indicie të cilat mund të arsyetoheshin në favor të “gabimit” të pretenduar. Konkretisht, në deklaratën periodike për vitin 2012, subjekti ka deklaruar se: *për blyerjen e apartamentit, janë bërë deklaratimet përkatëse në kohë*, duke konfirmuar se gjendja e detyrimeve dhe shlyerja e tyre sipas deklaratimeve të mëparshme, qëndron. Së dyti, gjatë hetimit administrativ, kur është pyetur specifikisht për detyrimin 35.000 euro, ndaj shoqërisë ndërtuese, dhe të pashlyer deri më 31.12.2006 [në deklaratën periodike për vitin 2006], meqenëse e gjithë kredia rezultonte e tërhequr deri në tetor 2006, subjekti është shprehur se *nuk i kujtohen datat konkrete dhe rëndësi ka që ia ka shlyer detyrimin shoqërisë nëpërmjet kësaj kredie*⁷³.

18.9. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit në ankim për *gabim* në deklarim, janë aspak bindëse. Një detyrim i shlyer në tërësi, në një vlerë të konsiderueshme që përbën më shumë se gjysmën e çmimit të apartamentit, sikurse është 32.500 euro, brenda një viti, nuk është një e dhënë që mund të përbëjë objekt harrese. E thënë ndryshe, subjekti argumenton që ka harruar të deklarojë shlyerjen e 54% të një detyrimi të konsiderueshëm, dhe kërkon për herë të parë saktësimin 14 vjet më pas, në ankimin e vendimit me të cilin u shkarkua nga detyra. Në rast se shumat e kredisë, të tërhequra *cash* gjatë vitit 2006, do të ishin përdorur për shlyerjen e detyrimit, logjikisht pritet që subjekti nuk do të ishte në vështirësi për të kujtuar kohën e kryerjes së pagesave shoqërisë dhe deklaruar në vitin përkatës, kur veprimet janë të freskëta dhe efekti i tyre mbi ekonominë familjare është imediat. Së fundmi, pretendimi i subjektit se ka dërguar deklarim shtesë për vitin 2006, është po ashtu i pabazuar, pasi është deklarativ. Në fashikujt e Komisionit nuk është administruar një akt i tillë. Nga shqyrtimi i aktit të kontrollit të ILDKPKI-së, dërguar në Komision, rezultojnë të dhëna⁷⁴

⁷³ Pyetësori i datës 9.04.2020, në përgjigje të pyetjes për kohën e përdorimit të kredisë nga Emporiki Bank.

⁷⁴ Në aktkontrollin e dërguar në Komision, ILDKPKI-ja pasqyron, ndër të tjera, edhe përmbajtjen e shkresës së DPPP-së nr. {***} prot., datë 09.12.2014, ku rezulton: “[...] nga ILDKPKI jemi informuar ndër të tjera se nga kontrolli i deklaratimeve të interesave privatë të subjektit Bardhok Lleshi, prokuror, kanë konkluduar se ka fshehje të gjendjeve të llogarive bankare në emër të tij dhe të bashkëshortes, e apartamentit me sipërfaqe 125 m², e pagesave

lidhur me konkluzione të kontrollit të deklarimeve të interesave privatë të subjektit, ushtruar në vitin 2014, ndër të tjera edhe për *fshehje të pagesave* shoqërisë ndërtuese [{"***"} ShPK]. Nëse subjekti vërtet do të kishte dërguar një korigjim të tillë, ai do të ishte pjesë e fashikullit dhe pjesë integrale e konkluzionit të ILDKPKI-së pas kontrollit të kryer në vitin 2014. Për gjithë sa më sipër, pretendimet e subjektit janë të pabazuara. Subjekti ka deklaruar detyrime të pashlyera në vlerë të plotë, edhe pasi ishte lëvruar kredia dhe kishte tërhequr gjithë vlerën deri në tetor 2006, ndërsa shpjegimet e mëvonshme janë jo bindëse e të pakuptimta.

18.10. Trupi gjykues konstaton se në kontratën e shitblerjes së apartamentit në vitin 2012, pasqyrohet se çmimi i shitjes së apartamentit prej 8.034.000 lekësh, i është paguar tërësisht shoqërisë [{"***"} ShPK nga pala blerëse [subjekti dhe bashkëshortja] dhe se pagesa e kësaj vlere pasqyrohet në dokumentet përkatëse të palëve. Gjatë gjithë procesit, subjekti nuk rezulton të ketë referuar apo sjellë këto dokumente në mbështetje të pretendimeve apo prapësimeve të tij, në asnjë rast, qoftë edhe me pretendimin se nuk i disponon aktualisht. Nga shqyrtimi i deklaratës së pasurisë të vitit 2006, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje në llogari bankare apo likuiditete *cash*, dhe për sa ka deklaruar të pashlyer detyrimin ndaj shoqërisë [{"***"} ShPK, trupi gjykues krijon bindjen se shumatat e huave të tërhequra *cash* mund të jenë përdorur prej tij për qëllime/aktivitete të tjera, të analizuar në detaj më poshtë.

18.11. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë që kredia bankare ka përbërë burim krijimi të apartamentit. Tërheqjet e shumës së kredisë së lëvruar në pesë (5) momente të ndryshme kohore, nuk u provuan në asnjë formë të kenë shërbyer për të kryer pagesa të detyrimeve të prapambetura nga subjekti kundrejt ndërtuesit. Po ashtu, edhe në deklaratat periodike të kohës, subjekti ka deklaruar se detyrimi vazhonte të qëndronte në vlerën 35.000 euro edhe në 31 dhjetor 2006, pavarësisht se kredia ishte tërhequr në total në atë moment kohor, ndërsa shumatat nuk janë deklaruar të disponuara në *cash* jashtë sistemit bankar. Për gjithë sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sikurse edhe ka kryer deklarim të rremë për burimin e krijimit të saj, parashikuar nga germat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

C.4. Pasuria bodrum me sipërfaqe 600 m², e regjistruar më datë 06.06.2015

- 19.** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting* me burim një *kontratë shkëmbimi* të hartuar më 05.06.2015 me vëllanë e tij [z. S. M.], nëpërmjet së cilës subjekti fiton këtë pasuri kundrejt një toke arë me sipërfaqe 1.200 m² [të ndodhur në Bërxullë, Tiranë]. Pasuria bodrum është regjistruar më 06.06.2015. Komisioni, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe në përputhje me ligjin, se ai nuk ka burime financiare të ligjshme, gjendet në situatën e konfliktit të interesit të paktën në një rast, ka arritur në përfundimin se subjekti ka kryer deklarim të rremë dhe ndodhet në kushtet e germave “a” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

*ndaj shoqërisë [{"***"} ShPK [...], mungon burimi financiar për apartamentin, në vlerë 25.000 euro [...] kanë depozituar kallëzim në Prokurori për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal [...].*

Në këtë vlerësim, Komisioni ka arritur pasi ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare nga të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë tokë arë me sip. 1.200 m², ndodhur në Bërxullë, e të shkëmbyer fillimisht me vlerën e mbetur të kredisë në Emporiki Bank, shtuar më vonë edhe me pasurinë bodrum me sip. 600 m². Shkëmbimi është çmuar të jetë tejet disproporcional referuar vlerave përkatëse të pronave të shkëmbyera dhe pa një logjikë ekonomike. Së fundmi, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, me veprimet e kryera në funksion të shtimit të pasurive të tij, ka shmangur tërësisht pagimin e tatimeve për vlerat e “super shtuara” të pasurisë së tij gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit.

19.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit si tërësisht të pabazuar. Sipas tij, toka arë që ka shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasurie, është blerë më 6.07.1998, me të ardhura nga emigracioni e, për rrjedhojë, është krijuar me burime të ligjshme. Pas nënshkrimit të kontratës së shkëmbimit më datë 05.06.2015, pronësia e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1200 m², ka kaluar te shtetasi S. M. (vëllai i subjektit). Për sa u përket veprimeve të tjera me tokën arë, subjekti potencon se nuk ka pasur detyrim t’i deklaronte në vitin 2005 pasi një kontratë huaje e lidhur [me z. L. N.] nuk është përmbushur prej qiramarrësit/huadhënës. Konkluzioni i Komisionit për të mos pranuar si të vërtetë deklaratën për ndryshimin e kontratës së huasë meqenëse ishte shkresë e thjeshtë, është i pabazuar në provat e administruara [deklarimet e z. L. N. në deklaratën e nënshkruar prej tij, dhe DIPP 2005 ku kjo hua nuk është deklaruar]. Të ardhurat nga kontratat e qirasë janë deklaruar, deklarimi është bërë sipas të ardhurës së përfituar realisht. Në kontrata është parashikuar pagesa e detyrimeve tatimore nga qiramarrësi që është person juridik, në përputhje me ligjin. Në procedimin penal të vitit 2013 [me nr. {***}], në të cilin i dëmtuari kallëzues është ky individ [z. L. N.], nuk ekzistonte asnjë interes privat mes tij dhe të dëmtuarit. Kontrata e huasë lidhur me këtë person në vitin 2005, nuk është ekzekutuar dhe detyrimet reciproke që rridhnin prej saj kishin shumë vite që ishin shuar. Po ashtu, nuk ekzistonte asnjë marrëdhënie detyrimi apo e ndonjë lloji tjetër mes palëve. Rrjedhimisht, nuk qëndron konkluzioni se subjekti ka vepruar në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia. Vlera e tokës arë, me sipërfaqe 1.200 m², në Bërxullë, është rritur ndjeshëm për shkak të rrethanave objektive, si: ndërrimi i zërit kadastral në truall, miratimi për zhvillim, për rrjedhojë disproporcionaliteti nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive.

19.2. Nga aktet në fashikull, analizuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se përfundimi i Komisionit është i bazuar. Në vijim, dhe pa përsëritur arsyetimin e shtjelluar më sipër për të ardhurat e deklaruara nga emigracioni, të cilat referohen si burim edhe për krijimin e pasurisë origjinale, tokë arë në Bërxullë, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e saj. Po ashtu, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson serinë e transaksioneve të pretenduara të kryera qoftë me pasurinë origjinale, apo me atë të fituar nga shkëmbimi, si veprime juridike fiktive, të kryera për të justifikuar të ardhura të deklaruara e me burime të paprovuara. Konkluzioni i trupit gjykues të Kolegjit bazohet në arsyetimin e shtjelluar në vijim.

19.3. Nga aktet në fashikull, rezulton sa vijon.

a. Toka arë është blerë nëpërmjet kontratave të shitjes⁷⁵, datë 6.07.1998. Konkretisht, subjekti ka blerë dy toka bujqësore me sipërfaqe 600 m² dhe çmim 850.000 lekë secila [1.700.000 lekë në total], i likuiduar përpara noterit.

b. Në DPFID, hartuar në mars 2005, subjekti e ka deklaruar pasurinë me sipërfaqen përkatëse, në një vlerë më të ulët sesa rezulton nga kontratat e shitjes, e konkretisht 1.500.000 lekë, dhe krijuar më 17.08.1998. Në deklaratën periodike për vitin 2006, subjekti ka rideklaruar këtë pasuri, me të njëjtat të dhëna sikundër në DPFID 2004. Në asnjë nga këto deklarata, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003⁷⁶, apo referuar në ndonjë formë të ardhurat nga emigracioni.

c. Në datën 28.04.2005⁷⁷, nëpërmjet një kontrate noteriale huaje, një individ, z. L. N., i jep hua Bardhok Lleshit shumën prej 150.000 eurosh, “sot, me nënshkrimin e kësaj kontrate”, me të drejtë rikthimi për dy vjet. Për shumën e marrë hua, huamarrësi [subjekti] vë garanci tokën objekt i kësaj analize. Palët kanë rënë dakord që një kopje e kontratës të mbahet për efekt të bllokimit të pronës për llogari të huadhënësit, deri në likuidimin e huasë prej 150.000 eurosh.

ç. E njëjta tokë ka qenë edhe objekt i një barre hipotekore të vendosur nga Banka Emporiki, në datën 23.11.2005⁷⁸.

d. Më 26.07.2010, subjekti ka nënshkruar një kontratë noteriale sipërmarrjeje [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] me shoqërinë tregtare “{***}” [që i përket të njëjtit vëlla me të cilin ka shkëmbyer këtë pasuri më pas, në vitin 2015, z. S. M.], për ndërtim mbi pasurinë tokë arë. Në të njëjtën ditë, Banka Emporiki ka dhënë miratim për ndërtimin e një objekti mbi pasurinë tokë arë të sipërcituar, sipas lejes së ndërtimit lëshuar nga autoritetet vendore në Bërxullë. Sipas këtyre akteve, leja e ndërtimit me datë 27.07.2010, është lëshuar për një ndërtesë shërbimesh tri kate dhe bodrum, ndërsa një leje e datës 15.06.2010 e KRRT-së, e referon sipërfaqen e sheshit të ndërtimit prej 1.200 m². Në kontratën e sipërmarrjes, palët kanë rënë dakord që me dorëzimin e objektit ndërtimor, pronari i tokës [subjekti] humbet të drejtën e pronësisë mbi truallin, ndërsa ndërtuesi do të shlyejë shumën e mbetur të huasë që ai kishte ndaj Bankës Emporiki.

dh. Subjekti ka lidhur katër (4) kontrata qiraje për pasurinë origjinale, në periudhën kohore nga nëntori 2009 deri në dhjetor 2018, me tre persona të ndryshëm juridikë, me kohëzgjatje të ndryshme kohore dhe me çmime të ndryshme⁷⁹. Në vitin 2010 dhe në deklaratën vetting, subjekti

⁷⁵ Me nr. {***} dhe nr. {***}, me të njëjtën datë.

⁷⁶ Ligji 9049/2003, në nenin 6, me titull “Deklarimi i parë”, parashikon: “Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrimin për deklarim, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre”. Dhe në nenin 9, me titull “Deklarimi para fillimit të punës”, parashikon: “Punonjësit që fillojnë punë për herë të parë në njërin nga funksionet që mbartin detyrimin për deklarim, janë të detyruar të deklarojnë, sipas kërkesave të nenit 6 të këtij ligji”.

⁷⁷ Kontrata e huasë mban numër {***}.

⁷⁸ Kontratë hipoteke nr. {***} rep., nr. {***} kol.

⁷⁹ Kontratat e qirasë janë noteriale e me palët e detajet si vijojnë: me shoqërinë “{***}” për periudhën kohore 13.11.2009 për një vit, me qira mujore 80.000 lekë; me “{***}” ShPK, më 30.04.2011 – për një vit, me qira mujore

ka deklaruar të ardhura në vlerën 720.000 lekë, nga kontrata e parë, ndërsa në deklaratën *vetting* ka deklaruar 960.000 lekë të ardhura nga e njëjta kontratë. Në kontratën më të hershme në kohë, palët kanë rënë dakord që pas afatit njëvjeçar, toka do t'i kalonte në pronësi qiramarrësit. Në të gjitha kontratat e qirasë, pagesa është specifikuar të kryhet në *cash*.

e. Në datën 05.06.2015, subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën noteriale të shkëmbimit me vëllanë, S. M., duke përfituar edhe një bodrum prej 600 m² kundrejt tokës arë në Bërxullë. Në këtë kontratë referohet kontrata e sipërmarrjes e sipërcituar [në shkronjën “d”], sikurse edhe barra hipotekore e vendosur nga Emporiki Bank.

ë. Në datën 05.03.2016, subjekti ka lidhur edhe një kontratë qiraje me “{***}” ShPK, për bodrumin e fituar nga shkëmbimi, për një pagesë prej 1.000 eurosh në muaj e afat të njejtë, deri më 31.12.2018.

19.4. Nga analiza e veprimeve juridike të mësipërme, në kontekst kronologjik, por jo vetëm, rezultojnë disa fakte, nga të cilat trupi gjykues vlerëson se veprimet juridike të kryera nga subjekti me këtë pronë, janë fiktive dhe janë kryer për të mundësuar deklaram të ardhurash, burimet e të cilave nuk provohen me dokumentacion ligjor. *Së pari*, subjekti ka dhënë me qira tokën duke e angazhuar atë si objekt qiradhënieje edhe për tetë (8) vite pasi ajo ishte objekt i një kontrate sipërmarrjeje/ndërtimi. Kjo qasje ka gjetur zbatim për të gjitha kontratat, me përjashtim të së parës. *Së dyti*, qiramarrja nga “{***}” ShPK e një toke arë, duket se është ekuivalentuar me qiramarrjen e një bodrumi, pasi ky i fundit i ka kaluar subjektit. Me fjalë të tjera, duke pasur parasysh ndryshimet thelbësore mes një toke arë dhe një bodrumi, për nga natyra e tyre dhe përdorimi, ekuivalentimi mes tyre për qëllim qiradhënieje merr kuptim vetëm nëse synimi real i palëve nuk arrihet për shkak dhe si përdorim i saj. Në kushtet që subjekti ka vijuar të deklarojë fitime prej kësaj pasurie, kontratat nuk mund të kenë pasur qëllim tjetër, përpos sa materializohet nëpërmjet deklaramit të të ardhurave nga subjekti, e konkretisht, për të krijuar perceptimin e vijueshmërisë së të ardhurave të konsiderueshme të deklaruara. Konkretisht, në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar prej kësaj marrëdhënieje, përfshirë edhe periudhën kohore pasi toka i ishte dhënë për ndërtim shoqërisë së ndërtimit të të vëllait, në total 64.200 euro dhe 960.000 lekë, fituar për shkak të qiradhënieve.

19.5. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerësoi edhe faktin e vlerës së tregut të pasurisë së fituar nga subjekti nëpërmjet shkëmbimit, për të cilën Komisioni është bazuar në çmimet e shitjes së referencës përlllogaritur nga Enti Kombëtar i Banesave. Sipas vlerësimit të Komisionit, përkundër 1.700.000 lekëve të shpenzuara për blerjen e tokës, subjekti ka fituar një pasuri me vlerë konsiderueshëm më të lartë – përreth 18,2 herë më të lartë – sikurse edhe shlyerjen e huave ndaj Bankës Emporiki⁸⁰.

600 euro; dhe sërish me të njëjtën shoqëri, duke nisur nga 19.11.2012 dhe qira mujore 1.000 euro në muaj, me afat nga 01.08.2012 deri më 01.08.2014; me “{***}” ShPK, me kohëzgjatje nga 01.08.2014 deri më 31.12.2018.

⁸⁰ Referuar paragrafit 4.13 të vendimit të Komisionit, sipas të cilit sipërfaqja 600 m², rezulton në vlerën 30.900.000 lekë.

19.6. Po ashtu, trupi gjykues, sikurse edhe Komisioni, çmon të sjellë në vëmendje që kontrata e dytë me “{***}” ShPK, është lidhur nëntë (9) muaj pasi subjekti i kishte humbur të drejtat mbi tokën për shkak të shkëmbimit të saj me bodrumin. Me fjalë të tjera, kontrata me “{***}” ShPK e lidhur për bodrumin me të njëjtat kushte me atë për tokën arë, dhe nëntë muaj pas faktit që subjekti nuk e gëzonte më pasurinë objekt të qirasë origjinale, nuk mund të argumentohet ndryshe përveçse si konfirmim i nevojës së subjektit për të treguar vijimësi të ardhurash, pavarësisht nga statusi/mungesa e të drejtave mbi pasurinë.

19.7. Panorama e mungesës së gjurmëve të kësaj marrëdhënieje nuk ndryshon edhe me konstatimin e kryer në Kolegj për dy mospërputhje në analizën dhe arsyetimin e Komisionit për të ardhurat nga qiraja. Së pari, nuk është i saktë për njërin nga qiramarrësit konstatimi i Komisionit se mungon në tërësi dokumentacioni në administratën tatimore për këto marrëdhënie qiraje⁸¹. Nga aktet e administruara nga Komisioni, rezulton në fakt se njëri prej personave juridikë qiramarrës ka kryer pagesa të pjesshme për tatimin në burim⁸², për periudhën kohore nga 01.07.2011 deri në 01.07.2012 dhe mars-nëntor 2014. Po ashtu, në analizën financiare të kryer për subjektin, Komisioni ka përfshirë të ardhura nga qiraja konsiderueshëm më të larta sesa ai ka deklaruar në deklaratat periodike për vitet 2013 dhe 2015⁸³. Kontratat e qirasë parashikojnë shlyerjen e detyrimit në *cash*, dhe me përjashtim të deklarimit të sipërreferuar, marrëdhëniet juridike të krijuara nuk kanë lënë gjurmë. Me fjalë të tjera, ndonëse të gjithë qiramarrësit janë persona juridikë e, si të tillë, kishin detyrimin ligjor për të mbajtur tatimin në burim, për qiratë e paguara ka vetëm deklarim për dy periudha kohore dhe pagesë të pjesshme, që përbën më pak se 10% të qirasë së paguar. Së fundmi, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me veprimet e njëpasnjëshme me këtë pasuri, përfshirë kontratat e huadhënies apo ato të qirave. Edhe deklarimi i të ardhurave nga subjekti ka qenë i pasaktë. Në deklaratën për vitin 2010, subjekti ka deklaruar 720.000 lekë të ardhura nga qiraja e parë, ndërsa në deklaratën *vetting*, për të njëjtën periudhë kohore, ka deklaruar 960.000 lekë.

19.8. Edhe marrëdhënia e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. L. N., u vlerësua nga trupi gjykues si një veprim juridik fiktiv, i kryer për të mundësuar deklarimin të ardhurash për subjektin. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë disa aspekte. Së pari, ndërsa për lidhjen e kontratës në prill 2005 [referuar më sipër në paragrafin 19.3/c], palët vepruan nëpërmjet një kontrate noteriale, për zgjidhjen e saj, subjekti pretendon se është kryer me një shkresë të thjeshtë, që mban një datë që përkon me një muaj pas lidhjes së kontratës noteriale⁸⁴. Subjekti nuk

⁸¹ Referuar në vendimin e Komisionit, në paragrafët 4.14.1.3 dhe 4.14.4.3, në vijim të korrespondencës mes ILDKPKI-së e Komisionit me DTR.

⁸² Shkresa e datës 23.11.2020 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me nr. prot. {***}, administruar si pjesë e fashikullit nr. 4 të Komisionit, lidhur me kontratat me “{***}” ShPK.

⁸³ Konkretisht, për vitet 2013 dhe 2015, Komisioni ka përlllogaritur përkatësisht 420.000 lekë dhe 965.000 lekë më shumë të ardhura nga qiraja [në total 1.386.120 lekë] sesa ka deklaruar vetë subjekti për këto vite në deklaratim periodike vjetore, siç rezulton nga analiza në faqen 22 të rezultateve të hetimit administrativ.

⁸⁴ Subjekti ka përcjellë gjatë hetimit administrativ një deklaratë të thjeshtë që mban datën 27.05.2005, nëpërmjet së cilës palët deklarojnë se huadhënësi është tërhequr nga dhënia hua e shumës 150.000 euro.

ka deklaruar asnjërin nga këta hapa në deklaratën periodike vjetore. Shpjegimi i subjektit për arsyet për të cilat palët u tërhoqën nga një deklaratë noteriale, shumë pak kohë pasi ajo ishte hartuar dhe nëpërmjet një shkresë dore të thjeshtë, ngre pikëpyetje me rëndësi për vërtetësinë e saj, në tërësi⁸⁵. Së dyti, ky akt i thjeshtë që tenton të zhbëjë marrëdhënien e huasë, është sjellë nga subjekti gjatë hetimit administrativ, pasi atij i është kërkuar të japë shpjegime për të kundërshtuar barrën e provës për veprime të kryera në kushtet e *konfliktit të interesit*, për shkak të marrëdhënies së mëhershme të huasë dhe asaj të qiradhënies duke filluar nga viti 2014. Konkretisht, ka rezultuar se subjekti ka pranuar të shqyrtojë në vitin 2013 procedimin penal, bazuar në kallëzimin e bërë nga ky individ, me të cilin kishte pasur një marrëdhënie interesi (huamarrjeje) më herët në vitin 2005, ndërsa në vitin 2014 ka lidhur kontrata qiraje. Së treti, shpjegimet e subjektit se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit, meqenëse huaja nuk u realizua, bien ndesh me sa palët kanë pasqyruar shprehimisht në kontratën noteriale të huasë. Një krahasim i thjeshtë mes pretendimeve të subjektit për shkaqet që passollën zgjidhjen e kontratës nëpërmjet shkresës së thjeshtë për të revokuar një kontratë noteriale, dhe sa palët kanë përcaktuar në atë kontratë, tregon mospërputhje të qenësishme. Përcaktimet kontraktuale se: [...] *L. N. i jep hua shumë 150.000 euro [...] sot me nënshkrimin e kësaj kontrate [...]*, provojnë të kundërtën e pretendimeve të subjektit në hetimin administrativ. Në kushtet që me vullnet të lirë, palët janë shprehur që huadhënësi *e dispononte* shumë e huasë dhe *ia ka dorëzuar* atë huamarrësit [subjektit] në momentin e nënshkrimit të kontratës, shpjegimet e subjektit për të pretenduar të kundërtën për të dyja këto aspekte, janë jobindëse. Nëse situata faktike ishte ajo e pretenduar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, nuk ka ndonjë shkak ligjor për të cilin palët, përfshirë subjektin magjistrat, nuk e kanë pasqyruar atë në kushtet kontraktore. Përkundrajt kontratës, e cila në kuptim të parashikimeve të nenit 690 të Kodit Civil, ka forcën e ligjit për palët, dhe referuar në nenin 1050 të Kodit Civil⁸⁶ për konceptet thelbësore e bazike të huadhënies, pretendimi i subjektit se në fakt shuma e rënë dakord nuk ekzistonte apo kontrata u lidh për të siguruar një veprim juridik në të ardhmen, vlerësohet tejet jobindës e i pakuptimtë.

19.9. Fakti që subjekti nuk e ka deklaruar këtë kontratë apo zgjidhjen e saj në deklaratën periodike vjetore të kohës, do të kishte peshë në vlerësimin e Kolegjit nëse ky fakt do të përbënte të vetmen marrëdhënie juridike të padeklaruar prej tij. Ndërkohë, në kushtet që subjekti i rivlerësimin, siç është arsyetuar në këtë vendim, ka zgjedhur të mos deklarojë edhe interesa të tjera privatë të krijuar e të pranuar edhe prej tij, sikurse kontrata e sipërmarrjes në apartamentin në

⁸⁵ Në përgjigje të pyetësorit të datës 13.11.2020 dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ. Sipas subjektit, z. L. N. kishte për qëllim blerjen e pronës, do të siguronte shumë prej 150.000 eurosh dhe kontrata është përpiluar për të siguruar se pronë nuk do të blihej nga dikush tjetër për një periudhë kohore njëmuajore, gjatë së cilës ai do të siguronte shumë e parave. Pronë nuk është bllokuar në ZRPP Tiranë, siç përcaktohet në kontratë, pasi z. N. ka hequr dorë nga kontrata.

⁸⁶ Neni 1050 i Kodit Civil përcakton se: “Me kontratën e huasë njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t’i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit”.

Tiranë, pagesat e kryera në deklaratën periodike të kohës reale, apo mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurive, ndër të tjera, ky fakt nuk vlerësohet me peshë në rrethanat konkrete. Po ashtu, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se provat vlerësohen në harmoni. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit që tenton të potencojë deklaratimet e tij periodike si provë për versionin e fakteve të paraqitura prej tij në prapësim të një konkluzioni të pafavorshëm për të nga Komisioni.

19.10. Komisioni ka konkluduar se qoftë kontrata e huasë e vitit 2005, apo kontratat e mëvonshme të qirasë prej vitit 2014, me të njëjtin individ, e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit dhe, për pasojë, subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia në kushtet që ka pranuar të shqyrtojë në vitin 2013, procedimin penal për kallëzimin e bërë nga L. N.. Komisioni ka konstatuar⁸⁷ që në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, ka regjistruar procedim penal për veprën penale “përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, me kallëzues këtë individ. Pasi i dëmtuari/kallëzues [z. L. N.] ka hequr dorë nga ankimi, me vendimin e datës 01.07.2013, subjekti ka vendosur pushimin e hetimeve. Subjekti pretendon se do të ishte në kushtet e papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës nëse kontrata e huasë do të ishte ekzekutuar.

19.11. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i drejtë arsyetimi i Komisionit që subjekti nuk ka provuar shuarjen e marrëdhënies së interesave të krijuar nëpërmjet huasë së vitit 2005 mes subjektit dhe z. N.. Për pasojë, në shqyrtimin dhe kryerjen e procedimit penal të vitit 2013 në të cilin ky individ ishte kallëzues, subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005⁸⁸. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh edhe faktin që ky vlerësim i Komisionit ka qenë pjesë e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues çmoi ta vlerësojë edhe këtë konkluzion në mënyrë integrale me arsyetimin më sipër, në kontekstin e fiktivitetit të marrëdhënies së qirasë së subjektit me shoqërinë tregtare të këtij individi duke filluar nga viti 2014, për të justifikuar të ardhurat në vlerë të konsiderueshme, të deklaruara nga qiratë. Në këtë kontekst, trupi gjykues vëren se marrëdhënia mes subjektit të rivlerësimit dhe këtij individi është e vazhdueshme, dhe shpjegimet e subjektit për rrethanat faktike në të cilat kanë ndodhur veprimet juridike, mbetën deklarative e jobindëse.

19.12. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues konstaton se leja për shesh ndërtimi për sipërfaqen prej 1200 m², është miratuar një muaj përpara lidhjes së kontratës së sipërmarrjes mes subjektit dhe shoqërisë investitore “{***}” ShPK, me kërkesë të kësaj shoqërie⁸⁹. Për dhënien e lejes së ndërtimit, janë administruar edhe akte të tjera administrative⁹⁰, në të cilat, si kërkues evidentohet

⁸⁷ Referuar nga informacioni i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, përcjellë në Komision.

⁸⁸ Sipas nenit 3 të ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”: “[...] a) “konflikt faktik i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare [...]”.

⁸⁹ Vendimi nr. {***}, datë 15.06.2010, i KRT Komuna Bërxullë.

⁹⁰ Formulari 3, “Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike”, me konfirmimet përkatëse për lidhjen e tij me rrjetin elektrik, ujësjellës-kanalizime dhe telefonik.

në mënyrë nominale, me emër, mbiemër dhe nënshkrim vetë subjekti i rivlerësimit. Sa më sipër, në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, palët kanë qenë në dijeni të zhvillimit të pronës, vlerës së shtuar të saj për këtë shkak, dhe me vullnet të lirë kanë caktuar kushtet në kontratën e sipërmarrjes. Leja e përdorimit të objektit është lëshuar nga Komuna Bërxullë me shkresën nr. {***} prot., datë 05.06.2015, dhe në po të njëjtën datë, mes S. M.⁹¹ dhe subjektit është lidhur kontrata e shkëmbimit, ku palët kanë shprehur vullnetin për të ndryshuar kushtet e kontratës së sipërmarrjes, duke rënë dakord që në shkëmbim të truallit, subjektit t’i kalojë një sipërfaqe ndërtimore prej 600 m² në katin përdhes. Në aspektin substancial, ndryshimi i vullnetit të palëve për shtim të përfitimeve të subjektit, në momentin kur objekti kishte përfunduar së ndërtuari, ndërkohë që sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2010, palët kishin shprehur vullnetin se pronarit të tokës [subjektit] i hiqej e drejta e pronësisë mbi truallin me ndërtimin e objektit, dëshmon për një devijim të kushtit thelbësor të kontratës së vitit 2010 në favor të interesave privatë të subjektit. Duke referuar vlerën mesatare të sipërfaqes ndërtimore të përfituar nga subjekti, prej 30.900.000 lekësh [sipas llogaritjes nga Komisioni]⁹², si përfitim i shtuar krahas shlyerjes së vlerës së huasë nga viti 2010, trupi gjykues vlerëson se veprimet juridike në shkëmbimin e pasurisë tokë arë me sip. 1200 m², kanë krijuar përfitime pasurore shumë më të mëdha për subjektin, duke devijuar dukshëm nga raportet e shkëmbimit të aplikuara mes pronarit të tokës dhe palës investitore. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se shkëmbimi është disproporcional në vlerat përkatëse të pronave të shkëmbyera dhe pa një logjikë ekonomike.

19.13. Në përfundim, lidhur me pasurinë *bodrum* me sipërfaqe 600 m², trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të rremë dhe mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, parashikuar nga germat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, përfundimi i Komisionit është i drejtë, ndërsa pretendimet e subjektit, sikurse është analizuar gjerësisht më sipër, u vlerësuan të pabazuara.

*C.5. Pasuria automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {***} K*

20. Subjekti ka deklaruar 11.000 euro të ardhura nga shitja e këtij automjeti në deklaratën *vetting*. Shitja është kryer në datën 16.01.2010, ndërsa blerja më 25.09.2004 në vlerën 5.000 euro. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka kryer deklarim të rremë në lidhje me këto të ardhura dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen, parashikuar nga germat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Këto konkluzione të Komisionit bazohen në faktin që subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit në vlerë thujse dy herë më të lartë, gjashtë (6) vite pas blerjes. Po ashtu, ndonëse e paspecifikuar në vendim, në vlerësimin e mungesës së burimeve për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni ka pasur parasysh që subjekti nuk ka provuar të ardhurat nga

⁹¹ Me kontratë bashkëpunimi dhe sipërmarrje ndërtimi, nr. {***}, datë 05.02.2015, ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. S. M., shoqëria në pamundësi financiare, ka hequr dorë vullnetarisht si investitore e objektit, duke ia kaluar të drejtën tërësisht S. M., i cili ka marrë përsipër investimin e ndërtimit dhe kryerjen e të gjitha procedurave për regjistrimin e objektit në ZVRPP.

⁹² Përlllogaritja referon çmim të shitjes për sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 51.500 lekë/m², sipas udhëzimit të EKB-së nr. 4, datë 30.9.2015. Vlera e blerjes 60.000 euro, konvertuar me kursin mesatar të BOA-s për vitin 2003.

emigracioni, deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike për vitin 2004. Komisioni ka potencuar edhe që subjekti nuk ka paguar detyrimet tatimore që lindin nga fitimi në shitje i shumës 6.000 euro.

20.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit dhe pretendoi se në fakt, vlera e automjetit në blerje ka qenë përreth 12.000 euro, ndërsa çmimi 5.000 euro, i referuar nga palët në kontratë, ka qenë kërkesë e shitësit. Nuk ka pasur detyrime tatimore në kushtet që vlera e blerjes është më e lartë sesa ajo e shitjes.

20.2. Nga aktet në fashikuj, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë të vlerës së fituar nga shitja dhe mungesë burimesh për blerjen e këtij automjeti, është i bazuar. Pretendimet e subjektit janë deklarative, në kushtet që nuk mbështeten nga asnjë dokumentacion, përfshirë deklaratat periodike vjetore apo kontratën e shitjes që, nën dritën e dispozitave të Kodit Civil, ka forcën e ligjit dhe prezumohet të përmbajë kushtet kontraktore për të cilat palët kanë rënë dakord me vullnet të lirë. Për sa u përket të ardhurave nga emigracioni, trupi gjykues referon pa përsëritur e konfirmon arsyetimin e shtjelluar më sipër.

20.3. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban parasysht disa aspekte. Së pari, përpos çmimit të rënë dakord nga palët në kontratë, edhe subjekti e ka deklaruar vlerën e automjetit 5.000 euro në deklaratën e parë të pasurisë, në mars 2005. I njëjti çmim është deklaruar prej tij edhe në deklaratën periodike për vitin 2006. I vetmi ndryshim në këtë të fundit është që tashmë janë specifikuar si burim krijimi të ardhurat nga emigracioni. Subjekti nuk ka sjellë kontratën e blerjes së automjetit në vitin 2004. Në përmbledhje të këtyre akteve, rezulton që pretendimi i subjektit për një vlerë të ndryshme, 220% më të lartë në blerje sesa ajo e cituar nga palët, nuk u provua me asnjë dokument. Përkundrazi, deklaratat periodike të subjektit që në procesin e rivlerësimit përbëjnë provë, sikurse kontrata e shitjes që ka fuqinë e ligjit për palët, provojnë që pretendimi i subjektit në deklaratën periodike për vitin 2010 e në deklaratën e pasurisë *vetting*, për fitimin e vlerës 11.000 euro, janë të pambështetura në akte.

20.4. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje që dakordësia për një çmim shitjeje mbi dyfish më të lartë sesa ai i blerjes gjashtë (6) vite më herët, kryhet (i) ose në funksion të deklarimit të të ardhurave të fryra/shtuara në funksion të legjitimitetit të të ardhurave me burime të panjohura në vitin 2010, ose (ii) nënkupton që çmimi i blerjes ishte më i lartë sesa ai i vendosur në kontratën e vitit 2004, por është ulur në mënyrë artificiale për të mënjeluar problematikën me mungesën e burimeve në momentin e blerjes. Në analizën e kryer në Kolegj në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, u mor në konsideratë vlera e mjetit sipas kontratës së shitblerjes në vitin 2004, në vlerën 5.000 euro. Subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e kësaj pasurie edhe për këtë vlerë, nën dritën e arsyetimit të shtjelluar më sipër për karakterin krejtësisht deklarativ të të ardhurave të pretenduara, të fituara nga subjekti gjatë viteve 1991-1996 si emigrant në Greqi. Për gjithë sa më sipër, subjekti ka kryer deklarim të rremë për këtë pasuri dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e saj, nën dritën e parashikimeve nga geramat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

C.6 Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë “{***}” ShPK

21. Subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshortja kanë deklaruar në deklaratën *vetting* zotërimin e kuotave në një shoqëri tregtare: (a) në zotërim të subjektit 60% të kuotave, blerë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë; dhe (b) në zotërim të bashkëshortes 40% të kuotave në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë. Burimi i krijimit është deklaruar përkatësisht, të ardhurat nga emigracioni dhe të ardhurat e personit të lidhur nga mësimdhënia.

21.1. Përpos faktit që për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar saktësisht vetëm në deklaratën *vetting*, Komisioni ka konkluduar edhe që ai [subjekti] ka kryer deklaram të rremë dhe nuk ka provuar burimet e ligjshme të krijimit të shumës, parashikuar në geramat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, Komisioni ka potencuar faktin që blerja e kuotave në vitin 2011 ka qenë në vlerë minimale, ndërkohë që shoqëria kishte fitime të konsiderueshme, të riinvestuara dhe kishte rritur kapitalet e saj. Pretendimi i subjektit se shoqëria nuk kishte asnjë pasuri të regjistruar dhe vlera e kapitaleve ishte vetëm 100.000 lekë, është vlerësuar i paarsyeshëm. Komisioni po ashtu ka arsyetuar se me veprimet e tij, nëpërmjet pjesëmarrjes në status pasiv në këtë aktivitet tregtar fitimprurës të vëllëzërve, ka për qëllim ndikimin e tij nëpërmjet detyrës, e me veprime indirekte, cenon besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Së fundmi, Komisioni ka theksuar që gjatë ushtrimit të detyrës, subjekti ka shumëfishuar pasuritë e tij, në vlera të karakterit tregtar e që nuk i shkojnë për shtat një funksionari të drejtësisë.

21.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit si tërësisht të gabuar, duke theksuar se burim kanë qenë të ardhurat e vitit 2011. Specifikimi se burim kanë qenë të ardhurat nga emigracioni, ka qenë gabim material dhe në kushtet që në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës, nuk ka deklaruar gjendje *cash* apo likuiditet në bankë me këtë burim, deklarimi i tyre si burim do të ishte jologjik. Kuotat e blera më datë 31.08.2011, i zotëron në mënyrë pasive, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9367/2005 dhe vlera me të cilën ka paguar kuotat është derivat i vlerës së kapitalit të shoqërisë në momentin e blerjes së tyre, prej 100.000 lekësh. Fitimet e shoqërisë ishin të pashpërndara. Konkluzioni i Komisionit se ka pasur për synim të ndikonte në veprimtarinë tregtare fitimprurëse nëpërmjet figurës së tij si prokuror, nuk mbështetet në asnjë parashikim ligjor apo të dhënë të administruar gjatë hetimit administrativ. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005, magjistratët janë të lejuar të zotërojnë kuota të shoqërive tregtare.

21.3 Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e kuotave. Pretendimi se specifikimi i burimit të krijimit si të ardhura nga emigracioni në deklaratën *vetting*, është gabim material, u vlerësua i pabazuar, duke pasur parasysh konsistencën e përgjigjeve të dhëna gjatë procesit për këtë aspekt. Vlera e shitjes e kuotave të shoqërisë subjektit të rivlerësimit, ndonëse formalisht është në përputhje me vlerën e kapitalit të shoqërisë, ka passjellë në thelb transferimin e fitimit të pashpërndarë, i cili ka qenë i konsiderueshëm. Edhe në këtë rast, trupi gjykues konstaton

vendosje çmimesh fiktive, në favor të interesave të subjektit të rivlerësimit. Në vijim shtjellohet arsyetimi i Kolegjit mbi të cilin u bazua ky konkluzion.

21.4 Pikësëpari, nga aktet në fashikuj, rezulton sa vijon.

a. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar zotërimin e 60% të aksioneve të shoqërisë “{***}” ShPK dhe ka referuar dy kontrata noteriale shitblerjeje të datës “31.11.2011”⁹³, me vlerë në total 60.000 lekë. Burim krijimi janë deklaruar të ardhurat nga emigracioni. Personi i lidhur/bashkëshortja ka deklaruar zotërimin e 40% të aksioneve në të njëjtën shoqëri, me vlerë 40.000 lekë dhe burim krijimi të ardhurat nga mësimdhënia. Subjekti nuk ka deklaruar një vlerë të të ardhurave, dhe të dy deklaruesit janë shprehur se të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i kësaj shoqërie janë pasqyruar në dokumentacionin përkatës të organeve tatimore, janë riinvestuar dhe nuk është tërhequr dividendi.

b. Në deklaratën periodike për vitin 2007, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja është administratore dhe zotëron 40% të “{***}”. Po aty, subjekti ka deklaruar se shoqëria ka filluar aktivitetin privat në datën 22.06.2007, në fushën e ndërtimit, dhe sipas deklaramit, nuk ka realizuar fitime, pasi nuk është bërë ende bilanci i fitimit.

c. Në deklaratën periodike për vitin 2011, subjekti ka deklaruar blerjen e kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK, në total 60%, nëpërmjet kontratave noteriale të datës 31.08.2011, në vlerën 60.000 lekë, përkatësisht nga F. Ll. dhe N. M. [në pjesë të barabarta, përkatësisht vëllai dhe kunati i subjektit].

ç. Referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, Komisioni ka konstatuar se shoqëria “{***}” ShPK është krijuar më 21.12.2006, dhe personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit figuron një prej ortakëve dhe administratore e shoqërisë. Nga i njëjti burim, ka rezultuar ndryshimi i statusit të ortakëve duke filluar nga data 30.12.2015, në zbatim të ndalimeve që parashikonte ligji nr. 9367/2005⁹⁴ për subjektin. Në vijim të këtij ndryshimi, një individ tjetër ka marrë cilësinë e personit të besuar prej ortakëve, subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortes që tashmë kanë fituar status pasiv në këtë aktivitet. Nga hetimi administrativ i kryer në Komision, ka rezultuar se shoqëria nuk ka shpërndarë asnjëherë dividend⁹⁵. Komisioni referon edhe veprime të kryera për shitjen e filialit në Kosovë më 26.05.2010, për efekt të lidhjes së ngushtë të bashkëpunimit mes subjektit dhe vëllait në këtë aktivitetet tregtar.

21.5 Nga sa më sipër, rezultojnë disa fakte. Së pari, subjekti ka referuar për herë të parë në deklaratën *vetting*, të ardhurat nga emigracioni si burim krijimi i pjesës së tij të kuotave. Duke mbajtur në konsideratë analizën e shtjelluar gjerësisht më sipër, trupi gjykues vlerëson të mos përsërisë konstatimin për mungesën provueshmërisë së ekzistencës së këtyre të ardhurave, ligjshmërisë së tyre apo sasisë së përfituar që pretendohet. Së dyti, subjekti e ka deklaruar përfshirjen e bashkëshortes në këtë shoqëri një vit pasi i lindte detyrimi në zbatim të ligjit nr.

⁹³ Data riprodhuar tekstualisht sikurse është referuar nga subjekti në faqen 6 të deklaratës “*vetting*”.

⁹⁴ “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

⁹⁵ Referuar shkresës nr. prot. {***}, datë 13.02.2020, dërguar Komisionit. Referuar në paragrafin 6.11 të vendimit e në vijim.

9049/2003. Pavarësisht nga deklarimi i pjesëmarrjes, të ardhurat si administratore në deklaratat periodike të pasurisë të viteve 2007, 2008 dhe 2012, nuk janë deklaruar. Së treti dhe me peshë të veçantë në procesin e rivlerësimit, argumentet e subjektit për vlerën modeste të shpenzuar prej tij për blerjen e kuotave, janë jobindëse, sikurse është jobindës edhe kufizimi i arsytimit të tij për ndërthurjen e interesave me të vëllanë në faktin që shoqëria e tij dhe ajo në emër të vëllait nuk kanë pasur projekte të përbashkëta apo përfituar koncesion publik.

21.6 Nga të ardhurat dhe fitimet, referuar dokumentacionit zyrtar të administruar gjatë hetimit administrativ nga administrata tatimore⁹⁶, rezulton se në periudhën kohore menjëherë përpara dhe pas blerjes së kuotave nga subjekti, shoqëria tregtare e subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortes ka deklaruar fitime të konsiderueshme. Konkretisht, menjëherë pas blerjes së kuotave nga subjekti dhe bashkëshortja, të ardhurat dhe fitimi i deklaruar janë shtuar në mënyrë eksponenciale, duke arritur në 32,5 milionë lekë [rumbullakosur] fitim në vitin 2012. Nga këto shifra, rezulton se shpjegimi i subjektit për arsyet për të cilat ai dhe personi i lidhur shpenzuan vetëm 100.000 lekë për të zotëruar tërësisht këtë shoqëri, rezulton tejet jobindës. Shitja e kuotave në vlerën 100.000 lekë duket potencialisht kontradiktore edhe me fitimin e deklaruar në vitin 2011, prej 681.390 lekësh [nga 24.327.954 lekë të ardhura]. Po ashtu, është fakt i pakontestueshëm që shoqëria ka realizuar fitime të konsiderueshme krahasuar me vlerën nominale të themelimit, ndërsa pronare e kuotave deri në vitin 2015, ka qëndruar në mënyrë të pandryshueshme personi i lidhur/bashkëshortja, ndërsa kuotat e tjera janë zotëruar nga dy anëtarë të tjerë të familjes së subjektit, dhe më pas edhe vetë subjekti si zotërues aktiv për një periudhë kohore. Këto aspekte të jetës financiare të aktivitetit të tij privat, të analizuara në kontekstin e një komuniteti relativisht të vogël, ku subjekti jetonte e ushtronte detyrën [në Lezhë], natyrshëm ngrënë pyetje mbi efektin e funksionit të subjektit mbi mbarëvajtjen e lehtësitë në zhvillimin e biznesit, sikurse edhe ndërthurjes së pozitës zyrtare kundrejt subjektit si individ në perceptimin e publikut.

21.7 Në analizën e mësipërme, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin që subjekti nuk ka deklaruar vlerën e fitimeve të përfituara nga aktiviteti i shoqërisë, duke u mjaftuar vetëm me referimin në deklaratimet për organet tatimore. Ky mosdeklarim u vlerësua si një ndër aspektet kontekstuale të cilat dëshmojnë për mungesë transparence, që përveçse bie ndesh me detyrimet e tij ndër vite si subjekt deklarues i ligjit nr. 9049/2003, bie ndesh edhe me detyrimet në funksion të procesit të rivlerësimit për të deklaruar *të ardhurat neto të krijuara, në lekë apo valutë*⁹⁷. Në parim, transferimi i kuotave ka për objekt kalimin e një kompleksi të drejtash që përcaktojnë statusin e ortakut dhe fitimin e pjesës përkatëse të tyre në pasurinë e shoqërisë. Nga ky parim, rezulton që edhe transferimi i kuotave në vitin 2011 te subjekti, ka realizuar transferimin e fitimit të pjesës përkatëse në pasurinë e shoqërisë që këto kuota përfaqësonin, referuar në nenin 76 të ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Në faqen 5 të deklaratimeve periodike vjetore duke filluar nga viti 2012, subjekti ka deklaruar fitimet e akumuluarat e të pashpërndara të shoqërisë,

⁹⁶ Referuar në formë tabelare në faqen 21 të vendimit.

⁹⁷ Faqja 6 e shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

duke treguar në këtë mënyrë se i ka konsideruar ato si të ardhura të tij, ndërsa shitësit e kuotave, vëllai dhe kunati i tij, nuk kishin pretendime financiare. Për rrjedhojë, trupi gjykues i vlerëson çmimet e deklaruara të kuotave si fiktive, e në funksion të interesave të subjektit të rivlerësimit për të paraqitur një panoramë financiare të favorshme për të, pa e shoqëruar me shpjegime transparente e dokumentacion.

21.8 Edhe prapësimet e subjektit kundrejt konkluzionit të Komisionit për cenim të besimit të publikut për shkak të bashkëpunimit të ngushtë të aktivitetit të tij privat me shoqërinë e të vëllait, u vlerësuan nga trupi gjykues i Kolegjit të pabazuara. Nga dokumentacioni i administruar, si dhe nga burime të hapura, trupi gjykues i Kolegjit ka konstatuar një sërë faktesh që provojnë ndërthurje në kohë e në natyrë të aktivitetit të “{***}” ShPK [në pronësi e administrim të personit të lidhur/bashkëshortes, sikurse edhe të vetë subjektit] dhe shoqërisë së krijuar nga vëllai i subjektit, [“{***}” ShPK], të cilat tregojnë qëndrueshmëri organike interesash mes këtyre dy personave juridikë. Një pjesë e aspekteve të kësaj lidhjeje është arsyetuar gjerësisht më sipër, lidhur me pasurinë tokë arë në Bërxullë, shkëmbyer nga subjekti me garazhin [shtjelluar në pjesën e numërtuar C.4], sikurse analizohen edhe në vijim të këtij vendimi.

21.9 Në vlerësim të këtyre rrethanave, trupi gjykues e vlerësoi edhe këtë marrëdhënie si një ndër aspektet që ndikojnë në cenimin e besimit të publikut te drejtësia, për shkak të karakteristikave të referuara më sipër e në vijim. Mbi bazën e këtij vlerësimi integral, pjesë e të cilit është edhe marrëdhënia mes këtyre dy shoqërive [por jo vetëm], e që përfshin edhe të ardhurat nga aktivitetet e tjera, trupi gjykues çmon të theksojë se subjekti edhe në ankim nuk arriti të përmbysë konkluzionin e Komisionit se ndërthurja e interesave të tij me vëllezërit ka pasur për qëllim ndikimin, qoftë edhe në dukje të figurës së tij si prokuror në veprimtaritë fitimprurëse të familjarëve të tij, e ka cenuar besimin e publikut te drejtësia. Ky konkluzion shtjellohet në vijim.

21.10 Nga aktet në fashikullin e Komisionit, rezultojnë faktet e mëposhtme.

a) Shoqëria “{***}” ShPK, me ortak të vetëm vëllanë e subjektit [z. S. M.], është themeluar më datë 01.03.2010⁹⁸, me zyrë qendrore në Tiranë, në rr. “{***}”, pallati i ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK dhe kapital 100.000 lekë [bar “{***}”, kati i parë]. *Regjistrimi* në QKB rezulton të jetë kryer të nesërmen, në datën 02.03.2010, një muaj më pas, në datën 06.04.2010, ortaku i vetëm vendos *pezullimin* e aktivitetit të shoqërisë për një afat të pacaktuar; në datën 20.04.2010, shoqëria kalon në status aktiv. Në datën 22.04.2010, ortaku miraton ndryshimin e selisë së shoqërisë nga Tirana, në lagjen “{***}”, pall. {***}, Lezhë; në datën 26.04.2010, vendos blerjen e “{***}”, përfaqësia Kosovë [me kapital 5.000 euro]; më datë 30.06.2011, miraton *pezullimin* e aktivitetit tregtar të shoqërisë për një periudhë të pacaktuar kohe; më datë 04.03.2014, miraton kalimin e shoqërisë në status *aktiv*⁹⁹.

⁹⁸ Sipas faqes zyrtare të QKB-së, referuar aktit noterial nr. {***} kol., datë 1.03.2010, noter Xh. H..

⁹⁹ Për të kryer veprimet pranë QKR-së, S. M. autorizon z. N. M. [ortak i shoqërisë “{***}” ShPK], njëkohësisht kunati i tij dhe subjektit të rivlerësimit.

b) Në datën 26.05.2010, shoqëria “{***}” ShPK¹⁰⁰, i shet shoqërisë “{***}” ShPK¹⁰¹, tërësisht 100% të kapitalit të zotëruar prej saj në filialin “{***}”, përfaqësia në Kosovë, në përputhje me, ndër të tjera, vendimin nr. {***}, datë 26.05.2010, të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë¹⁰² [...].

c) Referuar informacionit nga burime të hapura të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës¹⁰³, identifikohet “{***} - Dega Kosovë”, degë e shoqërisë së huaj, me datë regjistrimi 17.06.2006, kapital 5.000 euro, pronar/aksioner {***}, përfaqësues i autorizuar E. L. [drejtor - me prokurë të posaçme], S. M. [Drejtor Gjeneral për Kosovë] dhe F. K. [agjent i regjistruar].

21.11 Nga sa më sipër, rezultojnë disa fakte me rëndësi në kontekstin e analizës së fiktivitetit të veprimeve të subjektit për të evituar kontrollin e pasurive të tij. *Së pari*, shoqëria “{***}” ShPK është themeluar e regjistruar nga vëllai i subjektit vetëm *dy muaj* përpara se “{***}” ShPK t’i shiste kapitalin e filialit të saj në Kosovë, ndërsa një muaj pas kësaj blerjeje ka pezulluar aktivitetin për një periudhë pothuaj 3-vjeçare. Këto veprime nuk mund të mos ngrenë pikëpyetje për qëllimin e vërtetë për të cilin shoqëria “{***}” është krijuar. *Së dyti*, të dyja shoqëritë kanë selinë në të njëjtën adresë në Lezhë – lagja “{***}”, pall. {***}. Më herët, selia e shoqërisë “{***}” ShPK ndodhej në adresën: rr. “{***}”, bar “{***}”, që sikundër analizohet gjerësisht vijim, rezulton të jetë pasuri e fshehur e subjektit. *Së treti*, i njëjti individ, z. E. L., drejtor me prokurë të posaçme në degën në Kosovë, është njëherazi zotëruar aktiv i kuotave të “{***}” ShPK. Ky individ, duke filluar nga data 31.05.2015, autorizohet si personi i besuar i subjektit dhe bashkëshortes, duke u ngarkuar edhe me të drejtën e vendimmarrjes mbi 100% të kuotave të shoqërisë. Ndonëse është e paqartë natyra ekzakte e marrëdhënies së z. E. L. me shoqërinë “{***}” ShPK – konkretisht, nëse angazhimi i tij ka për bazë një marrëdhënie punësimi, ndër të tjera – është fakt i pakontestueshëm që ligji e shoqëron rolin e tij si person i besuar me kompetenca ekskluzive të administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë¹⁰⁴.

¹⁰⁰ Ortakë të shoqërisë: (1) znj. A. P. 40 % të kuotave (bashkëshortja e subjektit); (2) z. F. Ll., 30 % të kuotave (vëllai i subjektit); dhe (3) z. N. M., 30 % të kuotave (kunati i subjektit).

¹⁰¹ Sipas kontratës me nr. {***}, datë 26.05.2010, hartuar pranë noterit Xh. H., në cilësinë e shitësit shoqëria “{***}” ShPK, me përfaqësuese ligjore A. P.; në cilësinë e blerësit shoqëria “{***}” ShPK, me përfaqësues ligjor z. S. M. – shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së.

¹⁰² Nëpërmjet këtij vendimi, asambleja, ndër të tjera, ka ngarkuar personin e lidhur/bashkëshorten e subjektit njëkohësisht administratorja të nënshkruajë kontratën e shitjes së kapitalit të shoqërisë së sipërcituar, si dhe ka ngarkuar ortakun N. M. të ndjekë procedurat ligjore për depozitimin e këtij vendimi dhe të kontratës së shitjes së kapitalit pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Kosovë, për të bërë ndryshimet përkatëse – shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së.

¹⁰³ <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,115254> – faqja zyrtare e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës. Ky burim informacioni nuk ofron ekstraktin historik të biznesit, dhe as kopje të dokumenteve mbi bazën e të cilave janë kryer veprimet përkatëse për regjistrimin apo për veprimtarinë e këtij biznesi.

¹⁰⁴ Ligji nr. 9367/2005, në nenin 3, të titulluar “Përkufizime”, pika 6, parashikon se: “Zotërim pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital” është gjendja, në të cilën pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër civil mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera (administrim, zotërim, tjetërsim etj.) kryhen nga një person i besuar nga pronari, bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre, që përcakton kriteret e përfitimit të fryteve të pasurisë, si dhe të drejta e detyrime të tjera të domosdoshme. I besuari nuk

21.12 Përpos këtyre fakteve, sikundër edhe atyre të potencuara nga Komisioni në vendim – aktiviteti i njëjtë, projektet e investuara që duket se janë projekte të të dyja shoqërive, nga burime të hapura¹⁰⁵, rezulton informacion i bollshëm lidhur me bashkëpunimin dhe aktivitetin tregtar të suksesshëm të dy shoqërive, potencuar kjo edhe nga të dhënat për fitimet e realizuara nga shoqëria “{***}” ShPK. Në këtë situatë faktike, duke konsideruar historikun e krijimit të shoqërisë “{***}” ShPK, veprimtarinë e saj në favor të interesave të subjektit [shkëmbimi i pasurisë tokë arë në Bërxullë fillimisht me detyrimin për pagesën e kredisë në Emporiki Bank dhe më pas, duke shtuar edhe pasurinë bodrum me sip. 600 m²], krijojnë një tablo të qartë, më së paku për ndërveprim të subjektit në aktivitetin tregtar të vëllezërve të tij [shih paragrafin 19.12, për të dhëna të përfshirjes së drejtpërdrejtë të subjektit në veprimtarinë e kësaj shoqërie, ku ai vepron në cilësinë e kërkuesit për interesa të saj]. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar vlerësimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, edhe me veprimet e tij indirekte përmes ndikimit qoftë edhe në dukje të figurës së tij si prokuror.

21.13 Ndonëse subjekti ka përmbushur detyrimet sipas ligjit nr. 9367/2005, duke kaluar në status pasiv nga viti 2015, në analizë të gjithë elementeve të mësipërme, me fokus vlerën e blerjes së kuotave krahasuar me fitimet dhe të ardhurat e shoqërisë, shpjegimet jobindëse të subjektit për këtë vlerë thuajse të papërfillshme, faktit që aktiviteti privat ka qenë kurdoherë i asociuar me subjektin dhe familjarë të afërt të tij, përfshirë edhe bashkëshorten, përpos subjektit vetë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Kuotat në vlerë modeste, deklaruar me burim të paprovuar, kanë krijuar pasuri të shumëfishuara gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit. Në përmbledhje, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve dhe deklarimit të rremë nëpërmjet çmimeve fiktive të deklaruara në funksion të interesave të subjektit të rivlerësimit, parashikuar nga gerrat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Analiza për aspektet e vlerësimit të cenimit të besimit të publikut, u bë pjesë e pjesë e vlerësimit tërësor.

C.7. Pasuria truall ndërtimi me sipërfaqe 7.210 m² në Lezhë

- 22** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës. Subjekti e ka deklaruar si pasuri të vëllait F. Ll.. Sipas asaj deklarate, pasuria i përket e gjitha vëllait dhe është blerë për të nga subjekti në datën 02. 07.2002, në vlerën 3.900.000 lekë. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me këtë pasuri dhe se nuk ka mundur të provojë mundësitë financiare me burime të ligjshme për blerjen e saj, duke u gjendur në kushtet e gërmës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

shkëmben asnjë mendim dhe asnjë informacion me pronarin dhe as nuk ndikohet nga ai për kryerjen e këtyre veprimeve me pasurinë. I besuari duhet të veprojë vetëm në të mirën e ruajtjes dhe rritjes së pasurisë, me të njëjtin motivim sikur këto veprime të kryheshin nga vetë pronari”.

¹⁰⁵ Shih: <https://www.facebook.com/albvizionsima/>; <https://vymaps.com/XK/Albvizion-simacom-805780092779096/> – krahas burimeve të hapura të referuara nga Komisioni në vendim, në poshtëshënimin 31, faqe 20.

22.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit si tërësisht të pabazuar, duke pretenduar se nga provat e administruara rezulton qartë se pasuria është e vëllait F. Ll.. Në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës e ka deklaruar atë meqenëse vëllai ka qenë në certifikatën familjare, por ka specifikuar që pasuria zotërohet tërësisht nga vëllai në fjalë. Sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit se nuk e ka deklaruar kontratën e shitjes së pronës në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, është tërësisht i pabazuar.

22.2 Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit. Në kushtet që kjo pasuri rezulton e blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2002 dhe shitur vëllait prej atij vetë në vitin 2005, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson së subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e sa rezulton nga kontrata e shitjes dhe blerjes, për sa i përket faktit që pasuria ishte blerë prej atij vetë. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë financiare dhe as të ardhura të ligjshme të vëllait [F. Ll.] për financimin e blerjes së pronës në vitin 2002. Nën dritën e këtyre fakteve dhe në vlerësim integral të aspekteve të tjera të pasurisë së referuar më sipër, në kontekst të ndërthurjes e vendosjes së pasurive të subjektit në emër të vëllezërve, trupi gjykues vendosi ta bëjë pjesë integrale të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë edhe këtë pasuri. Konkluzioni i trupit gjykues mbajti në konsideratë arsyetimin në vijim. Nga aktet në dosje, rezulton se subjekti e ka blerë këtë pasuri dhe regjistruar titullin e pronësisë në ZVRPP Lezhë në datën 27.05.2002¹⁰⁶. Në datën 04.02.2005, subjekti ia ka shitur atë vëllait të tij, F. Ll., nëpërmjet një kontrate noteriale shitjeje në të cilën, përpos në cilësinë e shitësit, subjekti përfaqëson me prokurë edhe blerësin, vëllanë F. Ll.. Kontrata e shitjes përcakton se çmimi i pasurisë është në vlerën 3.950.000 lekë, të likuiduara tërësisht jashtë zyrës së noterisë. Në prokurën e përfaqësimit [pa vulë apostile], deklarohet se i vëllai është me banim në Toronto. Nga ana tjetër, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar një kërkesë e z. F. Ll., që mban datën 26.4.2005, për regjistrim si person fizik, sikurse edhe një vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për këtë kërkesë, që mban datën 29.4.2005. Siç është arsyetuar gjerësisht më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk provoi përse, në kushtet që vëllai ka krijuar interesa privatë në Shqipëri, tre muaj pasi u hartua kontrata e shitjes së tokës, nevojitej të vepronte nëpërmjet prokurës së përgjithshme, nëpërmjet subjektit, për këtë kontratë shitjeje në shkurt 2005.

22.3 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës, dorëzuar më 24.03.2005, me pjesë takuese 0, datë krijimi 10.02.2005, dhe si pjesëtarë të familjes me pasuri të regjistruar në emër të vet, ka deklaruar vëllanë F. Ll., duke specifikuar për të edhe: *emigrant në Kanada*. Duke abstraguuar nga mospërputhja mes mënyrës së deklarimit të kësaj pasurie me udhëzimet në deklaratën për pasuritë¹⁰⁷ që u përkasin anëtarëve të familjes, apo

¹⁰⁶ Kontratë shitblerje nr. {***}, datë 27.05.2002, regjistruar në ZVRPP Lezhë me nr. regjistri hipotekor {***}, datë 27.05.2002.

¹⁰⁷ Në deklaratë, në formularin “Pjestarë të familjes me pasuri të regjistruar në emër të vet”, në ndihmë të subjekteve deklarues jepet qartësimi si vijon: “Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes me pasuri të

mungesën e një shpjegimi për arsyet e regjistrimit të titullit të pronësisë në emër të subjektit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson se përfaqësimi i blerësit nga subjekti i rivlerësimit, njëherazi shitës i pronës, në kontratën e shitjes më datë 04.02.2005, një muaj përpara dorëzimit të deklaratës së pasurisë përpara fillimit të detyrës, dëshmojnë për nxitim të subjektit për të minimizuar pasuritë që do duhet të deklaronte si subjekt deklarues, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003. Kjo bindje përforcohet nga fakti që në harkun kohor mes 26 dhe 29 prill 2005, z. F. Ll. ka kryer veprime për regjistrimin si person fizik, që nënkupton praninë e tij në Shqipëri, që tregon që shitja e ngutshme e tokës nëpërmjet subjektit, nuk gjen arsye logjike. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, subjekti nuk e deklaroi kontratën e shitjes së pasurisë vëllait të tij F. Ll.. Në këtë situatë faktike, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përfaqësimin e të vëllait, emigrant në Kanada, vlerësohen të pabazuara. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i bazuar.

22.4 Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e përllogariti vlerën e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie në ngarkim të subjektit, duke mbajtur në konsideratë vlerën provuese të plotë e të pakontestuar me dokumentacion të kontratës së shitjes së vitit 2002. Nga kjo analizë, subjekti rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë.

*C.8. Pasuria dyqan në rr. “{***}”, në Tiranë, dhe të ardhurat e deklaruar nga aktiviteti bar-kafe “{***}” ShPK*

- 23** Në deklaratën periodike për vitin 2006, subjekti ka deklaruar të ardhura në vlerën 2.800.000 lekë nga një dyqan i blerë nga vëllai në vitin 2002, në vlerën 60.000 USD, me të ardhura nga emigracioni. Subjekti ka deklaruar që dyqanin e menaxhon dhe vjel fitimet ai vetë. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se regjistrimi është bërë në emër të tij [subjektit] pasi vëllai ishte në të njëjtën certifikatë familjare me të dhe ishte jashtë Shqipërisë në atë periudhë kohore. Për sa i përket aspektit të dytë të trajtuar në këtë rubrikë të vendimit – aktivitetit të bar-kafesë “{***}” – subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* të ardhura nga ky aktivitet tregtar për tri vite [2006, 2007 dhe 2008], në vlerën në total *10.300.000 lekë*. Komisioni ka konkluduar se pasuria e blerë përpara fillimit të detyrës është deklaruar me burime të panjohura dhe të paprovuara, për të cilat subjekti nuk provoi ligjshmërinë. Po ashtu, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk provoi që pasuria i përket të vëllait, ndërsa pretendimet për të ardhurat e përfituara nga administrimi i këtij aktiviteti mbetën deklarative, tërësisht të paprovuara dhe informale. Përfundimisht, Komisioni vlerësoi se kjo është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe ai ndodhet në kushtet e germave “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

23.1 Subjekti i rivlerësimit kundërshton në tërësi konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, duke pretenduar se aludimet për pasuri të fshehur apo aktivitet tregtar të subjektit të rivlerësimit nuk mbështeten në të dhëna që e mbështesin këtë konkluzion. Kjo pasuri nuk ka qenë asnjëherë në

regjistruar në emrin e vet dhe i bashkëngjitet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim (lexo nenin 22 të ligjit).

pronësi të tij [subjektit] apo të vëllait, F. Ll. Ky i fundit e ka prenotuar këtë pasuri me kontratë porosie dhe financuar me të ardhura nga emigracioni. Kjo pasuri ka shërbyer për krijimin e personit fizik në emër të tij në vitin 2005. Ai vetë ka administruar vetëm të ardhurat nga aktiviteti tregtar, i cili ka pasur si administrator të vëllanë, që ka punësuar disa familjarë. Kontratat e sipërmarrjes nuk janë objekt deklarimi. Kjo është pronë e vëllait tjetër, N. Ll., për të cilën subjekti nuk ka pasur detyrim për deklarim. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi edhe konkluzionin e Komisionit lidhur me aktivitetin tregtar bar-kafe “{***}”, duke pretenduar se të ardhurat e deklaruara, në shumën totale prej 10.300.000 lekësh, janë administruar për llogari të F. Ll. sipas prokurës së përgjithshme të lëshuar prej tij më datë 31.12.2004, konfirmuar edhe me deklaratën noteriale të datës 06.01.2017. Ka deklaruar përdorimin e të ardhurave nga aktiviteti në deklaratat periodike të pasurisë dhe ka dhënë shpjegime të detajuara pranë ILDKPKI-së, por nuk ka deklaruar asnjëherë se ka menaxhuar këtë aktivitet. Për këtë aktivitet janë paguar detyrimet tatimore. Objekt deklarimi ka qenë xhiroja e realizuar dhe jo fitimi.

23.2 Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë në emër të të afërmit të tij [vëllait F. Ll.] dhe ka kryer deklarim të rremë për të ardhurat. Për pasojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në aktet në fashikull apo në dispozitat ligjore që gjejnë zbatim. Ndërsa vëllai i subjektit figuron formalisht të ketë bazuar aktivitetin e tij në këtë adresë, asnjë prej akteve nuk provon se ai ka pasur një marrëdhënie faktike me këtë dyqan, në asnjë formë, ndërkohë që nga aktet rezulton se ajo i përket formalisht një familjari tjetër [vëllait N. Ll.]. Nga ana tjetër, subjekti nuk arriti të shpjegonte kontradiktat që rezultojnë nga faktet e referuara prej tij kundrejt sa provohet nga aktet. Ky konkluzion i trupit gjykues bazohet në sa rezulton nga analiza e shtjelluar në vijim e akteve në fashikull.

23.3 Së pari, nga aktet në fashikuj, trupi gjykues konstaton sa vijon për këtë pasuri.

a. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar 10.300.000 lekë të ardhura nga bar-kafe “{***}” për vitet 2006, 2007 dhe 2008, të shoqëruar me shpjegimin se dokumentacioni për tatimet e paguara mungon, për shkak të llojit të biznesit¹⁰⁸ që tatohej në formë parashikimi në fillim të vitit.

b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006, subjekti ka deklaruar: “dyqan në rrugën “{***}”, sip. 86 m², blerë nga vëllai F. Ll., vlera 60.000 USD, pjesë takuese 0%, viti i krijimit 2002”, në rubrikën që i dedikohet deklarimit të pasurive. Nga ana tjetër, në të njëjtën deklaratë, në dy faqe të ndryshme që mbajnë të dyja nr. 5 e u dedikohen të ardhurave dhe angazhimeve në veprimtari private dhe/ose publike, ka mospërputhje të konsiderueshme. Konkretisht, ndërsa në njërin prej tyre, subjekti deklaron [me shifra dhe me fjalë] 4.000.000 lekë “të ardhura nga biznesi i vogël (bar-kafe) në emër të vëllait F. Ll. dhe shfrytëzohet nga unë pasi ai është me banim në Kanada”, në tjetrën, për të njëjtin aktivitet, subjekti ka deklaruar [me shifra dhe fjalë] 2.800.000 lekë të ardhura. Edhe dy zërat e tjerë të përfshirë në faqen e dubluar nr. 5, ndryshojnë në vlerë, dhe

¹⁰⁸ Subjekti është shprehur: “[...] lidhur me dokumentimin ligjor të fitimit nga bar-kafe “{***}” për periudhën e sipërcituar, ju sqarojmë se ky ka qenë një biznes i vogël dhe në organet tatimore çdo fillim viti deklarohej një fitim i parashikuar, i cili ndryshon me fitimin e realizuar, i cili ka qenë sipas shumës së cituar më sipër [...]”.

pjesërisht edhe në detajet e përshkrimit. Në përmbledhje, subjekti duket se ka deklaruar vlera konsiderueshëm më të larta në faqen e parë, me nr. 5, duke i ulur ato në faqen tjetër me të njëjtin numër. Diferencat shkojnë nga 7.200.000 lekë të ardhura në total, në 4.394.600 lekë në total. Ndër këto diferenca, më e madhja përbëhet nga të ardhurat e bashkëshortes, që janë deklaruar fillimisht 2.000.000 lekë e më pas 503.500 lekë, sikurse edhe fitimet nga biznesi bar-kafe, të cilat fillimisht janë deklaruar 4.000.000 lekë e më pas 2.800.000 lekë.

c. Në deklaratën periodike për vitin 2007, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 3.500.000 lekë, nga i njëjti aktivitet privat, me të njëjtin përshkrim: “në pronësi të vëllait F. Ll., të cilin e administroj unë”.

ç. Në deklaratën periodike për vitin 2008, subjekti ka deklaruar 2.800.000 lekë të ardhura nga ky aktivitet.

d. Gjatë viteve 2009 dhe 2010, në llogaritë bankare të subjektit, rezultojnë derdhje fondesh nga dy vëllezër, kunati dhe motra e subjektit. Sipas përshkrimit, pagesat kanë të bëjnë me pagesën e detyrimit të kredive. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar¹⁰⁹: *[...]të ardhurat për shlyerjen e kësteve të kredisë për periudhën 2006-2009, kanë burim të ardhurat e deklaruara nga pagat e tij dhe e bashkëshortes, dhe nga bar-kafe “{***}”, të cilat i kam administruar sipas një prokure të posaçme nga vëllai F. Ll. (e vitit 2004), dhe se pagesat janë bërë në rrugë bankare prej familjarëve të tij, që kanë menaxhuar punën në lokal [...]. Ndërsa nga viti 2010, ku vëllai F. Ll. është larguar nga certifikata familjare, pagesa e kredisë prej 55.000 eurosh, është bërë nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas kontratës së lidhur më datë 26.07.2010, e cila ka kryer të gjitha pagesat nga ai moment e në vijim [...].*

dh. Në përmbushje të barrës së provës, për të provuar se kjo pasuri nuk i përket atij, subjekti është shprehur se në deklaratën e tij në ILDKPKI në vitin 2007, ka deklaruar se për marrjen e kredisë prej 55.000 eurosh, të marrë në Emporiki Bank, ishin llogaritur edhe të ardhurat e bar-kafe “{***}” [...].

e. Nga hetimi administrativ i kryer¹¹⁰, ka rezultuar që aktiviteti në fjalë, në emër të z. F. Ll., ka deklaruar fitime në total në vlerën 2.040.852 lekë në vitet 2008 dhe 2009, të marra së bashku. Sipas informacionit nga burime të hapura, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që mban datën 29.04.2005, në emër të z. F. Ll. është regjistruar si person fizik aktiviteti “bar-restorant, tregtim me pakicë të artikujve të ndryshëm”, me status aktiv. Vendi i ushtrimit të aktivitetit është rr. “{***}”, Tiranë.

ë. Në vitin 2008 – një ndër vitet kur subjekti ka deklaruar fitim në deklaratën periodike vjetore, sipas DRT-së, fitimi i referuar ka qenë 1.108.632 lekë. Në vitet 2005 [viti i regjistrimit] deri në vitin 2007, ky aktivitet nuk ka deklaruar fitim¹¹¹. Nga hetimi administrativ, ka rezultuar edhe që dyqani ndodhet në pallatin në të cilin banon subjekti.

¹⁰⁹ Në përgjigje të pyetjes 4 të pyetësorit, datë 9.4.2020.

¹¹⁰ DRT Tiranë konfirmon të dhënat e regjistrimit të personit fizik, përgjegjës në tatimore biznes i vogël, dhe fitim të deklaruar 0 për vitet 2005, 2006, 2007, 1.108.632 lekë për vitin 2008, dhe 932.222 lekë për vitin 2009.

¹¹¹ Sipas shkresës së DRT-së Tiranë, dërguar ILDKPKI-së më 26.04.2019, referuar edhe në formë tabelare në paragrafin 9.2 të vendimit të Komisionit.

23.4 Nga sa më sipër, rezultojnë disa fakte relevante në kontekstin e analizës së kryer në funksion të shkaqeve të ankimit. Së pari, subjekti argumentoi se kjo pronë është prenotuar nga vëllai F. Ll., por që ai nuk është bërë asnjëherë pronar formalisht për këtë pasuri, ndonëse është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri tashmë [shih edhe më sipër], sikurse edhe rezulton të jetë regjistruar si person fizik që në vitin 2005. Në mbështetje të këtij shpjegimi, subjekti ka paraqitur një certifikatë pronësie për njësinë, lëshuar më datë 16.02.2020, në emër të vëllait tjetër, N. Ll. Është e paqartë, dhe subjekti nuk ka shpjeguar përse vëllai F. Ll. hoqi dorë nga të drejtat pronësore mbi këtë pasuri, ndërkohë që përmes saj ai është regjistruar si person fizik, me status aktiv edhe aktualisht. Së dyti, përpos mungesës në tërësi të ndonjë lidhjeje mes vëllait F. Ll. me këtë pasuri, përpos referimit të saj si adresë për regjistrimin si person fizik, subjekti nuk provoi as edhe ekzistencën e burimeve financiare të mjaftueshme kundrejt krijimit të kësaj pasurie, sikurse as ligjshmërinë e tyre. Të ardhurat nga emigracioni në ShBA dhe Kanada të vëllait, pretenduar nga subjekti, mbetën të paprovuara, çka dëshmon pamundësinë financiare të të vëllait për krijimin e kësaj prone me të ardhura të ligjshme.

23.5 Nga ana tjetër, ndërsa nuk është provuar marrëdhënia e z. F. Ll. me këtë pronë, nga sa është përmbledhur më sipër, rezulton një marrëdhënie e qartë përfitimi e subjektit të rivlerësimit me të. Konkretisht, subjekti ka deklaruar përfitime të konsiderueshme personale prej kësaj prone për disa vite, dhe ka vijuar ta administrojë personalisht, siç edhe ka deklaruar ndër vite, apo ka vjelë të ardhurat në funksion edhe të shlyerjes së kredisë së marrë prej tij – sikurse ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ për depozitimet e fondeve nga familjarë të ndryshëm të tij, që menaxhonin lokalit [referuar në paragrafin 22.3/e]. Nën këtë dritë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i bazuar konkluzioni i Komisionit se kjo pasuri është e subjektit. Përpos këtij aspekti kyç në analizën e marrëdhënies së subjektit me këtë pasuri, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe indicie të tjera që përforcojnë këtë konkluzion, siç është vendndodhja e njësisë pikërisht në ndërtesën e subjektit, apo edhe huaja prej 150.000 eurosh, e marrë në vitin 2005, përpara çeljes së këtij aktiviteti, marrë nga z. L. N. [analizuar më sipër], e cila mund të tregojë nevojën financiare që kishte subjekti në atë periudhë kohore për aktivitetet tregtare të referuara më sipër, por edhe në lidhje me këtë pasuri. Duke mbajtur në konsideratë edhe sa është arsyetuar më sipër¹¹² në lidhje me kredinë e tërhequr *cash* në 2005-2006 nga subjekti, trupi gjykues i vlerësoi edhe këto indicie në drejtim të konkluzionit që bëhet fjalë për pasuri të fshehura të subjektit, dhe që likuiditetet e ndryshme i janë nevojitur për të plotësuar nevojat e aktiviteteve të tij financiare.

23.6 Për më tepër, në kushtet që dokumenti i vetëm zyrtar për këtë pasuri – certifikata për vërtetimin e pronësisë në emër të vëllait tjetër, N. Ll. – mban datën 16.06.2020, pronësia mbi këtë njësi për gjithë harkun kohor nga viti 2006 e vijim, kur subjekti ka ushtruar aktivitetin tregtar, mbeti e padokumentuar. Subjekti po ashtu nuk provoi, qoftë edhe indirekt, që vëllai F. Ll., që sipas subjektit kishte investuar për krijimin e kësaj pasurie, ka vjelë të ardhurat nga aktiviteti, përpos

¹¹² Shih rubrikën C.3 në lidhje me pasurinë apartament në rrugën “{****}”, sikurse edhe sa rezulton nga aktet në lidhje me tërheqjen e kredisë nga subjekti, referuar në paragrafin 18.3/f.

faktit të mospasjes së të ardhurave për ta krijuar këtë pasuri. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti dështoi të provojë të kundërtën e barrës së provës, sikurse edhe që tagrat me të cilat prona është zotëruar prej tij për ushtrimin e aktivitetit tregtar dhe vjeljen e të ardhurave, si janë ato të deklaruara prej tij. Ndërkohë, përdorimi i pronës për zhvillimin e një aktiviteti tregtar të regjistruar në emër të të vëllait, ndërkohë që të ardhurat përfitohen e përdoren prej subjektit, mund të dëshmojnë vetëm për ekzistencën e interesave financiarë të subjektit për këtë pronë, pasi e kundërta nuk do të kishte logjikë ekonomike.

23.7 Për sa u përket të ardhurave nga aktiviteti, nga aktet e referuara në mënyrë të përmbledhur më sipër [në nënpjesët e paragrafit 23.3], rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar të ardhurat nga aktiviteti tregtar bar-kafe “{***}” ShPK, por ka lënë në heshtje rolin e tij, të cilin e ka specifikuar qartë në deklaratat periodike vjetore si administrator dhe menaxher i aktivitetit, përpos vjeljes së të ardhurave prej tij individualisht. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka rënë në kontradiktë me sa deklaruar në deklaratat periodike vjetore, e konkretisht, duke pretenduar se të ardhurat kanë qenë të vëllait dhe i ka deklaruar “për shkak se ka qenë pjesëtar i familjes” dhe për shkak të “prokurës së posaçme prej tij”¹¹³. Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur që familjarët e tij *kanë punuar dhe administruar këtë aktivitet tregtar* dhe ka riparashtruar faktin që kishte një prokurë të posaçme që të përfaqësonte të gjithë interesat pasurorë të vëllait F. Ll..

23.8 Nga kontradiktat e ilustruara më sipër, rezulton se subjekti ka ndryshuar versionin gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar versione faktesh në përputhje me nevojën e kohës. Koncretisht, ndërsa ndër vite si subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003, por edhe për shkak të procesit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi të ardhura të konsiderueshme në funksion të krijimit të perceptimit të mundësisë për të përballuar shpenzime të kryera e pasuri, në procesin e hetimit administrativ, subjekti është përpjekur të zhveshë ekonominë e tij nga këto të ardhura, meqenëse u përball me mospërputhjet themelore në panoramën ligjore të fakteve të pretenduara prej tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklarimi si të tija i të ardhurave, në deklaratën *vetting*, sikundër edhe në deklaratat periodike të pasurisë, përjashton pretendimin e mëpsmë të subjektit që të ardhurat në fakt janë të F. Ll..

23.9 Përpos sa më sipër, duke abstraguar nga problemet me aspektet e formës në prokurën e posaçme të datës 31.12.2004, hartuar në Kanada, së cilës i mungon vula apostile¹¹⁴, nga përmbajtja e saj rezulton se i përfaqësuari [F. Ll.] nuk i ka dhënë tagra subjektit të përfitojë të ardhurat nga aktiviteti tregtar, regjistruar në emër të tij. Prokura përmban tagra për çdo veprim ligjor që ka lidhje me administrimin e pasurive të paluajtshme, llogaritë bankare apo çdo lloj veprimi tjetër të përfaqësimit. Duke analizuar *a contrario*, nëse subjekti dhe vëllai kishin mes tyre një dakordësi

¹¹³ Përgjigje e subjektit për pyetësin nr. 1, më datë 6.03.2020.

¹¹⁴ Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 7.03.2003, “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit, si dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit” dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 146/2021.

sipas së cilës i pari kishte liri të pakufizuar të gëzonte përfitimet pasurore që i takonin të dytit, marrëdhënia do të rezultonte dhurim i pakushtëzuar dhe i pakufizuar në kohë e, për rrjedhojë, nuk do të ishte prokura e posaçme mjeti juridik më efikas për të realizuar dhurimin e të ardhurave.

23.10 Trupi gjykues analizoi edhe peshën e të ardhurave nga aktiviteti tregtar në shlyerjen e kësteve të kredisë të subjektit për periudhën 2007 - gusht 2010. Sikurse është referuar më sipër, duke filluar nga shtatori 2010, shlyerja e kredisë është detyrim i shoqërisë “{***}” ShPK, sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes së lidhur mes subjektit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë [vëllai i subjektit]. Nga kjo analizë, rezulton se për këtë periudhë, subjekti ka kryer vetëm 13 nga 48 pagesa të kryera, ndërsa 35 pagesa janë kryer nga të afërm të tij¹¹⁵. Ky raport i shpërpjesëtuar dukshëm, nuk duket të jetë pasojë e pamundësisë për kryerjen e pagesave nga subjekti apo bashkëshortja e tij. Në këtë situatë faktike, trupi gjykues e gjen të pakuptimtë shpjegimin e subjektit se për shlyerjen e kësteve të kredisë janë përdorur edhe të ardhura nga paga e tij dhe e bashkëshortes, për sa nuk duket bindëse që të ardhurat nga pagat t’u jenë dorëzuar të afërmeve të tij për të kryer veprimet në bankë. Për rrjedhojë, edhe shlyerja e kësteve të kredisë së marrë nga subjekti, nëpërmjet fitimeve nga aktiviteti tregtar, përforcon bindjen se kjo përbën një pasuri të subjektit të rivlerësimit.

23.11 Nga ana tjetër, ndonëse një pjesë e kredisë është marrë përsipër nga personi juridik në emër të vëllait S. M. [sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 26.07.2010, analizuar më sipër] dhe rezulton që ky individ të ketë shlyer 10 pagesa, ose 22,4% të vlerës së mbetur të kredisë nga Emporiki Bank, në pasqyrat financiare të shoqërisë nuk kanë rezultuar përshkrime shpenzimesh apo pagesa për detyrime që lidhen me shlyerjen e detyrimit të kredisë për llogari të z. Bardhok Lleshi. Në bilance nuk rezulton që shoqëria të ketë shpërndarë dividend. Në këtë situatë faktike, pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht më sipër për marrëdhënien e subjektit me këtë person juridik [shih paragrafin 19.12], trupi gjykues i vlerësoi edhe këto konstatime në drejtim të konkluzionit tërësor se subjekti i rivlerësimit ka krijuar e mbajtur marrëdhënie, në dukje korrekte, me synim për të devijuar kontrollin e pasurive të tij dhe shtimin e tyre.

23.12 Së fundmi, nga hetimi administrativ ka rezultuar se totali i të ardhurave të deklaruara nga subjekti prej këtij aktiviteti është shumë më i lartë sesa rezulton nga dokumentacioni zyrtar i përcjellë nga administrata tatimore. Konkretisht, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 10.300.000 lekë nga ky aktivitet, sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, fitimi i deklaruar nga subjekti është ndjeshëm më i ulët, vetëm 2.040.852 lekë. Me fjalë të tjera, subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* [dhe në deklaratat periodike vjetore] 8.259.148

¹¹⁵ N. M. [kunati i subjektit] ka kryer 10 pagesa; N. Ll. [vëllai i subjektit] ka kryer 13 pagesa; S. Ll. [vëllai i subjektit] ka kryer 2 pagesa; S. M. [vëllai i subjektit] ka kryer 10 pagesa, 7 gjatë vitit 2009 dhe 3 në muajt e parë të vitit 2010, përpara se t’i lindte detyrimi për shlyerjen e kësteve të kredisë sipas kontratës së sipërmarrjes të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

lekë më tepër sesa ka deklaruar për qëllime tatimore. Pretendimi i subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision, sikurse edhe në ankim, se objekt deklarimi në atë kohë ka qenë xhiroja e realizuar dhe jo fitimi, është deklarativ dhe i pabazuar në ligjin nr. 8438/1998, me ndryshimet përkatëse. Sipas këtij ligji, meqenëse subjekti realizonte të ardhura mbi 2.000.000 lekë, duhet të paguante tatime. Përpos këtij fakti, deklarimet e subjektit sipas ligjit nr. 9049/2003 apo në funksion të procesit të rivlerësimit, nuk lënë vend për paqartësi apo gabime në deklarimin e xhiros. Subjekti ka dhënë vlerë me fjalë e shifra në seksionin e të ardhurave si fitim. Në kushtet që subjekti prezumohet njohës i ligjit, duke qenë magjistrat, pretendimet e tij sa më sipër u vlerësuan si përpjekje e mëtejshme për të përkulur faktet në favorin e situatës së tij në procesin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se të ardhurat e aktivitetit tregtar nuk përmbushin kërkesat e nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi, të pabazuar.

23.13 Në përmbledhje të sa më sipër, lidhur me pasurinë dyqan me sip. 86 m², të ndodhur në rr. “{***}”, në Tiranë, dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit nga aktiviteti bar-kafe “{***}” ShPK, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë në emër të të afërmit të tij [vëllait F. Ll.] dhe ka kryer deklarim *të rremë* për të ardhurat. Për pasojë, subjekti gjendet në kushtet e germës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 për pasurinë, si dhe të germës “ç” për sa u përket të ardhurave nga aktiviteti tregtar.

*C.9. Kuotat në zotërim të subjektit dhe bashkëshortes në shoqërinë tregtare “{***}” ShPK*

- 24** Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur kuota dhe subjekti ka qenë edhe ortak e administrator në personin juridik referuar në këtë rubrikë të analizës. Një pjesë e këtyre interesave privatë ka rezultuar të vijojë deri në vitin 2007 [kuotat e bashkëshortes], ndërkohë që asnjë nga këto segmente të marrëdhënies nuk është deklaruar qoftë në deklarimin e parë përpara fillimit të detyrës [mars 2005, subjekti është emëruar në tetor 2004]. Shoqëria ka pasur fitime dhe rezulton me status aktiv dhe tashmë zotërues të kuotave janë dy vëllezër të subjektit, përkatësisht D. (M.) dhe N. Ll. me nga ½. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka konstatuar se subjekti gjendet në kushtet e fshehjes së pasurisë dhe të konfliktit të interesit, parashikuar përkatësisht në germat “c” dhe “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionit, mosdeklarimi ndër vite ka pasur për synim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të veprimeve të tij si dhe personit juridik, ndërsa shitja e kuotave fillimisht bashkëshortes e më pas vëllezërve ka përbërë veprime fiktive për të shmangur kontrollin e veprimeve të subjektit dhe personit të lidhur në kushtet e konfliktit të interesit.

24.1 Subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e Komisionit duke argumentuar se mosdeklarimi i kuotave është një pasaktësi e deklarimeve të para apo neglizhencë e bashkëshortes për kuotat e saj, ndërsa mosdeklarimi i fitimeve të shoqërisë, deri në momentin që shoqëria vendos të shpërndajë dividend, vjen në përputhje me nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003.

24.2 Trupi gjykues i Kolegjit e përfshiu analizën dhe konkluzionin e vet për këtë aspekt të shkaqeve të ankimit në vlerësimin tërësor të çështjes, në përfundim të të cilit konkludoi se me veprimet e tij, subjekti ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë. Sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi këto veprime të kryera ndër vite nga subjekti në kontekstin e shmangies nga kontrolli dhe verifikimi i pasurisë, sikurse edhe si fiktivitet në veprime, kryer për të krijuar fitime në vlera të konsiderueshme në favor të tij. Analiza mbi të cilën bazohet ky arsyetim shtjellohet në vijim.

24.3 Së pari, nga aktet në fashikull, trupi gjykues konstaton se subjekti ka zotëruar 50% të kuotave në shoqërinë “{***}” ShPK¹¹⁶ deri më 02.04.2004 dhe 25% të kuotave deri më 03.03.2005¹¹⁷. Bashkëshortja e tij ka zotëruar 25% të kuotave në periudhën 03.03.2005 - 12.04.2007¹¹⁸. Në vitin 2007, edhe bashkëshortja ka shitur pjesën e saj të kuotave në favor të njërit prej vëllezërve të subjektit të rivlerësimit [z. N. Ll.]. Deri në vitin 2006, selia e shoqërisë është adresa e vetë subjektit të rivlerësimit. Asnjë nga këto fakte nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore apo në atë të parë, hartuar më 25.03.2005. Shoqëria ka realizuar fitime të konsiderueshme në dy vitet pasi subjekti është bërë subjekt deklarues/emëruar prokuror dhe deri kur bashkëshortja ka shitur kuotat, në vlerën në total *13.126.456 lekë*¹¹⁹.

24.4 Nga analiza e sa më sipër, rezulton së pari se pretendimi i subjektit për harresë, duket tejet i pasinqertë në kushtet që duket e pakuptimtë të harrohet fitimi i të ardhurave të konsiderueshme për dy vite rresht, ndërkohë që kuotat e zotëruara janë po ashtu të konsiderueshme dhe ndryshimi i situatës ka përfshirë veprime aktive, si shitja e tyre e likuidime të tjera mes ortakëve, që kanë përfshirë edhe vetë subjektin. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të bazuar konstatimin e Komisionit që edhe kalimi i vlerës së mbetur të kuotave (25%) nga bashkëshortja në vitin 2007 të N. Ll., janë veprime fiktive të kryera për të shmangur kontrollin dhe verifikimin e kësaj pasurie. Mosdeklarimi i të ardhurave të konsiderueshme, në vlerësimin e trupit gjykues, është zgjedhje të qëllimshme për fshehjen e pasurisë dhe të veprimtarisë tregtare. Përpos sa më sipër, trupi gjykues konstaton se edhe në këtë rast, kalimi i kuotave është kryer sipas vlerës së kapitalit fillestar, sikundër kalimi i kuotave të shoqërisë “{***}” ShPK, duke dëshmuar për veprime fiktive në vijimësi mes subjektit dhe vëllezërve të tij. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit u çmuan si pjesë e një modeli sjelljeje të treguar prej tij, në përpjekje për të justifikuar veprime të përsëritura, për shmangien e kontrollit të pasurive nga organet kompetente. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit dhe pretendimet e subjektit, të pabazuara.

¹¹⁶ Shoqëria “{***}” ShPK është regjistruar më 21.03.2002, me seli në rr. “{***}”. Subjekti i rivlerësimit është ortak me 50% të kuotave dhe administrator i saj.

¹¹⁷ Subjekti i rivlerësimit, më datë 02.04.2004, largohet nga administrator dhe i shet 25% të kuotave të tij z. N. Ll. [vëllai i subjektit]. Në datën 3.03.2005, subjekti i ka transferuar kuotat e tij [25%] bashkëshortes, znj. A. P..

¹¹⁸ Më datë 12.04.2007, bashkëshortja e subjektit i ka transferuar kuotat në zotërimin e saj, z. N. Ll. [vëllai i subjektit].

¹¹⁹ Referuar në paragrafin 12.6 të vendimit të Komisionit, sipas pasqyrave financiare të deklaruara e publikuara në faqen zyrtare të QKB-së.

C.10. Gjendja e cash-it të deklaruar

25 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën prej 10.000 eurosh. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, plotësuar në mars 2017 – dy muaj pasi është plotësuar deklarata *vetting* – subjekti ka deklaruar kursime në vlerën 5.000 euro për vitin deklarues [2016]. Komisioni ka konstatuar se nëse kësaj vlere të kursyer nga të ardhurat e vitit 2016, i shtohen kursimet *cash* të deklaruara në vitet pararendëse në deklaratat periodike vjetore, subjekti do të duhet të kishte 8.338.024 lekë *cash*, jashtë sistemit bankar. Në përfundim, për këtë aspekt të deklarimit të pasurisë, Komisioni ka konkluduar se deklaratimet e subjektit mund të jenë fiktive dhe ai gjendet në kushtet e deklarimit të rremë, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

25.1 Subjekti pretendoi në ankim se ka deklaruar të ardhura nga qiraja ndër vite, të cilat janë *administruar* në *cash*, por nuk kanë qenë domosdoshmërisht të kursyera. Fakti që këto të ardhura kanë qenë të kursyera nuk do të thotë se ato duhet të jenë në gjendje *cash*. Të ardhurat janë për t’u shpenzuar, ato *nuk* janë të detyrueshme për t’u deklaruar, me përjashtim të rastit kur me to krijohet një pasuri apo përdoren për shkollim, pretendoi subjekti.

25.2 Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit dhe akteve në fashikuj, vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kushtet kur ndër vite ka deklaruar vetëm shtesë të likuiditeteve jashtë sistemit bankar, e jo pakësime. Për shkak të këtyre kontradiktave në deklaratimet e tij, vlera e deklaruar në deklaratën *vetting* nuk pasqyron të vërtetën. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion, shtjellohet në vijim.

25.3 Në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka referuar si vijon, për sa i përket gjendjes së likuiditeteve jashtë sistemit bankar:

- në deklaratën për vitin 2005: “*cash* në shtëpi 4.500 euro, pjesë takuese 50%”;
- në deklaratën për vitin 2010: “gjendje *cash* në vlerën 11.000 euro”;
- në deklaratën për vitin 2012: “kursime *cash* në vlerën 12.000 euro, të krijuara për vitin 2012”;
- në deklaratën për vitin 2013: “kursime *cash* në vlerën 9.000 euro, të krijuara për vitin 2013”;
- në deklaratën për vitin 2014: “kursime *cash* në vlerën 12.000 euro, të krijuara për vitin 2014”;
- në deklaratën për vitin 2015: “kursime *cash* në vlerën 5.000 euro, të krijuara për vitin 2015”;
- në deklaratën për vitin 2016: “kursime *cash* në vlerën 5.000 euro, të krijuara për vitin 2016”¹²⁰.

25.4 Së pari, nga sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar në asnjë prej viteve të marra në analizë pakësim të gjendjes së likuiditeteve, sikurse e kërkonte në mënyrë të shprehur, nëse ishte rasti, neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 dhe formulari përkatës. Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari, në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket

¹²⁰ Subjekti ka plotësuar deklaratën e pasurisë *vetting* në datën 26.1.2017, ndërsa deklaratën periodike për vitin 2016 në datën 20.03.2017.

pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për “[...] ndryshimet “shtesa dhe pakësime” nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit” që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]”.

25.5 Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë, duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërbushja e detyrimit sillte pasoja për deklarim të rremë si vepër penale. Sikurse është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit¹²¹, saktësia e deklarimeve të subjekteve për sa u përket likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar në deklaratat periodike vjetore, merr rëndësi të veçantë në kushtet që ato janë e vetmja provë nëpërmjet së cilës mund të kryhet vlerësimi i kriterit të pasurisë në procesin e rivlerësimit për sa i përket këtij zëri pasurie. Sikurse shtjelluar gjerësisht edhe në vendime të mëparshme të Kolegjit, ndërsa deklaratimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit [në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016], analiza e deklaratës *vetting* dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike, është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me burime të ligjshme¹²².

25.6 Për sa më sipër, në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar pakësime, prezumimi ligjor si subjekt deklarues nën dritën e ligjit nr. 9049/2003, nënkupton që këto të ardhura kanë mbetur të pandryshuara/pakësuara dhe, mbi të gjitha, në kushtet që subjekti deklaroi kursime në *cash* nga të ardhurat e vitit përkatës – nga qiraja apo burime të tjera – është i saktë vlerësimi i Komisionit. Në kushtet që në deklaratën e pasurisë *vetting*, në janar 2017, subjekti deklaroi 10.000 euro, ndërsa dy muaj më pas, një sasi likuiditetesh jashtë sistemit bankar në vlerën e akumuluar prej 8,6 milionë lekësh, deduktohet që deklarimi në deklaratën *vetting* nuk pasqyron të vërtetën. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga germa “ç” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

C.11. Analiza financiare

- 26** Nga analiza financiare e kryer gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një balancë negative në total në vlerën prej (-) 21.763.772 lekësh, nga të cilat (-) 10.578.153 lekë për periudhën 2004-2016, ndërsa për periudhën përpara vitit 2004, në balancë negative në vlerën prej (-) 11.185.619 lekësh. Komisioni konstatoi edhe që ndryshe nga sa pretendoi subjekti, pasuritë e tij nuk janë krijuar të gjitha përpara ushtrimin të detyrës, përkundrazi.

¹²¹ Shih ndër të tjera, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka (JR 27/2020) në: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi-Dritan-Peka-i-anonimizuar-per-web.pdf>, apo subjektit të rivlerësimit E. Islamaj (JR 11/2019) në: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%C3%ABr-web.pdf>, si dhe subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori (JR 19/2019) në: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh-Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralet.pdf>.

¹²² Shih vendimin JR 27/2020, paragrafi 19.4.vi.

Pasuritë aktuale të subjektit të rivlerësimit janë disa herë më të mëdha sesa ato të deklaruara në vitin 2004. Përfundimisht, pasi mori në analizë edhe prapësimet e subjektit, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm, parashikuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

26.1 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se analiza financiare e Komisionit është e pasaktë, dhe se rezultatet e të gjitha viteve janë pozitive. Sipas tij: (i) nuk janë vlerësuar kursimet nga puna në emigracion, që mbulojnë tërësisht vlerën e pasurive të krijuara përpara fillimit të detyrës prej 7.558.130 lekësh; (ii) për disa nga pasuritë e krijuara përpara fillimit të detyrës, ka dublim të vlerave, me ndikim në rezultatin që vjen kronologjikisht sipas viteve; (iii) vlera e pasurive të krijuara në periudhën 2004-2016, është vetëm 6.200.000 lekë, e cila hedh poshtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka shumëfishuar pasuritë gjatë ushtrimit të detyrës; (iv) për vitin financiar 2005, duke mos llogaritur vlerën e huasë prej 150.000 eurosh, e cila nuk është bërë efektive, balanca është pozitive; (v) për vitet financiare 2005-2010 nuk janë llogaritur të ardhurat e bashkëshortes si administratore e shoqërisë “{***}” ShPK; (vi) për vitin financiar 2006, është llogaritur e gjithë shuma e kredisë së alokuar nga Emporiki Bank, ndërkohë që duhet të llogaritet vetëm shlyerja e kredisë në vlerën prej 1.137.298 lekësh; (vii) për vitet financiare 2008-2009, nuk janë llogaritur të ardhurat nga bar-kafe “{***}”, të paktën në vlerat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas vërtetimit të DPT-së, respektivisht prej 1.108.132 lekësh dhe 932.220 lekësh; (viii) për vitin financiar 2010, nuk janë llogaritur të ardhurat nga kontrata e qirasë me shoqërinë “{***}” ShPK dhe vlera e shitjes së automjetit me targë {***}.

26.2 Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të akteve në fashikull dhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, konstaton se konkluzioni i Komisionit është i saktë. Edhe në analizën financiare të kryer në Kolegj në funksion të shkaqeve të ankimit të ngritura prej subjektit, u konfirmua balanca negative e konstatuar nga Komisioni. Nga analiza financiare e kryer, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të kryera për vitet 2003, 2004, 2006, 2007, 2009 dhe 2010, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Edhe në vlerësimin e kryer në Kolegj dhe arsyetuar gjerësisht më sipër, u gjet i pabazuar në fakte pretendimi i subjektit se pasuritë e tij janë krijuar përpara se të emërohej në detyrë. Përkundrazi, siç analizohet gjerësisht më sipër, subjekti ka shumëfishuar asetet e tij gjatë qëndrimit të detyrë. Për pasojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Ç. Vlerësimi tërësor

27 Nga një analizë tërësore, trupi gjykues vlerëson se subjekti gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion që përfshin gjithë aspektet e kontrollit të pasurisë së subjektit, ka në konsideratë faktin që atribuimi i pasurive nga subjekti anëtarëve të ndryshëm të familjes, në kohë të ndryshme, rezulton një praktikë konsekuente e subjektit, që logjikisht kryhet tërësisht në funksion të mënjanim të kontrollit të pasurive, të cilat duket se janë të subjektit të rivlerësimit. Në këtë analizë, trupi gjykues e vlerësoi faktin që subjekti ka menaxhuar aktivitete tregtare gjatë kohës që ishte prokuror, të cilat nuk i ka deklaruar me transparencë, si marrëdhëniet e krijuara, ashtu edhe veprimet e kryera ndër vite, përfshirë edhe përfitimet e të ardhurave prej tyre.

27.1 Nën të njëjtën dritë, trupi gjykues vlerësoi edhe marrëdhënien e krijuar nga subjekti me shoqërinë tregtare “{***}” ShPK, “{***}” ShPK. Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës dhe në deklaratat periodike, i kuotave të zotëruara prej tij, i transferimit të tyre më pas të bashkëshortja dhe i shitjes së tyre në vitin 2007 edhe prej bashkëshortes, janë kryer për të shmangur kontrollin dhe verifikimin e kësaj pasurie, si dhe verifikimin e fiktivitetit të veprimeve për shitjen e kuotave në vlera të pakonsiderueshme, përkundrajt fitimeve të konsiderueshme, të pashpërndara dhe të rikapitalizuara.

27.2 Përpos këtyre marrëdhënieve që qartazi duken të krijuara e mbajtura në funksion të shtimit të konsiderueshëm të pasurive nga subjekti, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje edhe kryerjen e detyrës në kushtet e papajtueshmërisë – në rastin e procedimit penal për z. N. në vitin 2013, pasi kishte krijuar marrëdhënie interesi në vitin 2005 nëpërmjet një huaje të konsiderueshme, edhe në kushtet kur në vitin 2014 e në vijim, ka lidhur kontratë qiraje [referuar në paragrafin 19.4] – si dhe nga analiza tërësore që përfshin gjithë aspektet e kontrollit të pasurisë së subjektit. Gjithashtu, për sa analizuar gjerësisht më lart në këtë vendim, sjelljet e subjektit që përfshihen në parashikimet e nenit 65, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, do të mjaftonin të kualifikoheshin sipas kësaj dispozite edhe në mungesë të elementeve të tjera të përfshira brenda kriterit të pasurisë, për pasojë trupi gjykues i vlerëson si të mjaftueshme për aplikimin e nenit 65, pika 5, ndonëse procesi i rivlerësimit është kryer vetëm për një kriter.

28 Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Bardhok Lleshi nuk arrin nivel të besueshëm të kriterit të kontrollit të pasurisë. Për pasojë, vendimi nr. 336, datë 15.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bardhok Lleshi, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 336, datë 15.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bardhok Lleshi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 19.09.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi